

**KRITIKË LETRARE****“Ngjizja e papërlyeme”, një ndër romanet me të bukur të A. Tufës**Nga **BASHKIM HOXHA**

— Faqe 12

**PROFIL****Rexhep Hoxha - Mësuesi që takoi në Bulaçin malor “Lulin e Vocërr”**Nga **HALIL RAMA**

— Faqe 22

**HISTORI****Lëvizja demokratike e Marsit 1922**Nga **ZABIT LLESHI**


— Faqe 18

**KUJTIME****Rahman Ismaili – fisniku fjalëpak e zemërmirë**

— Faqe 21-22

Ndërtimi i HEC të Skavicës kthehet në çështje elektorale. Palët politike për herë të parë shfaqin pikëpamje të kundërta

## SKAVICA:



Pamje nga vendi ku do të ndërtohet diga e Skavicës. Foto: Neki Feta

**NË BRENDESI:**

■ **Pse qesha** nga poshtë me Kryeministrin tim ■ **Ta mbrojmë Dibrën** dhe të luftojmë kundër një gjenocidi të tillë masiv ■ **“JO SKAVICËS”** në fletën e votimit ■ **Edukimi patriotik** nëpërmjet kulturës dhe artit ■ **Bledi Cami**, djali i Dibrës ■ **“Fjalor** nga e folmja e Bulqizës” ■ Si krijova një fjalor... ■ **“Pasqyra e thyer”** nga **Xhafer Martini** ■ **Lavdrim Puci** flet pak, punon shumë ■ **Vargje** që gulçojnë nga dhimbja dhe tradhtitë tinzare ■ Familja e madhe **Imeri** ■ Luftëtari dhe qëndrestari, **Bajram Bardulla** ■ **Djemtë e Dardhës** rrojnë me këngën ■ I përfalem mirënjohjes ■ Ndahet nga jeta veterani **Besim Bajraktari** ■ Lamtumirë, **Mexhit Mëziu**

**Rama: “Garanton sovranitet energjetik për Shqipërinë”****Berisha: “Mbështes projektin me tunel, pa asnjë përmbytje”**

- **Edi Rama:** Skavica garanton sovranitet energjetik për Shqipërinë” dhe se ndërtimi i saj duhet të ishte bërë më herët. Do të bëhet një nga liqenet më turistike të Ballkanit. Ky është zhvillimi që mund të sjellim në këtu. Në këtu do të zhvillojmë turizmin, agrobiznesin, sektorin energjetik. Dhe me këto do të bëjmë të mundur që gjithë këtë, që Zoti e ka bërë për merak këtu; Dibrën zoti e ka bërë ditën e diel, kur ka qenë pushim, ka pasur kohën për ta qëndisë; gjithë këtë ta kthejmë në pasuri për njerëzit dhe kjo do kohën e vetë”.
- **Sali Berisha:** “Skavica shënon hordhinë më barbare që kërkon të vërshojë mbi Dibrën në të gjitha kohërat. Ajo s’do të ndërtohet kurrë për të përmbytur Dibrën. Kam arritur në përfundimin e prerë se Skavica kurrë nuk duhet të ndërtohet në variantin që përmbytet fshatrat e Dibrës. Sot ka alternativa të tjera energjie: ato 100 megavat energji, që përfitohet nga përmbytja e Dibrës, mund t’i përfitosh shumë kollaj me turbina ere apo me panele diellore”.
- **“Marrëveshja e 3 tetorit 2020 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës është krejtësisht e paligjshme, antishqiptare dhe antikombëtare. Ajo është antiligjore jo vetëm në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, por edhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut”**

**REPORTAZH I RRJETIT INVESTIGATIV BIRN**

## Zgjedhjet në Dibër mbahen nën hijen e “Dosjes 184” dhe projektit të Skavicës

Banorët e Dibrës e shohin përballjen 6 marsit për kreun e bashkisë më shumë si garë për vendin e dytë, ndërsa kërkojnë që kandidatët të kenë një qëndrim të qartë mbi projektin e HEC-it të Skavicës që prek mbi 2 mijë familje. Nga **Sami CURRI/BIRN** - FAQE 4-5

**ANALIZË**

## Edhe njëherë për Skavicën

**Çfarë janë S-443 dhe S-485 dhe cilat janë fshatrat që fshihen nga harta?**

- **S-443 ose h=443 m** është kuota (izoipsi) e projektuar e digës së hidrocentralit në variantin e parë. Kjo kuota e sjell liqenin që do të krijohet mbi urën e Topojanit. Pra e pushton edhe grykën e Hoteshit, që ndan pellgun e Dibrës në jug nga ai i Peshkopisë (Dibrës së Poshtme) në veri. Me këtë kuota zhduset Dibra e Poshtme.
- **Po S-485? h=485** është kuota (izoipsi) e projektuar për digën e Skavicës në variantin e dytë (sipas inxhinierëve partiakë pas 10 ose 15 vjetësh). Në këtë variant përmbytet komplet fusha e Gjoricës, aty ku është shkruar historia e Dibrës (kundër Hajredin Pashës), pra përmbytet edhe Dibra e Sipërme deri afër fshatit Bllatë.

Nga **ADRIATIK BALLA**, doktor i shkencave gjeografike - FAQE 7

Gazeta "Rrugë e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur. Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur! Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugearberit@gmail.com> Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Gazetë e pavarur. Nr. 2 (186). Shkurt 2022  
Gazeta doli nga shtypi, 7 mars 2022.  
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Mars 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim. Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt. Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

**GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRIJTE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.**

**JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "e".**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

#### BOTUES:

Musa Riçku  
Bujar Karoshi  
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:

Osman XHILI  
Abdurahim ASHIKU  
Adriatik BALLA,  
Sami CURRI  
Bashkim HOXHA  
Xhafer Martini  
Muharrem GJOKA  
Halil RAMA  
Besnik LAMI  
Demir OSMANI  
Jovan BARDHI  
Tefta CAMI  
Sulejman TOMÇINI  
Stefan KUMARAKU  
Shuaip METHASANI  
Zabit LLESHI  
Mevlud BUCI  
Nazmi KOÇI  
Selman MEZIU  
Agim DEMIRI  
Bujar MUÇA

Redaksia falenderon përzemërsisht zotin **Altin Hysa** për donacionin prej 5000 lekësh dhënë për gazetën.

#### KËRKOHEM KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në goftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit [www.rrugearberit.com](http://www.rrugearberit.com).

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë. Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank  
Rrugë e Arbërit / NIPT: K820190025  
Nr. llog. në lekë: 0010036640  
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:  
Rr. "Zenel Baboçi",  
Pall. "Ferar", Tiranë  
Tel. +355 4 22 33 283  
+355 69 20 68 603

E-mail: [rrugearberit@gmail.com](mailto:rrugearberit@gmail.com)

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

**N**dërtimi i hidrocentralit të Skavicës ia doli të ishte një çështje elektorale gjatë zgjedhjeve të parakohshme për kryetarin e Bashkisë së Dibrës. Palët në fushatë për herë të parë kanë pasur pikëpamje të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Partia Socialiste e quan ndërtimin e HEC të Skavicës si një projekt kombëtar që "do ta shpëtojë Shqipërinë nga 'varësia energjetike'."

PD zyrtare, që në këtë fushatë kishte kandidat për kryetar të bashkisë z. Luan Haka, ka mbrojtur pikëpamjen se "modeli më i përshtatshëm për ekonominë e Dibrës dhe mbrojtjes së natyrës, është projekti me tre diga".

Kandidati tjetër i PD, Premtim Kryemadhi, i njohur në këto zgjedhje nën siglën "Shtëpia e Lirisë", ka dalë krejtësisht kundër projektit të ndërtimit. "Ne do ti themi "Jo" këtij projekti shkatërrues për Dibrën", ka thënë Kryemadhi në takimet elektorale, madje ka premtuar se pas zgjedhjeve, në detyrën e kryetarit të bashkisë "do të udhëheqë protestat popullore për ta ndaluar ndërtimin e hidrocentralit".

#### KRYEMINISTRI RAMA: "SKAVICA GARANTON SOVRANITET ENERGJETIK PËR SHQIPËRINË"

Kryeministri Edi Rama ishte më 26 shkurt 2022, ku zhvilli një takim në kuadrin e fushatës "Këshillim Kombëtar për Shqipërinë". Kryeministri foli për tema të ndryshme si sistemin e drejtësisë, informalitetin në punë, evazionin fiskal, madje edhe për opozitën e ndarë në dysh, por nuk tha asnjë fjalë për Skavicën, duke dhënë një sinjal se "qeveria e ka ndarë mendjen për ndërtimin e saj, ndaj nuk ka nevojë për asnjë lloj këshille".

Por nuk e anashkaloi Skavicën gjatë një takimi me të rinjtë në një nga kafenetë e Peshkopisë.

"Liqeni që ndërtohet nga Skavica do ta bëjë këtë zonë një nga zonat më të bukura dhe më me shumë atraksione, jo në Shqipëri, por edhe në Ballkan", u tha ai të rinjve.

Duke marrë shembull një nga liqenet e Belshit, i cili ka pasur transformim të madh gjatë qeverisjes së tij, Kryeministri Edi Rama tha se "Liqeni që do të krijohet nga Skavica dhe gjithçka që do të ndërtohet atje, do të jetë një destinacion turistik i jashtëzakonshëm. Do të krijojë punësi, ekonomi, kulturë".

"Nuk është thjesht çështja që do të ndërtohet aty një vepër, e cila është projektuar, është ideuar të ndërtohet qysh atëherë kur është ndërtuar kaskada, dhe që do të shpëtojë Shqipërinë nga pikëpamja energjetike" - tha Rama.

"Do të na bëjë më në fund të pavarur ne, shqiptarëve, sepse nuk jemi të pavarur. Ne na bën të pavarur sistemi elektroenergjetik, i cili, është i varur nga 'Allahu' lart. Hedh 'Allahu'

**Rama: Skavica garanton sovranitet energjetik për Shqipërinë" dhe se ndërtimi i saj duhej të ishte bërë më herët.**

Do të bëhet një nga liqenet më turistike të Ballkanit. Ky është zhvillimi që mund të sjellim ne këtu. Ne këtu do të zhvillojmë turizmin, agrobiznesin, sektorin energjetik. Dhe me këto do të bëjmë të mundur që gjithë këtë, që Zoti e ka bërë për merak këtu; Dibrën zoti e ka bërë ditën e diel, kur ka qenë pushim, ka pasur kohën për ta qëndisë; gjithë këtë ta kthejmë në pasuri për njerëzit dhe kjo do kohën e vetë".

# SKAVICA:



Pamje nga vendi ku do të ndërtohet diga e Skavicës. Foto: Neki Feta

shumë ujë, ne kemi shumë ujë. Ktheu kurrizin Allahu nga ana tjetër dhe na hodhi vetëm diell, ne s'kemi ujë fare. Ndërkohë, ajo që ne na mungon është rezervuari që mban rezervën, Skavica. Prandaj, ne sot kemi një situatë ku shesim lirë dhe blejmë shtrenjtë. Me Skavicën ne do ta mbajmë ujin aty, nuk do ta shesim kur është lirë, do ta shesim kur është shtrenjtë dhe as nuk do të përmbysim dynjanë se nuk kemi ku çojmë ujin", tha Kryeministri Rama.

Më tej, kryeministri Edi Rama theksoi se "Skavica garanton sovranitet energjetik për Shqipërinë" dhe se ndërtimi i saj duhej të ishte bërë më herët. Ai foli edhe për shpronësimet dhe investimet e tjera në këtë rajon, gjatë fazës së ndërtimit dhe pas ndërtimit të saj.

"Sot ne jemi të varur nga budalliku, sepse në gjithë ato vite nuk menduam të bëjmë këtë. Ato prona që janë aty nuk vlejnë, pasi njerëzit kanë ikur. Ato banorë që jetojnë aty, sigurisht që do të shpronësohen, ashtu siç ju takon. Pjesa tjetër do të kenë prona me vlera marramendëse, jo pas 100 vjetësh, por pas 10 vjetësh. Do të bëhet një nga liqenet më turistike të Ballkanit. Ky është zhvillimi që mund të sjellim ne këtu. Ne këtu do të zhvillojmë turizmin, agrobiznesin, sektorin energjetik. Dhe me këto do të bëjmë të mundur që gjithë këtë, që Zoti e ka bërë për merak këtu; Dibrën zoti e ka bërë ditën e diel, kur ka qenë pushim, ka pasur kohën për ta qëndisë; gjithë këtë ta kthejmë në pasuri për njerëzit dhe kjo do kohën e vetë".

Kryeministri iu referua investimit në Rugën e Arbërit, e cila e ka afruar Tiranën me Dibrën shumë afër dhe do ta afrojë më shumë me ndërtimin e Tunelit të Murrizit.

"Dibra bëhet kopshti i gjelbër i Tiranës", tha Kryeministri në takimin me të rinjtë në Peshkopi.

#### PREMTIM KRYEMADHI: DO TË JEMI NË BALLË TË PROTESTAVE KUNDËR NDËRTIMIT TË SKAVICËS

Kandidati i "Shtëpisë së Lirisë" ka premtuar se do të jetë kundër ndërtimit të HEC të Skavicës.

"Kudo ku kam shkuar, në Reç, në Zall Dardhë, në Fushë-Alie e deri në Luzni, kam takuar qindra qytetarë që kanë mijëra halle, por tani u është shtuar edhe halli tjetër, halli i përmytjes me Skavicën. Unë bashkë me ju do ti themi "Jo" këtij projekti shkatërrues për Dibrën. Do ti themi "Jo", sepse nuk mund të ndërtohet pa pëlqimin e dibranëve një projekt që e nxjerr fare Dibrën. 7-8 mijë hektarë të përmytura dhe mbi 30 fshatra të zhdukura, bashkë me historinë e tyre. Kjo nuk mund të ndodhë", tha Kryemadhi gjatë takimi përmytjes të fushatës së tij elektorale.

Gjatë një takimi elektorale në Fushë-Alie më 25 shkurt, Kryemadhi premtoi se do të ishte zëri

**Premtim Kryemadhi: "Unë bashkë me ju do ti themi "Jo" këtij projekti shkatërrues për Dibrën. Do ti themi "Jo", sepse nuk mund të ndërtohet pa pëlqimin e dibranëve një projekt që e nxjerr fare Dibrën. 7-8 mijë hektarë të përmytura dhe mbi 30 fshatra të zhdukura, bashkë me historinë e tyre. Kjo nuk mund të ndodhë."**

“Marrëveshja e 3 tetorit 2020 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës është krejtësisht e paligjshme, antishqiptare dhe antikombëtare. Ajo është antiligjore jo vetëm në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, por edhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut,

# Rama: “Garanton sovranitet energjetik për Shqipërinë” Berisha: “Mbështes projektin me tunel, pa asnjë përmbytje”

Sali Berisha: “Skavica shënon hordhinë më barbare që kërkon të vërshojë mbi Dibrën në të gjitha kohërat. Ajo s’do të ndërtohet kurrë për të përmbytur Dibrën. Kam arritur në përfundimin e prerë se Skavica kurrë nuk duhet të ndërtohet në variantin që përmbyt fshatrat e Dibrës. Sot ka alternativa të tjera energjie: ato 100 megavat energji, që përfitohet nga përmbytja e Dibrës, mund t’i përfitosh shumë kollaj me turbina ere apo me panele diellore”.



Kryeministri Edi Rama dhe disa anëtarë të qeverisë, së bashku me kandidatin për kryetar bashkie të Dibrës, Rahim Spahiu, në Peshkopi. Foto: FB/EdiRama



Ish-Kryeministri Sali Berisha dhe kandidati për kryetar bashkie i Dibrës, Premtim Kryemadhi, gjatë fushatës elektorale në Fushë Alie. Foto: FB/SaliBerisha

i qytetarëve kundër këtij projekti shkatërrues. “Kemi kryetarë bashkie që shkojnë e vijnë, kemi deputetë të majtë e të djathtë, por a keni dëgjuar ndonjërin prej tyre ta përmendë Skavicën? Skavica është çështja e ditës, por pse nuk e përmendin?”

“Një kryetar bashkie që ka qytetarët me vete, ka shumë kompetenca, më shumë se kryeministri. Unë do të jem në këmbë të mbarë protestave, jo vetëm ju që prekeni drejtpërdrejtë, por edhe të tjerëve, sepse vetëm të bashkuar mund ti bëjmë ballë kësaj katastrofe historike, demografike kulturore për gjithë zonën. Unë do të jemi bë ballë të këtyre protestave”, tha Premtim Kryemadhi në Fushë-Alie.

## BERISHA: “MBËSHTES PROJEKTIN E SKAVICËS ME TUNEL, PA ASNJË PËRMBYTJE”

Edhe ish-kryeministri Sali Berisha, i cili udhëhoqi fushatën e “Shtëpisë së Lirisë” tha në Fushë Alie se ishte kundër projektit që përmbyt fshatrat të tëra. Përfaqësues të banorëve të këtij fshati i kërkuan Berishës që ti ndihmonte ata në mbrojtjen e shtëpive dhe trojeve të tyre nga ndërtimi i HEC të Skavicës.

Duke iu përgjigjur thirrjes së tyre, Berisha tha se “Dibrën e kërcënon një mynxyrë e vërtetë, e kërcënon përmbytja e tokave, e shtëpive, e varreve të të parëve dhe e historisë së saj, që është njëkohësisht palcë e historisë kombëtare, me një digë e tëra korruptive, diga e Skavicës”.

Berisha, në fjalën e tij theksoi se në vitin 2005, kishte anuluar një kontratë me një kompani italiane, për faktin se ai nuk mbështeste asnjë projekt që shpërngulte qoftë një fshat apo lagje si dhe pa kaluar nga një tender ndërkombëtar”.

Berisha tha se “kompania italiane e ribëri projektin, për një tunel nga Skavica deri afër Bicaj, pa asnjë përmbytje”. “Ky është projekti që unë mbështes dhe do ta mbështes. Projekt me përmbytje nuk mbështes kurrë dhe kjo nuk mund të ndodhë”, tha ai.

Ish-kryeministri Berisha e akuzoi Ramën për dhënien e ndërtimit të Skavicës më një prokurim të drejtpërdrejtë, duke anashkaluar garën ndërkombëtare. Ai u bëri thirrje dibranëve në Tiranë dhe kudo nëpër botë, që të ngrihen në këmbë për të ndaluar përmbytjen e Dibrës.

“Skavica shënon hordhinë më barbare që kërkon të vërshojë mbi Dibrën në të gjitha kohërat. Ajo s’do të ndërtohet kurrë për të përmbytur Dibrën” - tha Berisha.

Të njëjtin qëndrim ai mbajti edhe në takim përmbyllës elektorale në bulevardin “Elez Isufi” në Peshkopi, më 2 mars 2022.

“Edi Rama ka marrë përsipër ti bëjë Dibrës

atë që nuk ia ka bërë asnjë pushtues në të gjitha kohërat: të mbytë nën ujë Dibrën më pjellore, Dibrën historike, vendorigjinën e Skënderbeut, të mbytë nën ujë dhjetëra fshatra, përfshirë edhe shtëpitë dhe varrezat. Dhe pse? Për të prodhuar 100 megavat energji më shumë në hidrocentralin e Skavicës. Kam arritur në përfundimin e prerë se Skavica kurrë nuk duhet të ndërtohet në variantin që përmbyt fshatrat e Dibrës. Sot ka alternativa të tjera energjie: ato 100 megavat energji, që përfitohet nga përmbytja e Dibrës, mund t’i përfitosh shumë kollaj me turbina ere apo me panele diellore”.

## LUAN HAKA: TRANSPRENCË E PROJEKTIT, KONSULENCË DHE KOMPENSIM I DUHUR PËR BANORËT

Luan Haka, kandidati i PD që drejtohet nga Lulzim Basha, nuk ka mbajtur një qëndrim të prerë për çështjen “Skavica”. Në takimet me banorët ai ka vënë theksin te “konsulencia me banorët dhe transparencë të planit të fizibilitetit”.

Pas një takimi në Luzni më 22 shkurt 2022, Haka shkroi në faqen e tij në Facebook se “në fokus të bisedave, një vend të veçantë zuri dhe projekti i ndërtimit të Skavicës. Banorët theksuan se nuk janë kundër ndërtimit të kësaj veprë madhore energjetike, por nevojitet transparencë e projektit, konsulencë dhe kompensim i duhur për banorët që do të preken nga ndërtimi”.

Haka i qëndron pikëpamjes se “modeli më i përshatshëm për ekonominë e Dibrës dhe mbrojtjes së natyrës, është projekti me tre diga, i cili nuk do të shpërngulte komunitete të tëra, por do ta kthente zonën në një destinacion tërheqës turistik”.

Në një intervistë për median Haka ka evidentuar dy momente. E para, ai ka vënë re se “asnjë dibran nuk është kundër investimeve madhore energjetike kombëtare, por rasti i ndërtimit të Skavicës duhet të përfshijë më shumë konsulencë me banorët dhe transparencë të planit të fizibilitetit”.

Pika e dytë, sipas tij, lidhet me shqetësimet që banorët kanë për përmbytjen e tokave bujqësore dhe investimeve që kanë ngritur, si dhe pasojat në ekosistem.

Sipas Hakës, banorët “kërkojnë shpjegime dhe sqarime nga ekspertët e fushës, dhe jo nga euforia apo interesat e politikanëve”.

## ORGANIZATAT MJEDISORE: TË RISHIKOHET PROJEKTI, SJELL DËME TË MËDHA MJEDISORE DHE PASOJA TË PARIPARUESHME SOCIALE

Më 22 dhe 23 shkurt, në një nga sallat e Hotel Veri në Peshkopi, përfaqësues të

“Projekti i Digës së Skavicës çënon proceset ligjore dhe kushtetutën shqiptare, është shkatërrues për mjedisin, shkatërron identitetin dhe kulturën dibrane, identitetin e popullit shqiptar dhe është kundër interesit kombëtar të vendit. Është krejtësisht e pakuptueshme se si mund të jete dhënë një leje mjedisore për një projekt hidroenergjetik

organizatave mjedisore dhe shoqërisë civile, zhvilluan takime në lidhje me organizimin e një fushate informuese dhe faktmbledhëse në terren, mbi dëmet që sjell ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës.

Përfaqësues në këtë takim ishte edhe një nga aktivistet e organizatës më të madhe në Europë, Euronatur, e cila është e angazhuar në mbrojtjen e natyrës, jetës së egër të Europës, ruajtja e habitateve të saj dhe ofrimin e një perspektive ekonomike miqësore ndaj natyrës për banorët vendas. Organizata ka krijuar një rrjet të fuqishëm organizatash partnere dhe shkencëtarësh, duke ofruar mbështetje për komunitetet që rrezikohen nga ndërtimi i veprave të mëdha, ngjashëm si ai i HEC të Skavicës.

E pranishme në këtë takim ishte edhe Ferzileta Gjika, e cila përfaqësonte një lëvizje të dibranëve, shqiptarëve, në New York, të cilët janë kundër ndërtimit të Skavicës.

“Projekti i Digës së Skavicës çënon proceset ligjore dhe kushtetutën shqiptare, është shkatërrues për mjedisin, shkatërron identitetin dhe kulturën dibrane, identitetin e popullit shqiptar dhe është kundër interesit kombëtar të vendit. Është krejtësisht e pakuptueshme se si mund të jete dhënë një leje mjedisore për një projekt hidroenergjetik”, tha për gazetën “Rr.A.” Ferzileta Gjika.

Ajo i cilësoi veprimet e politikanëve si “të papërgjegjshme”.

“Ndërsa emergjenca klimatike përshkallëzohet, qeveritë e ndryshme të Europës dhe Amerikës po kërkojnë mënyra për të reduktuar emetimet e “Greenhouse Gas” dhe “Go Green”. Ndërsa industria hidroenergjetike në Shqipëri po kërkon të përfitojë nga urgjenca klimatike, duke e reklamuar në mënyrë të rreme fuqinë e saj si “të pastër, të gjelbër, të qëndrueshëm dhe të rinovueshëm”. Hidrocentrali i Skavicës është energji e pistë, nuk duhet lejuar të kualifikohet për subvencione ose të konsiderohet “energji e pastër”. Është një fatkeqësi e të drejtave të njeriut, klimës dhe mjedisit”, tha Gjika.

Ajo theksoi se “SHBA ka ndaluar me ligj

ndërtimin e hidrocentraleve të mëdha, siç është ai i Skavicës, dhe shteti federal merret vetëm me mirëmbajtjen e hidrocentraleve ekzistuese, është e pakuptueshme se si është përfshirë një kompani amerikane në ndërtimin e HEC Skavica”.

Gjatë një intervistë në “Syri TV” më 27 shkurt 2022, ajo i kërkoi qeverisë shqiptare që ta ndalojë zhvillimin e këtij projekti, duke propozuar disa kërkesa:

- të bihet dakord për muajt në vijim, mars-prill 2022, për një rishikim të plotë të planeve aktuale të zhvillimit të hidrocentralit mbi Lumin Drin i Zi;

- organizimi i një tryeze të rumbullakët shkencore për Skavicën, ku të përfshihen ekspertë vendas dhe ndërkombëtar, për të informuar marrjen e vendimeve në lidhje me çështjet e identifikuar në pellgun ujëmbledhës të Drinit të Zi;

- të ndiqen angazhime politike dhe ligjore të Shqipërisë, për të përmbushur konventat ndërkombëtare si dhe kërkesat e Bashkimit Evropian në lidhje me ndërtimin e digave të mëdha;

- të shqyrtohen alternative të tjera energjie, si ajo diellore, nga era, dhe të ndalohet kategorikisht ndërtimi i një hidrocentrali të madh, si ai i Skavicës;

- të dëgjohet zëri i banorëve të Dibrës që preken drejtpërdrejtë nga përmbytja e vendit të tyre, duke zhdukur identitetin, historinë, kulturën, shtëpitë dhe trojet.

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, dy ditë para zgjedhjeve, doli me një thirrje të hapur, ku kërkon ndihmën dhe kontributin e çdo shqiptari për “shpëtimin e Dibrës”.

Deklarata i kundërvihet kryeministrit dhe politikanëve që duan të ndërtojnë Skavicën, dhe bën thirrje që njerëzit të votojnë për “veten e tyre”.

“Votoni atë që ju ka dalë Zot në mbrojtjen e Dibrës. Këto votime janë një test për shpëtimin e Dibrës tonë”.

Në deklaratën e shoqatës, firmosur nga kryetari, Nazmi Drizi, nuk përmendet emri i kandidatit, por nënkuptohet se ai është Premtim Kryemadhi.

Shoqata ka deklaruar publikisht se ka mbi 5 mijë anëtarë në radhët e saj, por gjatë fushatës elektorale nuk organizoi asnjë proteste kundër Skavicës. Tani mbetet të verifikohet nëse 5 mijë anëtarët e saj do të votojnë kandidatin e “Shtëpisë së Lirisë” apo do ti bojkotojnë zgjedhjet.

Që prej protestave të organizuara në nëntor 2020, ku Drizi është gjobitur me një shumë prej 5 milionë lekë, protestat e shoqatës kanë qenë të pakta. Që prej protestës së organizuar në nëntor 2021 në Peshkopi, ku u themelua Aleanca për Mbrojtjen e Dibrës, nuk ka pasur më protesta kundër Skavicës. Protestat janë zhvilluar vetëm në Facebook.

**Banorët e Dibrës e shohin përballjen 6 marsit për kreun e bashkisë më shumë si garë për vendin e dytë, ndërsa kërkojnë që kandidatët të kenë një qëndrim të qartë mbi projektin e HEC-it të Skavicës që prek mbi 2 mijë familje.**



Në foto:  
Bulevardi "Elez Isufi" i zbrazur nga posterat edhe pse në kohë fushate.  
Foto: Sami Curri / BIRN

Marrë nga  
<https://www.reporter.al/2022/03/04/zgjedhjet-ne-diber-mbahen-nen-hijen-e-dosjes-184-dhe-projektit-te-skavices/>

# Zgjedhjet në Diber mbahen nën hijen e "Dosjes 184" dhe projektit të Skavicës

Nga SAMI CURRI/Birn

Banorët e Dibrës, në harkun kohor të shtatë viteve kanë ndërruar 5 kryetar bashkie – tre të zgjedhur dhe dy të emëruar. Në zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit, ata do u drejtohen sërish kutive të votimit për të votuar kryetarin e gjashtë, për një mandat pak më shumë se një vit.

Por këtë herë fushata për kryebashkiakun e ri, nuk ngjall shumë interes, pasi banorët e quajnë "muhabet të mbyllur". Në garë përballë socialistëve në pushtet dhe me kontroll të çdo institucioni, qëndron një opozitë e përçarë.

"Opozita po të ishte e bashkuar këta (socialistët) i qëronin si portokall. Fitoren e sigurt. Po tashi PD e ndarë, dihet ajo," tha Kujtim Murra, një pensionist që po bënte shëtitjes e mbasdites në bulevardin "Elez Isufi" në Peshkopi.

Mungesa e interesit dallohet edhe në shëtitoren kryesore të Dibrës, e cila dikur me afrimin e zgjedhjeve mbushej me flamuj dhe postera elektorale, ndërsa në këto zgjedhje nuk shihet asgjë e tillë.

Haxhi Paci, njësoj si miku i tij Kujtim Murra thotë se nuk sheh se si këto zgjedhje mund ta ndryshojnë drejtimin e bashkisë. Ai ankohet se Dibra ka ngelur në legjenda si "kreshnike" dhe "trime", ndërsa sot problemet e shumta dhe politika e ka vënë për poshtë këtë zonë.

Kandidatët për postin e kryetarit të bashkisë në këto zgjedhje janë katër. I pari në fletën e votimit është Premtim Kryemadhi, një arsimtar që kandidon nga koalicioni "Shtëpia e Lirisë", i cili është krijuar nga LSI, por mbështetet nga ish-kryeministri Sali Berisha dhe një fraksion i Partisë Demokratike. Luan Haka është në garë si kandidat i Partisë Demokratike.

Nga koalicioni i majtë i Socialistëve në pushtet në garë për kryetar është Rahim Spahiu. Ndërkohë në garën për kryetar të Bashkisë Diber do të jetë edhe një 26 vjeçar, Dritan Torba si kandidat i Partisë Lëvizja e Re.

## NËN HIJEN E "DOSJES 184"

Në Bashkinë Diber banojnë afro 56,000 qytetarë të cilët kanë të drejtën e ushtrimit të votës. Në zgjedhjet për Kuvend të një viti më parë, ishin afro 30,000 qytetarë që e ushtruan këtë të drejtë.

Një vit pas zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, ata janë ftuar sërish t'u drejtohen kutive të votimit më 6 mars, për të votuar pasardhësin e Dionis Imeraj – kryebashkiakut që la drejtimin e bashkisë për t'iu futur garës për deputet në listat e Partisë Socialiste. Imeraj e humbi mundësinë të bëhej deputet pasi Partia Demokratike u kthye si shumicë në Diber me një diferencë të vogël votash.

Kjo fitore erdhi sipas demokratëve lokalë pas përpjekjeve të mëdha për të ndaluar shit-blerjen e votës. Në fushatën e fundit në prill të vitit që shkoi, dy persona u ndaluan nga mbështetës të PD-së dhe kandidatët e saj në zgjedhje me dyshimin se po blinin vota. Të dy u dënuan në dhjetor të vitit që shkoi nga Gjykata e Dibrës me 1 vit burg për akuzën e korrupsionit në zgjedhje.

Por zgjedhjet e mëparshme kanë pasur një panoramë tjetër. Në zgjedhjet lokale të vitit 2015, kandidati i socialistëve Shukri Xhelili, fitoi me 500 vota diferencë bashkinë. Xhelili u shkarkua një vit më vonë dhe më pas u dënua, pas akuzave për abuzim me detyrën në kërkim të favoreve seksuale për një vend pune.

Në zgjedhjet që pasuan socialistët garuan me Muharrem Ramën, i cili ndryshe nga sa pritej fitoi me një diferencë të shtuar prej 4,232 votash ndaj kandidatit të Partisë Demokratike. Ky dominim i Partisë Socialiste dhe aleatëve të tyre të PDIU, e

njohur ndryshe si partia e komunitetit çam, do të vijonte edhe në zgjedhjet për Kuvend në vitin 2017-të.

Këto fitore të thella të socialistëve dhe rritja elektorale e PDIU – pavarësisht se në Diber nuk ka një komunitet çam, ngritën dyshime. Një sërë përgjimesh të publikuara fillimisht në vitin 2019 pas një investigimi të BIRN dhe Zërit të Amerikës, treguan se një sërë funksionarësh shtetërore dhe persona të tjerë pranë socialistëve kishin manipuluar votat.

Hetimet e zvarritura të prokurorisë dolën po ashtu në të njëjtin përfundim edhe pse shumica e personave të akuzuar për blerje vote nuk u dërguan në gjykatë, për shkak të afateve.

Skandali i blerjes së votave u përdor nga opozita si motiv për të braktisur mandatet në Kuvend dhe bojkotuar zgjedhjet lokale të vitit 2019. Në këtë të fundit Dionis Imeraj, i cili qe një ndër personat e përmendur në "Dosjen 184" mori si kandidat i vetëm në zgjedhje gati 13,000 vota.

Por hesapet me "Dosjen 184" nuk kanë përfunduar ende. Prej gati 1 viti, dy gjyqe për katër të pandehur vijojnë në gjykatën e Dibrës. Por gjykimi i avashtë i të akuzuarve për abuzim me detyrën dhe presion ndaj zgjedhësve, nuk duket se ka ndikuar shumë në perceptimin e banorëve të kësaj bashkie mbi sigurinë e votës.

"Mileti rrehet për 5 lekë dhe si të rre-

hesh për 5 lekë çfarë pret ti. Këtu nëse do të bëhesh kryetar ose deputet është punë lekësh. Ke lek hajde", – thotë Kujtim Murra, me mllef për ato çfarë kanë ndodhur në Diber.

Për Haxhi Pacin, historia e "kësaj dosjes së Dibrës" është gjë e ditur dhe e përsëritur. "Po dihen ato gjona dhe dihet që s'ka për të pas naj gjë nga drejtësia, se nuk ka si të ketë se po hanë të gjithë në një tas", tha ai me ironi.

E megjithatë "Dosja 184" është pjesë e fushatës, por këtë herë në përballjen mes dy grupimeve të Partisë Demokratike, atij të kryesuar nga Basha që kandidon Luan Hakën dhe atij të Berishës që kandidon Premtim Kryemadhin.

Në 2 shkurt Partia Demokratike akuzoi ish kreun e saj Berisha se po tallej me Dibrën, pasi kishte vendosur si kandidat bashkëshortin e ish-prokurores Belina Zeneli-Kryemadhi, e cila sipas tyre edhe pse pati në dorë nuk hetoi vjedhjen e zgjedhjeve të vitit 2016. "Kandidimi në Diber i bashkëshortit të prokurores që mbrojti bandën e Edi Ramës, duke mos hetuar dosjen 184 të vjedhjes së zgjedhjeve në Diber, është poshtërsi dhe tallje me dibranët", thuhet në një postim të PD në faqen Facebook.

Prokurorja Kryemadhi u shkarkua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për "mospërbushje të funksioneve".

Por Premtim Kryemadhi i quan absurde akuzat. Ai këmbëngul se bashkëshortja e tij si prokurore kishte këmbëngulur që dosja të hetohej nga SPAK për grup të strukturuar kriminal dhe se kur SPAK nuk pranoi ta merrte përsipër ajo kishte hequr dorë nga hetimi.

Kryemadhi nga ana tjetër nuk beson se skenarë si ato të vitit 2016 mund të përsëriten. Ai këmbëngul se në zgjedhjet e vitit 2021 vota arriti të mbrohej dhe premtion se mund të bëjë sërish këtë.

Në anën tjetër kandidati i LRE, Dritan Torba e sheh historinë e papërfunduar të "Dosjes 184" si një rrezik për zgjedhjet e të dielës. "Shit-blerja e votës është arsyeja kryesore pse po qeverisemi kaq gjatë nga këto parti dhe e reja nuk mbështet" – shprehet Torba për BIRN.

Përfaqësuesit dhe kandidatët e Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste nuk iu përgjigjën kërkesave të vazhdueshme të BIRN për të folur mbi fushatën e tyre në Diber.



Tabelë kundër ndërtimit të HEC "Skavicë në fshatin Bllaçë. Foto: Sami Curri / BIRN



Tokat bujqësore në luginën e Drinit të Zi. Foto: Sami Curri

### QYTETARËT KËRKOJNË QËNDRIM PËR "SKAVICËN"

Njësia Administrative Kastriot është vetëm 20 minuta larg nga Dibra. Nëse do të përfundojë së ndërtuari HEC Skavica në variantin e tij më digë të lartë, një pjesë e tokave bujqësore të kësaj njësie dhe disa fshatra do të përmythen nga uji.

Krijimi i rezervuarit të Skavicës do të shkaktojë sipas parashikimeve përmytjen e mijëra hektarëve tokë dhe prek rreth 2000 familje.

Për vite me rradhë projekti ka qenë ide, e mbajtur në sirtar që në vitin 1963, por përmes nënshkrimit të një memorandumit bashkëpunimi ndërmjet kompanisë amerikane 'Bechtel', qeverisë shqiptare dhe qeverisë së SHBA-vë, puna për ndërtimin e kësaj vepre duket se kanë filluar.

Kjo i ka zemëruar shumë banorë të Dibrës që e kundërshtojnë hidrocentralin dhe i kërkohet kandidatëve për kryebashkiakë të mbajnë qëndrim për të.

Elez Noka dhe Medi Toda janë banorë të fshatit Bllaçe në Fushë-Alie. Ata tregojnë se HEC Skavica do iu përmbysë varret dhe tokat e për ta kjo është e pa pranueshme.

"Nuk besoj se do të jetë e banueshme kjo zonë se do të jetë mjegull dhe lagështirë. Më mirë të na mbys në të gjallët se sa të mbys kockat e varreve," thotë Elez Noka. Për ta ky projekt ka paqartësi dhe nuk iu është dhënë asnjë sqarim banorëve që mund të dëmtohen.

Noka thotë se kryetari i ri i bashkisë duhet të "prijë protestat" nëse populli është kundër. Për atë vetëm me protesta mund të ndalet ky projekt.

"Se në këtë rast, harroje se Skavica ndalohet ndryshe veçse me luftë. Populli në protestë. Po këta në Dibër sot kanë lënë pleq e plakat. Në katër shtëpi, një banohet se tre të tjerë janë braktisur. Këta e kanë shkatërruar jo pa qëllim nga 30 vite Dibrën," tregon ai mes zemërimit dhe dëshpërimit.

Por ndër garuesit në zgjedhje, vetëm dy pranuan të tregonin qëndrimin mbi hidrocentralin. Premtim Kryemadhi, kandidat i koalicionit "Shtëpia e Lirisë" thotë se nëse banorët do të jenë kundër ndërtimit të Skavicës, ai si kryetar bashkie do të jetë në ballë të protestave.

"Protestat do të kenë në ballë Premtim Kryemadhin, nesër kryetar bashkie, nëse dibranët nuk e mbështesin projektin e HEC

**Perseku mendon se përtej debatit politik plani nuk mund të ndalohet. Teksa dredh duhanin në duart e "vrara" nga puna, ai thekson historia e Skavicës i duket "kafe e pirë" – ironi që tregon se një fejesë është kryer.**

Skavicës," tha ai.

Njësoj edhe kandidati i LRE, Dritan Torba deklaroi se është kundër ndërtimit të HEC Skavicës. "Nëse një komunitet është kundër, kryetari duhet të jetë i pari që i mbështet," tha ai.

Por Hysen Uka – i aktivizuar në nisma të ndryshme publike në Dibër dhe që e mbështet ndërtimin e HEC-it, thekson se deklaratat e dy kandidatëve janë deklarime për peshkim të votave.

Sipas Ukës dalja e ish-kryeministrit Sali Berisha dhe kandidatit të Shtëpisë së Lirisë kundër këtij projekti, bëhet për "peshkim të votave". "Sfida e tij nuk është nëse fiton apo jo, por për revansh ndal Lulzim Bashës. Janë llogari elektorale dhe ai e din se sa përfiton nga kjo. Në datë 7 mars 2022, Sali Berisha nuk do të merret më me këtë punë," shprehet Uka dhe këmbëngul se Berisha më herët e kishte cilësuar projektin si një "ëndërr në sirtar".

Uka thotë se projekti i HEC-it krijon mundësi për një paketë investimesh strategjike që mund të realizohen paralel me punimet për ndërtimin e tij.

Por Ramadan Perseku, banor në fshatin Kastriot, tha ndërsa kulloste delet pranë rrugës se do humbiste gjysmën e tokës së tij nga ndërtimi i hidrocentralit dhe nuk sheh ndonjë përfitim prej tij.

Perseku mendon se përtej debatit politik plani nuk mund të ndalohet. Teksa dredh duhanin në duart e "vrara" nga puna, ai thekson historia e Skavicës i duket "kafe e pirë" – ironi që tregon se një fejesë është kryer.

Perseku mendon njësoj edhe për zgjedhjet. Ai thotë se ka votuar PD-në më parë, por këtë herë me gjasë nuk do të shkojë të votojë.

"Vetëm rrena, rrena. Këtij mileti i kanë dhënë për të ngrënë me lugë bosh", tha ai dhe shtoi se për shkak të ndarjes së PD-së, në Dibër do të fitojë kandidati socialist.

## FEJTON

# Pse qesha nga poshtë me Kryeministrin tim

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ai kishte mbledhë ca çupëlina dhe po u tregonte një përrallë...

Në mes të ditës...

Në mes të dimrit...

Në mes të Dibrës...

...Na ishte një herë e një kohë një...

Larg e larg, 9 male kaptuar...

Vendasit i thoshin liqen.

Në fakt ishte hurdhë, nga ata që natyra i mbush me kova nga qielli dhe ia mbyll daljen, e burgos, e kalb, e baltos...

Uji fle, qerpiku nuk i lëviz...

Erë e rëndë. Parfum kalbësirash, plehu, simfoni e valle bretkocash...

I pastruar të gjitha.

Një më një, copë më copë.

Me të gjitha mjetet: me fshesa, sfulq, buldozerë.

Me punë me pare e punë pa pare, vullnetare...

Dritë e bëmë.

Mbollëm qark e rreth pemë, shumë pemë: akacie, selvi, shelgie, lule...

Është bërë gjëja më e bukur.

Të shkosh atje rinolesh, merr frymë, ajër të pastër mbushur me ozon.

Është bërë pika turistike më e frekuentuar...

Për vendasit...

Për ardhanakët nga e gjithë Shqipëria...

Për të huaj nga Amerika dhe Australia...

Ndërkohë në ekran fotopamjet vraponin njëra pas tjetrës...

Duartrokitje...

Në ekran nja tre-katër vajza, të bukura si zana malesh.

Qeshnin dhe duartrokisnin...

Ai vazhdoi...

Kështu do ta bëjmë edhe Skavicën, bukuri të bukurive të Shqipërisë. Me një liqen të madh, me vila si në bregdetin e Himarës time dhe të Koços. Pata thënë se në pleqëri bashkë me Koçon do të pushonim e pinim kafe te rrapi në Dhërmi. E ndryshova. Do të vij të pleqëroj në Dibër. Do bëj një vilë në fjordin e Setës. Do të jetë më i bukur edhe se fjordet e Norvegjisë. Pa le

ai i Veleshicës me Sllovën e Elez Isufit port jahtesh, jahte nga bosët serbë të "Ballkanit të hapur"...

Mos harroni edhe hapësirën e bukur të Luznisë, Brezhdanit, Cetushit e Ushtelencës, urën e varur që do të lidhë rrugën "Nëntë Malet e Dibrës", rrugë që do të jetë si një gjerdan kopjues i tërë pasqyrës perëndimore të liqenit të Skavicës...

Më e bukur nga të gjitha do të jetë pasqyra liqenore e fushës së Muhurrit, Kastriotit dhe Fushës së Çidhnës. Por bukuria e kësaj bukurie do të jetë "Rruga e lidhjes së Prizrenit", qyteti i ri i Kastriotit. Buzë liqenit ai do të jetë ma i bukur se Pogradeci e Struga, qytet modern...

Një profesion i ri do të lulëzojë gërma-dhash, profesioni i peshkatarit. Dibra nuk do të ketë nevojë më të rrisë lopë, dele, dhi, pula, kuaj e gomarë. Nuk do të ketë nevojë dibrani të lë kockat për një kosh me misër e një magje me grurë. Do të mbjellë rasat peshku e do të vjelë troftë, ballëgjërë e koranë. Edhe peshkaqenë. Pse jo, edhe krokodilë...

Do të ketë fabrika peshku ku do të punësohen mijëra gra e vajza...

Qark liqenit të Skavicës, që një gazetar që ka tradhtuar Dibrën duke u arratis jashtë këtij vendi të bekuar që lulëzon si asnjëherë e quan hurdhë, do të lulëzojë jeta, do të mbijnë si kërpudhat pas shiut vila, akuodrome, pishina për kampionate evropiane e botërore garash nga njeri breg në tjetrin, fusha vaterpoloje sa dibranët do ta harrojnë kërkesën për stadium futbollit...

Eh sa bukur do të jetë. Lumë kush të rrojë e në Dibër do të gëzojë.

Duartrokitje...

Duartrokitje...

Duartrokitje frenetike e buzëqeshje që shpërthejnë në qeshje...

Qeshje fëminore...

Tek i shikoja në ekranin e vogël tërë atë gëzim e hare më erdhi edhe mua, 1000 kilometra larg, të qesh.

E provova...

Nuk më doli lart...

Më doli poshtë...



Një thirrje që vjen nga Amerika.

- Shënime duke ndjekur tre zëra televizivë

# Ta mbrojmë Dibren dhe të luftojmë kundër një gjenocidi të tillë masiv

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ai e nisi emisionin sikur të kishte nxjerrë me duar nga zjarri një patate të pjekur. Iu përvëlua dora. E hodhi në dorën tjetër. U përvëlua, ndërroi dorë, u përvëlua...

Ishte hera e parë që përballë me një problem që thonë se ka bërë emër të përveçëm diku gjashtë dekada më parë për tu zgjuar një duzinë vite më parë, 12 vjet të shkuara.

Të parin, atë para gjashtë dekadave nuk e ka jetuar. Është i ri në moshë. Të dytin e ka jetuar, me mikrofon në jakën e këmishës.

Nuk e mbaj mend të ketë skicuar ndonjë emision televiziv me të ftuar brenda vendit, me dibranë që u shkatërrohet jeta, për jashtë vendit, nuk bëhet fjalë.

Nuk e di në se e ka dëgjuar beniaminin e vet (në televizionin e të cilit ka bërë uljen e radhës) kur çirrej dritare më dritare televizive se "Unë di të ndërtoj vepra të mëdha..."

Nejse të shkuara të rrëguara.

Ajo që më bëri ta dëgjoj deri në fund dhe ta zbardh për ta përcjellë "të shkruar" nisur nga sentenca latine "e shkruara mbetet" është se më në fund diga e hurdhës së Skavicës, domosdoshmërinë e ngritjes të së cilës fjali të parë e ka pas (dhe e ka) si Berisha ashtu edhe Rama... "Ndërtimi i Skavicës shpëton Shkodrën nga përmbytja"... doli në një dritare televizive, në Syri Net, në emisionin Krasta Show...

Urojmë të dalë edhe në të tjerët, kombëtarë e jokombëtarë, vendorë e kabllorë, me luftëtarë që i thonë "PO DIBRË! JO SKAVICËS" dhe me patronazhistë teknikë dhe politikë...

"Sot, thamoderatori, kam një program shumë të ngjeshur, shumë të shpejtë..."

Shprehje e zakonshme e moderatorëve që gjithnjë vrapojnë, asnjëherë nuk kanë kohë, gjithnjë u mbaron koha televizive...

Në studio kishte një doktor shkencash, Enriko Cekon, agronom, ekonomist...

Kishte një inxhinier pyjesh, ekspert mjedisi, dibranin Munir Hoxha, i njohur për mbrojtjen e mjedisit nga Radika, Luginës së Drinit të Zi, bukurive të Dibres, JO-së së madhe të Skavicës...

Kishte edhe një dibrane, Ferzileta Gjiken, aktivistepër mbrojtjen e Luginës së Drinit që fliste nga përtej Oqeanit Atlantik.

Le ti lexojmë mendimet e tyre...



**Enriko Ceka:**  
**NUK KA NEVOJË FARE TË NDËRTOHET SKAVICA**

Në vitin 2003 një kompani britanike i ka bërë ofertë qeverisë shqiptare që ujin që rrjedh nga Fierza në Koman dhe në Vaun e Dejës, natën, ta çojmë sipër në Fierzë me gjysmën e çmimit të harxhimit të energjisë. Pra nuk ka nevojë fare të ndërtohet Skavica sepse ujin që rrjedh ditën për të prodhuar energji elektrike nga Fierza, Komani dhe Vau i Dejës e çojmë natën sipër në Fierzë.

Në qoftë se Skavica kushton minimalisht

250 milionë euro projekti për ta kthyer ujin mbrapsht nga Vau i Dejës për në Fierzë bën maksimalisht 40 milionë euro...

Poqe se përmbytet toka humbasim tokën bujqësore, rreth 3-4 hektarë secila familje nga 16 mijë familjet që jetojnë në zonën që preket. Nga ana ekonomike Shqipëria prodhon perime të vona në periudhën shtator-tetor nga brezi Kukës-Korçë, Shqipëria juglindore dhe verilindore.

Po qe se ne prishim këtë ekosistem nuk do të kemi perime të vona të cilat axhustojnë çmimet e tregut.

Po qe se nuk kemi perime të vona që në mes të shtatorit çmimet do të rriten me 25-30 për qind në tregun vendas...

Por është Dibra, Koça, Kukësi që furnizojnë Shqipërinë me perime të vona.

Është 60 milionë euro në vit.

Këtyre 13 mijë familjeve do tu marrish 60 milionë euro në vit para të thata.



**Munir Hoxha:**  
**NDËRTIMI I SKAVICËS ËSHTË GENOCID NDAJ DIBRËS DHE DIBRANËVE**

Për herë të parë Dibra është përpara dilemës së ekzistencës.

Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të mbysë rreth 35 fshatra, jo më pak se 20 mijë banorë dhe 20 mijë të tjerë u preken interesat e tokave dhe të pronave. Kjo është ana njerëzore. Në fund të fundit atje ka njerëz dhe këto duhet ti pyesësh përpara se të nisësh një studim, një projekt për të ndërtuar një hidrocentral, çdo vepër.

Hidrocentrali po ndërtohet në lumin Drin, në pjesën e vetme që ka mbet e paprekur, rreth 70 kilometra, zonë që mund të ishte një resurs i madh turistik për të krijuar të ardhura për popullsinë e Dibres dhe për më tepër që ndërtimi i Rrugës së Arbrit do ti shërbente këtij qëllimi dhe Dibra të ishte një ndër zonat më të zhvilluara të Shqipërisë, jo siç është sot e fundit në Shqipëri.

Gjithçka ka nisur mbrapsht.

Me popullin nuk ka biseduar askush dhe shumica e njerëzve janë të shqetësuar për ekzistencën.

Për mua ky do të ishte një gjenocid. Atë që nuk e bëri dot Serbia për nëntë vjet me Dibranët dhe u zbraps, këtë po e bën qeveria jonë.

Ajo po i largon këta njerëz me forcë.

Dhe ky është një veprim që dënohet nga çdo konventë ndërkombëtare. Populli i Dibres nuk do ta lejojë.

Qeveria kujton se e ka të lehtë. E ka nis punën mbrapsht.

Nuk diskutohet këtu se sa lekë do të shpenzohen.

Këtu dëmtohen jetë njerëzish.

Do të dëmtojë mjedisin.

Do të dëmtojë klimën.

Do të dëmtojë të gjithë atë hapësirë ekologjike që sot mund të ishte një ndër zonat më atraktive për turizëm.

Skavica projekt zhvillimorë?

Si mund të jetë një projekt zhvillimorë ai projekt që merr nëpër këmbë interesat e popullit dibran, rreth 40 mijë banorë?

Si mund të jetë projekt zhvillimorë ai që shkatërron mjedisin?

Ne nuk jemi një shtet me tokë të pasur.

Kemi pak tokë.

Ta kthejmë edhe atë pak tokë në liqen?

Kjo do të jetë një katastrofë e madhe ekologjike që prish gjithë ekuilibrat bio-ekologjikë dhe do të shkaktojë një mjerim të madh për popullin tim. Mua më vjen keq edhe për diçka tjetër...

Në Dibër po goditet historia e saj e lashtë dhe e re.

Në Dibër, dhe pikërisht në atë zonë, është vendlindja dhe vend origjina e Kastriotëve, e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Ne po i zhdukim edhe ato gjurmë të vetme që kanë mbetur të Heroit tonë Kombëtar duke e mbytur duke e kthyer atë zonë në një zonë shkretëtirë. Ky do të ishte një krim shumë i madh.

Populli i Dibres ma merr mendja do të ketë përkrahje nga gjithë populli shqiptar sepse nuk kemi të bëjmë me një interes të ngushtë. Do të ngrihet kundër këtij projekti që për mendimin tim është antikombëtar.

Atë që nuk e kanë realizuar armiq të kombëtarë që ta copëtonin Dibren po e copëton sot me një vendim qeveria shqiptare, e cila pa biseduar me kërkënd, pa biseduar me specialistë ka arritur këtu.



**Ferzileta Gjika:**  
**NUK DO LEJOJMË TË SHUHET DIBRA NGA HARTA E SHQIPËRISË**

Është shumë e rëndësishme që të sensibilizojmë opinionin publik si brenda vendit edhe jashtë tij.

Këtë gjë e kemi nisur në Nju Jork me disa protesta dhe do të vazhdojmë edhe në Shqipëri në Evropë dhe gjithandej derisa të drejtat e njeriut, të drejtat e shqiptarëve të vijjnë në vend.

Projekti i ndërtimit të Skavicës është bërë në fshetësi, nuk ka asnjë lloj të dhëne online ose në media që të flitet për Skavicën dhe pavarësisht se nga përpjekjet e mëdha që ka bërë vetë populli i Dibres për tu dëgjuar në media, zëri i tij është shuar gjithmonë.

Dua të theksoj që ne nuk do të ndalemi, ne do të vazhdojmë me protesta paqësore dhe do ti çojmë deri në Strasburg çështjen ligjore.

Kemi marrë shumë përkrahje nga organizata të ndryshme jashtë vendit, në Evropë dhe në Amerikë, dhe ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me këto organizatave për të marrë ndihmën si ligjore si dhe nëpërmjet fondacioneve për ndihmë për tu organizuar dhe për ti thënë Jo Skavicës. Të shpëtojmë Drinin e bukur, të shpëtojmë atë vend të bukur që është Dibra, nuk mund ta shuajmë nga harta e Shqipërisë, nuk mund ta heqim

Organizatorët e mbrojtjes së Dibres nga hurdha e korrupsionit "Skavica" kanë përgatitur protesta paqësore, thirrje popullit dibran për rezistencë, thirrje dibranëve në Tiranë, Durrës, Kamzë, kudo që janë, në Shqipëri e jashtë saj, në mërgim, mbarë popullit shqiptar që ti thotë JO Skavicës, JO fshirjes nga harta gjeografike dhe historike e Dibres së 18 betejave me Gjergjin e Gjon Dibranit në krye kundër perandorisë më të madhe të mesjetës, perandorisë osmane. Intelektualë, juristë e dibranë me prestigj kombëtarë e ndërkombëtarë po përgatiten për një betejë, një aksion madhor për ta mbrojtur Dibren nga shuarja e saj.

Dibren nga harta e Shqipërisë.

Ne do ta mbrojmë Dibren.

U bëj thirrje të gjithë shqiptarëve që ta mbrojmë Dibren dhe të luftojmë kundër një gjenocidi të tillë masiv që ashtu siç tha edhe profesor Hoxha është e paimagjueshme se si mund të merren gjithëkëto vendime pa u ulur fare me dibranët dhe pa diskutuar asnjë lloj ligji.

\* \* \*

Beteja për mbrojtjen e Dibres po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha. Në tubimet elektorale për kryetarin e bashkisë së Dibres pyetja kryesore që u bëhet kandidatëve është: "A do ti thoni JO Skavicës?", "A do ti thoni PO Dibres?"

Banorët e zonës që zhytet dhe mbytet nga hurdha e Skavicës kanë shpallur se do të bojkotojnë zgjedhjet, nuk do të marrin pjesë në zgjedhje.

Patronazhistët thonë: "Punë e madhe. Edhe me dy vota zgjedhim kryetar bashkie!"

Organizatorët e mbrojtjes së Dibres nga hurdha e korrupsionit "Skavica" kanë përgatitur protesta paqësore, thirrje popullit dibran për rezistencë, thirrje dibranëve në Tiranë, Durrës, Kamzë, kudo që janë, në Shqipëri e jashtë saj, në mërgim, mbarë popullit shqiptar që ti thotë JO Skavicës, JO fshirjes nga harta gjeografike dhe historike e Dibres së 18 betejave me Gjergjin e Gjon Dibranit në krye kundër perandorisë më të madhe të mesjetës, perandorisë osmane.

Intelektualë, juristë e dibranë me prestigj kombëtarë e ndërkombëtarë po përgatiten për një betejë, një aksion madhor për ta mbrojtur Dibren nga shuarja e saj, nga zhdukja e saj, nga tjetërsimi i saj në hurdhë që hap e mbyll portat, që zbrazet e mbushet sa herë kanë nevojë hidrocentralet e kaskadës së Drinit e sa herë që përmbytet Shkodra.

Dibranët po bëhen të ndërgjegjshëm për tu futur në një betejë të madhe për ta mbrojtur Dibren, kësaj radhe jo me krismën e pushkës si 100 vjet më parë në betejën e Lanë-Lurës, por me zërin e fortë të demokracisë kohore.

10 shkurt 2022

analizë

# EDHE NJËHERË PËR SKAVICËN

**Çfarë janë S-443 dhe S-485 dhe cilat janë fshatrat që fshihen nga harta?**

Nga **ADRIATIK BALLA**, doktor i shkencave gjeografike.

**NË VEND TË HYRJES**



Kundër ndërtimit të Skavicës shprehen intelektualët, arkeologët, gazetarët, specialistët e çdo fushe, qytetarët e përgjegjshëm, thuajse i madh e i vogël. Pro tij shprehen dy-tre fshatarë të cilëve u kanë thënë se me ndërtimin e Skavicës mund të kultivojnë pafundësisht troftën (Salmo Trutta). "Peshq" të tillë që e kanë "karremin" ka në çdo vend, apo siç thotë populli "pyll pa derra s'ka", por kulmi i ironisë arrin kur pushtetarët nuk dëgjojnë zërin e ajkës së mendimit dhe qytetarisë në Dibër. Si ka mundësi që asnjë krah politik në qarkun e Dibrës, në garë për zgjedhjet e prillit, nuk e përmend Skavicën?

Në kohën e monizmit u bënë, për hir të së vërtetës, disa vepra të mira, përfshi këtu dhe hidrocentralin. Do të ishte ndërtuar edhe "Skavica", sigurisht, por edhe pse i frikshëm ai sistem kishte, sidoqoftë, logjikën e peshores (sa fitojmë e sa humbasim). Kam folur me inxhinierë që kanë firmosur për hidrocentralin e tjerë dhe thonë që ky projekt u la për një kohë tjetër, sepse, nëse ndërtohej, më shumë kishte humbje se fitime. Tani që politikës po i shteron retorika e dalë boje prej 30 vjetësh (tranzicion ekzemplar me pasoja të rënda për shoqërinë), del dhe një herë në skenë "Skavica". Dhe, siç ndodh zakonisht, pas këtyre projekteve fshihen plane korruptive e të errëta.

**DISA TË DHËNA PËR HIDROCENTRALET MBI LUMIN DRIN DHE PIKËPYETJET E SKAVICËS**


Hidrocentrali i Vaut te Dejës, vënë në punë në nëntor 1971, ka 5 agregate dhe një fuqi 250 MW. Prodhimi vjetor i tij është 1.1 miliard kilovatorë (Pano N., "Pasuritë Ujore të Shqipërisë", 2015).

Hidrocentrali i Fierzës është vënë në shfrytëzim në nëntor 1978. Ka fuqi të vendosur prej 500 MW dhe punon me 4 agregate. Prodhimi vjetor i tij është 1.8 miliard kilovatorë (po aty).

Hidrocentrali i Komanit filloi ndërtimin më 1979 dhe përfundoi më 1985. Ka fuqi të vendosur 600 MW dhe punon me 5 agregate. Prodhimi vjetor i energjisë është 2 miliard kilovator (po aty).

Nuk ka të dhëna të sakta se sa do të jetë fuqia e hidrocentralit të Skavicës, sepse deri tani është ecur me supozime e hamendësime ordinere. E njëjta gjë vlen dhe për hidrocentralin e Ashtës, deri tani imagjinar.

Hidrocentrali i Skavicës, për shumë arsye, nuk do të ketë prodhim që do të shpëtojë dhe zgjidhë përfundimisht çështjen e energjisë, prandaj këtu dalin disa përfundime e ngrihen



Detyrohen të shpërngulen mijëra banorë (afro 20 mijë). Edhe sikur t'u ndërtohet gratis një qytet, shkohet në kolaps, pasi kjo popullatë nuk është e përgatitur (kualifikuar) për treg pune tjetër nga bujqësia dhe blegtoaria, plus shërbimet që nevojiten kudo që t'i akomodosh.

## Më mirë një Dibër pa hidrocentral, apo një Shqipëri pa Dibër?

*Një prononcim brilant, shkencor e shoqëror.*

*Më erdhi në adresën time të ngushtë.*

*Po kush është Adriatik Balla?*

*Një njohës i fisit të tij më flet për rrënjë të kohës së Skënderbeut, për kontributin luftarak në betejën e Vajkalit në vitin 1465, rrënjë që vazhdojnë të jenë e të nxjerrin filiza e lulëzojnë në të njëjtin truall si shekuj më parë.*

*Adriatiku ka mbaruar universitetin e Tiranës në degën gjeografi me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 2015 mbrojt doktoraturën për të arritur në shkallën shkencore "Doktor i Shkencave".*

*Konkurroi disa herë për një vend në universitet por dyert nuk u hapën për një djalë Bulqize.*

*Profesorin e gjeografit e ushtron për kënaqësinë e tij duke qenë i pranishëm me*

*shkrime në revistat albanologjike.*

*Kësaj radhe erdhi në adresën time me një shkrim prestigjioz duke na sjellë një vështrim shkencor për luginën e Drinit të Zi dhe protestën e tij intelektuale që ajo të mos mbytet nga hurdha e Skavicës.*

*"Unë jam dibran, po bëj detyrën time. Shkruan në facebook. Nuk jam kundër hidrocentraleve, por jam kundër HEC-eve që shkatërrojnë mjedisin e sidomos atyre që shkatërrojnë Dibrën"*

*Le ta dëgjojmë këtë zë që me modesti e përfundon studimin e tij shkencor:*

*"Ky status shpreh mendimin tim personal, të bazuar në disa fakte. Mund të jetë një gjykim emocional, por nxitimi për të bërë projekte pa i analizuar mirë dhe pa marrë mendimin e banorëve është, në pikëpamjen time, abuziv."*

**A. Ashiku**

disa pikëpyetje që kërkojnë sqarim.

1. Hidrocentrali, nëse ndërtohet, nuk do të ketë prodhim të mjaftueshëm të energjisë elektrike që të plotësojë përfundimisht nevojat e vendit, kjo është më se e sigurt.

2. Nuk ka argument të mjaftueshëm që do të shpëtojë Shkodrën dhe Lezhën nga përmbytja, të gjithë ata që i mëshojnë këtij fakti abuzojnë.

3. Nëse vihet në balancë përfitimi ekonomik midis produkteve bujqësore e blegtorale krahasuar me hidrocentralin, peshorja anon nga e para dhe këtë e ka vërtetuar edhe sistemi i kaluar dhe specialistët seriozë të atyre viteve.

4. Mund të fitohet një hidrocentral me jetëgjatësi 100, 200 ose 300-vjeçare, por përmbytet një histori mijërvjeçare.

5. Kryesorja: Si do të mund të shpërngulen mijëra familje, si do të kompensohet dëmi i tyre ekonomik, ku do të vendosen ata, çfarë pune do të bëjnë?

6. Kush do të përfitojë nga hidrocentrali? Sa prej këtyre përfitimeve shkojnë në interes të publikut?

7. Cilat do të jenë pasojat (efektet) anësore fiziko-gjeografike pas ndërtimit të Skavicës, në aspektin gjeologjik-hidrogeologjik, gjeomorfologjik, klimatik, në florë dhe në faunë?

8. A është marrë parasysh mendimi i publikut? Nëse po, a ka pasur një referendum dhe cili ka qenë rezultati i tij?

9. Kush janë specialistët që kanë firmosur "pro", si i kanë emrat, ku kanë punuar dhe çfarë botimesh paraprake kanë bërë ata për këtë çështje. Cili ka qenë argumenti i tyre?

10. Më mirë një Dibër pa hidrocentral, apo një Shqipëri pa Dibër? - Të jesh apo të mos jesh, kjo është çështja.

**ÇFARË JANË S-443 DHE S-485?**

Për ndërtimin e Skavicës po qarkullojnë lloj-lloj variantesh, njëri me kuotë më të ulët, i cili do të ishte krejtësisht katastrofë pasi nuk do të kishte rendimentin e kërkuar si dhe një kuotë të digës më të lartë që do të shkaktonte një katastrofë akoma më të madhe, një fatkeqësi kombëtare, pasi do ta zhdukte luginën e Drinit të Zi. S-443 ose h=443 m është kuota (izoipsi) e projektuar e digës së hidrocentralit në variantin e parë. Kjo kuotë e sjell liqenin që do të krijohet mbi urën e Topojanit. Pra e pushton edhe grykën e Hoteshit, që ndan pellgun e Dibrës në jug nga ai i Peshkopisë (Dibrës së Poshtme) në veri. Me këtë kuotë zhduket Dibra e Poshtme.

Po S-485? h=485 është kuota (izoipsi) e projektuar për digën e Skavicës në variantin e dytë (sipas inxhinierëve partiakë pas 10 ose 15 vjetësh). Në këtë variant përmbytet komplet fusha e Gjoricës, aty ku është shkruar historia e Dibrës (kundër Hajredin Pashës), pra përmbytet edhe Dibra e Sipërme deri afër

**S-443 ose h=443 m është kuota (izoipsi) e projektuar e digës së hidrocentralit në variantin e parë. Kjo kuotë e sjell liqenin që do të krijohet mbi urën e Topojanit. Pra e pushton edhe grykën e Hoteshit, që ndan pellgun e Dibrës në jug nga ai i Peshkopisë (Dibrës së Poshtme) në veri. Me këtë kuotë zhduket Dibra e Poshtme.**

**Po S-485? h=485 është kuota (izoipsi) e projektuar për digën e Skavicës në variantin e dytë (sipas inxhinierëve partiakë pas 10 ose 15 vjetësh). Në këtë variant përmbytet komplet fusha e Gjoricës, aty ku është shkruar historia e Dibrës (kundër Hajredin Pashës), pra përmbytet edhe Dibra e Sipërme deri afër fshatit Bllatë.**

fshatit Bllatë.

I pashë me kujdes hartat topografike, një për një, dhe u përpoqa të krijoj vetë izoipsin e liqenit të ardhshëm në variantin e parë dhe të dytë. Nëse zbatohet edhe varianti i dytë është një fatkeqësi e madhe kombëtare, sepse praktikisht i bie të zhbëhet Dibra, zemra e atdheut etnik.

**VENDBANIMET QË ZHDUKEN NGA HARTA**

Ja disa prej fshatrave të njohur, të ndodhur pranë lumit Drini i Zi, që përmbyten nga "Skavica" (mos harrojmë se mbi këto kuota vihen në diskutim edhe shumë fshatra të tjerë që kanë tokën e bukës nën kuotën e digës, si dhe një brez 5-10 m lartësi mbi digë që bëhet i papërdorshëm):

-Draj-Reç dhe Zall-Reç (340 m)

-Zall-Dardhë (350-400 m)

-Lugjaj

-Shenlleshi

-Zall-Kalis

-Fushë-Cidhna (360-400 m), si dhe lagjet që shtrihen në anët e përrrenjve Shtumbat, Bllaç, Laçaj etj.

-Arrasi (370m)

-Mustafe (disa lagje)

-Kishaveci (390-500 m)

-Kandri (Fusha e Thatë)

(vijon në faqen 8)

“Hidrocentralet janë gjë e mirë, energji e pastër, por ato ndërtohen atje ku logjika ekonomike është e shëndetshme. Të përmbytësh Dibrën ka pasoja të rënda.”

## EDHE NJËHERË PËR SKAVICËN

(Vijon nga faqja 7)

-Vajmëdhën timer dhe Kalaj  
-Disa lagje të Sinës (vendlindja e Kastriotëve), 450-500 m  
-Bresti i Poshtëm dhe Fushë-Kastrioti (450-550 m)  
-Kuben dhe Rreth-Kalaj  
-Fushë-Muhuri (400-500 m)  
-Fusha e Brezhdanit (400-420 m tek ish-stallat)  
-Katundi i Ri (430 m)  
-Një lagje e Selanit dhe një lagje e Hoteshit  
Me S-485 dëmtohen edhe:  
-Gradeci dhe Kovashica (480 m)  
-Homeshi, Okshatina, Boçeva, Gjorica (450-550 m)  
-Izoipsi 500 m i afrohet fshatit Bllatë e Poshtme

### PËRFUNDIMI: “PO” HIDROCENTRALEVE, “JO” ATIJ QË VARROS DIBRËN

Hidrocentralet janë gjë e mirë, energji e pastër, por ato ndërtohen atje ku logjika ekonomike është e shëndetshme. Të përmbytësh Dibrën ka pasoja të rënda.

1. Detyrohen të shpërngulen mijëra banorë (afro 20 mijë). Edhe sikur t’u ndërtohet gratis një qytet, shkohet në kolaps, pasi kjo popullatë nuk është e përgatitur (kualifikuar) për treg pune tjetër nga bujqësia dhe blegtoaria, plus shërbimet që nevojiten kudo që t’i akomodosh.

2. Zhduken fshatra të tërë dhe krejt toka e tyre bujqësore dhe lugina e Drinit të Zi është nga më pjelloret e Shqipërisë. Një hidrocentral më shumë nuk është më mirë sesa një hambar më pak. Mos harroni, hidrocentralet kanë një jetëgjatësi të caktuar (sepse vjen një ditë e mbathen nga depozitimet), kurse fusha (lugina) është brez pas brezi.

3. Dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme lidhja shpirtërore e banorëve me zonën.

4. Varrosët historia e lavdishme e Dibrës, histori mijëra vjeçare, ku spikat si “Olimpi”, Historia e Skënderbeut, heroit të vetëm kombëtar të shqiptarëve. Nuk ka Skënderbe pa Dibrë e pa Dibrë nuk ka Shqipëri.

5. Në luginën e Drinit të Zi, nuk do të oshëtijnë më këngët e Azis Ndreut, Qerim Sulës e shumë e shumë artistëve me nam të kësaj toke, por nën mjegullën që do të krijohet dhe nga thellësia e liqenit do të dëgjohet vetëm zëri i bretkosave. Shpata e Kastriotit do të zëvendësohet me kallamat buzë kënetës. Këtu vdes dhe mbyllet historia.

### NË VEND TË MBYLLJES...

Që të mos dëgjojmë nesër bretkosat, duhet ta ngremë zërin sot, ndryshe “Skavica” e varros Dibrën. “Këshillat” se me ndërtimin e liqenit do të vijë jeta përrallore, me turizëm unik, peshkim fantastik dhe udhëtim bibliik, janë përralla që nuk i hanë as budallenjtë.

P.s. Ky status shpreh mendimin tim personal, të bazuar në disa fakte. Mund të jetë një gjykim emocional, por nxitimi për të bërë projekte pa i analizuar mirë dhe pa marrë mendimin e banorëve është, në pikëpamjen time, abuziv.

A.BALLA

# “JO SKAVICËS” në fletën e votimit



Pamje nga fshati Laçes, Fushë Alie, i cili mbytet nga hidrocentrali i Skavicës. Foto: Hajredin Toca

Nga **BUJAR KAROSHI**

Çështja e hidrocentralit të Skavicës ia ka dalë këtë herë të bëhet fjala kryesore e fushatës elektorale në Dibër, ndoshta për faktin se këto zgjedhje nuk kanë asnjë ndikim për Skavicën, as pozitivisht dhe as negativisht.

Dy kandidatët e së djathtës së përçarë e kanë futur këtë çështje në fushatën e tyre për sa më shumë vota, por në qoftë se ndonjëri prej tyre do të fitojë, ata nuk kanë asnjë mekanizëm ligjor për ta penguar.

Të dy kandidatët e së djathtës, pavarësisht vullnetit e dëshirës, e kanë të humbur betejën për kryetar të bashkisë së Dibrës.

Le t’i lëmë pasionet dhe dëshirat dhe të gjykojmë pak ftohtë:

Partia Socialiste e mori bashkinë e Dibrës në vitin 2015 me “përçarjen” që nxiti brenda të djathtës. Ajo përkrahu në prapaskenë tre aktivistë të së djathtës, që të kandidonin si të pavarur ose me partitë e tjera, duke arritur kështu t’i shkëpusnin të djathtës 1625 vota. Pas zgjedhjeve u pa se PS nuk kishte pasur nevojë për “tre” ndihmës, por vetëm për njërin prej tyre, një kandidat që vinte nga “zemra” e së djathtës në Dibër, në Bllaçë, aty ku PD kishte bastionin e saj.

Aktivisti i PD-së kandidoi përmes Partisë së të Drejtave të Njeriut ose ndryshe

Fituesi është paracaktuar, ndaj ktheni zgjedhjet në një referendum

Përballë “pakënaqësisë” që njerëzit nuk po dëgjojnë dhe nuk janë dëgjuar për Skavicën, kanë mundësinë që këto zgjedhje t’i kthejnë në një referendum për Skavicën. Pavarësisht se cilin kandidat votojnë, ata mund të shkruajnë në fletën e votimit “Jo Skavicës”. Me këtë zgjedhje do t’i bëjnë fletët e votimit të pavlefshme, por në qoftë se kjo mënyrë votimi është në shumicë, do të japin mesazhin se kundër Skavicës janë të gjithë bashkë, pavarësisht bindjes politike. Dibranët bashkë janë më shumë se PS dhe PD.

e njohur nga populli i facebook-ut si “Partia greke”, duke i hequr të djathtës 550 vota, mjaftueshëm për ta çuar PD në humbje.

Në vitin 2022, e djathta e ndarë më dysh, si me thikë, nuk ka nevojë për asnjë “sponsorizim” majtas, pasi e ka të sigurt humbjen.

Që votuesit dhe politikanët dibranë të japin një shembull se si duhet të jenë zgjedhjet në Shqipëri, kanë sot dy mënyra:

E para u takon dy kandidatëve të djathtës. Ata duhet të shkëputen nga “porositë” e qendrës, duke lidhur një aleancë mes tyre, në mënyrë që të kenë shanse për të fituar bashkinë. Kjo aleancë duhet lidhur që sonte. Nesër është vonë. Ky veprim do të ishte një mesazh për qeverinë, por edhe një mësim për shefat e “opozitës” lart.

Zgjedhja e dytë u takon qytetarëve. Përballë “pakënaqësisë” që njerëzit nuk po dëgjojnë dhe nuk janë dëgjuar për Skavicën, kanë mundësinë që këto zgjedhje t’i kthejnë në një referendum për Skavicën. Pavarësisht se cilin kandidat votojnë, ata mund të shkruajnë në fletën e votimit “Jo Skavicës”. Me këtë zgjedhje do t’i bëjnë fletët e votimit të pavlefshme, por në qoftë se kjo mënyrë votimi është në shumicë, do të japin mesazhin se kundër Skavicës janë të gjithë bashkë, pavarësisht bindjes politike. Dibranët bashkë janë më shumë se PS dhe PD.

Ndryshe, beteja për mbrojtjen e Dibrës është e humbur që tani. Dhe mos mallkoni, mos shani e mos fyeni, sepse fajin e kemi vetë, nuk na e ka askush.

Ansambli Artistik "Hazi Ndreu" – "Nderi i Kombit" fitues i dhjetra çmimeve të para e trofeve në disa festival kombëtare e ndërkombëtare

# Edukimi patriotik nëpërmjet kulturës dhe artit

Nga Muharrem GJOKA\*

Ansambli Artistik "Hazi Ndreu" – "Nderi i Kombit", i shndërruar tashmë në një institucion interpretues dhe përcues të vlerave më të mira kulturore-artistike, me repertorin e tij mjaft të larmishëm ka luajtur dhe luan rol edukativ për publikun e ri, sepse dashuritë e mëdha fillojnë herët e jo pas moshës 50 vjeçare.

Edukimi përmes kulturës ka qenë dhe është misioni i këtij ansambli. Dhe kjo jo me fjalë, por e konkretizuar në dhjetra festivale kombëtare e ndërkombëtare, ku është nderuar me disa çmime të para e trofe. Treguesi më i qartë për këtë është vetë emri i ish-partizanit të Brigadës së Parë Sulmuese, artistit famoz Hazi Ndreu që mban Ansambli, që si koreografi dhe kërcimtari virtuoz i valles dibrane ka mahitur mijëra shokë në Festivalin Botëror të Rinisë në Moskë (1957), ku merrnin pjesë 20 mijë konkurensë nga 180 vende, si dhe në dhjetra festivale kombëtare e ndërkombëtare, ndërkohë që botimet e tij studimore-shkencore janë referenca të mirëfillta për studjuesit e sotëm të historisë, traditës e etnokulturës. Referuar kësaj tradite, gjatë vitit 2021, ky Ansambël mori çmimin e parë në Festivalin virtual ndërkombëtar në Stamboll, në valle, këngë dhe instrument, ndërsa në Festivalin "Sofra Dardane" u vlerësua me Çmimin e Madh.

Me performancën e tij dhe nivelin e lartë artistik në interpretimin e valleve e këngëve popullore e qytetare, Ansambli u prezantua denjësisht në Festivalin e 14-të Ndërkombëtar të këngëve dhe valleve popullore në Kërçovë -Maqedonia e Veriut.

Dhe vetëm pas një muaj performoi shkëlqyer në Festivalin Ndërkombëtar "Saraj Fest 2021" në Shkup - Maqedonia e Veriut. Po ashtu artistët e këtij Ansambli shkëlqyen edhe në Festivalin "Kënga dhe Vallja Dibrane në Ulqin".

Këngët dhe vallet epike e lirike, të interpretuara mjeshhtërisht nga artistët e këtij ansambli kanë marrë vlerësimin e publikut edhe në Festivalin "Eshkë e ndezur mbi Shkelzen" (ku morën Çmimin e Parë); në Festivalin "International Folk Festival Tirana"; në Koncertin me rastin e marrjes së titullit "Lura Nderi i Kombit"; në Koncertin e fundvitit "Gëzuar nga Mot"; në Koncertin



e Madh festiv të RTSH "Urim i Bardhë"; në Koncertin me personalitetet e shquara të kulturës, artit, politikës e biznesit si dhe në Koncertin festiv në bashkëpunim me Bashkinë Dibër.

Ngjarje e madhe për Ansamblin Artistik "Hazi Ndreu" ishte marrja e titullit të lartë "Naim Frasheri", si dhe vlerësimi me titullin e lartë "Mjeshter i Madh" i presidentit të Ansamblit Z. Muharrem Gjoka dhe koreografit Avni Ndreu.

Në shfaqjet e organizuara herë pas here nga ky ansambël kanë performuar artistët: Arif Vladi – "Mjeshter i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut, Liri Rasha – "Mjeshter i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut", Vera Laçi – "Mjeshter i Madh", Zaim Tollja, etj.

Meritë të veçantë ka udhëheqësja artistike Earta Ndreu – koreografe dhe valltare e shumëtalentuar.

Krijimtaria e këtij ansambli, e ardhur nga ajka e kompozitorëve si: Përparim Tomçini – "Mjeshter i Madh" (pas vdekjes), Edmond Zhulali – "Mjeshter i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut", Kol Susaj –

"Mjeshter i Madh", dhe udhëheqja artistike nën drejtimin e "Mjeshtrit të Madh" Xhelil Ymeraj dhe mjeshtrit të koreografisë Avni Ndreu – "Mjeshter i Madh", ja kanë rritur vlerat dhe përmasat këtij ansambli duke i dhënë statusin e një ansambli kombëtar profesionist.

Ansambli ka performuar në disa televizione prestigjioze ndërkombëtare e kombëtare si: Rai Uno, Tv Romania, TRT Turk, RTK Kosovë, RTV Koha Tetovë, Top Channel, Vizon Plus, Tv Klan, TVSH, etj, ku janë dalluar për nivel të lartë interpretimi artistik këngëtarja dhe valltarja Erida Stana, valltaret: Fabjon Isufaj, Eralda Jaurri, Ergys Doçi, Kristijan Kavalli, Marsida Zhgjuni, Orinda Prenç, Rexhina Qerimi, Livia Bushpepa, Ledion Zhgjuni, Sara Ndreu, e tjere.

Ndërkohë arrijtjet e Ansamblit janë promovuar më së miri nga Mjeshtri i moderimit, gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv Defrim Methasani, si dhe nga publicisti e shkrimtari i mirënjohur Halil Rama – Mjeshter i Madh, autor i 20 librave me monografi, kritikë letrare e publicistikë.

Por, nëse Ansambli Artistik "Hazi

Ndreu" – "Nderi i Kombit" është bërë i njohur për dhjetra trofe e çmime mbarëkombëtare e ndërkombëtare, kjo i dedikohet parasëgjithash një emri të spikatur. Ai është Avni Hazi Ndreu, themelues dhe drejtues i këtij ansambli emërdritur, të dekoruar nga Presidenti i Republikës me Titullin "Naim Frasheri", me motivacionin: "Për veprimtarinë e shquar në mbartjen, ruajtjen dhe përsosjen e traditave, folklorit dhe trashëgimisë së çmuar etnokulturore të trevës së Dibrës. Me mirënjohje për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që ka shpalosur në skenat shqiptare dhe të huaja këngët dhe vallet tradicionale, veshjet koreografike si dhe meloditë e pasura burimore të shumë brezave dibranë". Kjo, për faktin se ky Ansambël është promovuesi i vlerave më të mira të kulturës sonë kombëtare, të cilat synon t'i pasurojë më tej në festivalet e takimet kombëtare e ndërkombëtare gjatë vitit 2022 të saponisur në start të mbarë.

\* Autori është President i Ansamblit Artistik "Hazi Ndreu" – "Nderi i Kombit". Mban titullin "Mjeshter i Madh".



# Bledi Cami, djali i Dibrës

Nga OSMAN XHILI

Dikur, një nga fëmijët e kopshtit të Breshjas, sot përgatit projekte prej qindra mijë eurosh, në ndihmë të këtij institucioni. E tillë qenka jeta, si një lojë shahu, që ka mundësi të pafundme për zgjidhje. Bledi kthehet pas në vite, kur hidhte hapat e parë të "Breshja", kur mëson-te këngët e vjershat feminare dhe i recitonte, në evente të ndryshme, bashkë me moshatarët e tij. Kur kapeshin për dore në vallet popullore, të përgatitur aq mjeshtërisht nga mësuesit e tyre. U dukej vetja në ato çaste se do bëheshin këngëtarë, se do bëheshin balerinë të famshëm, se do bëheshin dijetarë e patriotë të mëdhenj. Këndonin këngën e babagjyshit të vitit të Ri dhe deri vonë e besonin se ai vërtetë ekzistonte, se do të derdhte nga thesi i madh që mbante në kurriz, plot lodra të dashura për fëmijët.

Ja kështu i kaloi Bledi Cami ato vite të lumtura në kopshtin e fëmijëve, ku dhe pse e kishte mamin e tij, Mirelën, si edukatore, nuk donte të privilegjohej në mënyrë të padrejtë.

Fluturuan vitet shumë shpejt, tamam si ato fluturat krahëbukura dhe një ditë e pa veten në gjimnaz. Mësues kërkuar e profesionistë, por gjithsesi, të drejtë e korrekte. Shumë aktivitete bëheshin atëherë dhe Bledi Cami do të ishte përherë në qendër, duke dhenë më të mirën nga shpirti dhe talenti i tij. Bashkë me shokët vunë shumë drama në skenë, ku në njërin prej tyre ishte në rolin e shërbëtorit. Ju zgjua pasioni për të shkruar poezi, por dhe rrugën e romanit donte ta trasonte dhe pse ishte ende herët për ta realizuar. Gjuhët e huaja ishin një tjetër dëshirë e Bledit. Madje, nuk ishte thjeshtë dëshirë, por një domosdoshmëri për ti hapur fort në të ardhmen dyert e jetës. Mësoi gjuhën maqedone, gjermane, turqishten dhe anglishten. Ato do të ishin aleatë të mrekullueshëm, që Bledi të trokiste pa ndroje në dyert e fondacioneve të njohura, për të qenë pjesë e punës dhe bashkëpunimit me to.

Në atë kohë, jo vetëm gjimnazi, por dhe Pallati i kulturës në Dibër, ziente nga aktivitetet. Me programin "Blue Sky", të British Council dhe ambasadës britanike, çdo dy

javë bënin aktivitete të ndryshme, që vërtetë patën shumë ndikim pozitiv tek gjimnazistët. Aktorët e dikurshëm, jo vetëm që e kujtojnë me nostalgji atë kohë, por e ruajnë akoma shoqërinë e ndërsjelltë, dhe pse jeta i ka hedhur larg, në vende të ndryshme të botës. Të gjithë profesorët ishin të mrekullueshëm, por Bledi do të donte të veçonte Mirela Pustinën, mësuesen kujdestare, që i jepte gjuhën angleze, në të njëjtën kohë. Pjesët që ajo i jepte jashtë programit, rritën ndjeshëm aftësinë komunikuese të Bledit, por dhe anën gramatikore.

Shkollimin e lartë Bledi e kreu në Universitetin e Shkupit, për mjekësi, në degën e radiologjisë. As vetë ai nuk e kuptoi, se përse nuk vazhdoi për gazetari, letërsi, apo gjuhë të huaja, që i kishte aq pasion. Ndoshta ngaqë babai i tij punonte në këtë profesion human dhe donte që dhe i biri të ndiqte hapat e tij. Por, shumë shpejt, ai zuri shoqëri të re, njohje dhe angazhime të reja dhe nuk kishte më kohë ta peshonte problemin, në kishte vepruar drejt me zgjedhjen e degës, apo jo. Në fund të fundit vetë dallgët e jetës e kishin hedhur në këtë universitet dhe në këtë degë.



Me drejtoreshën e kopshtit të Breshias në Dibër të Madhe

Shumë shpejt e gjeti veten të angazhuar në disa projekte, me organizata joqeveritare, si "Youth centër", "Volunteer", "Kreativ" e të tjera si këto, që kishin të bëjnë me angazhimin e studentëve për të gjallëruar jetën universitare dhe për të qenë në të ardhmen aktivistë për lirinë, barazinë dhe të drejtat njerëzore.

Për të komunikuar sa më mirë me tyre, por dhe me publikun më gjerë, të rinjtë universitarë kishin hapur dhe një gazetë të titulluar "Voice". Pra ishte gazeta "Zëri", ishte



zëri i tyre, që kërkonte ndryshimin e shoqërisë, që ajo të bëhej më e hapur, më e çiltër, më humane. Bledi bënte rolin e përkthyesit të gazeta, nga anglisht në shqip. Përkthente pjesë që bënin fjalë për të drejtat njerëzore, për të drejtat gjinore, si dhe bashkëvëllazërimin mes popujve e kombësive të ndryshme.

Pas mbarimit me rezultate mjaft të mira të universitetit, Bledi Cami u mendua për një moment, se çfarë hapash do të hidhte më tej. Të ndiqte mjekësinë, apo ta kanalizonte gjithë atë përvojë të fituar diku tjetër. Cilëndo rrugë që të zgjidhte, ajo do të ishte në dobi të shoqërisë e të komunitetit. Ashtu si rastësisht, pa në internet një pozicion pune të një institucion arsimor dhe edukativ, shumë serioz europian, me qendër në Ankara. Quhej "Life long learning". Përvoja e Shkupit kishte qenë me shumë vlera për formimin e shumanshëm të tij, ndaj nuk e pati të vështirë t'i pranohet kërkesa pas aplikimit.

Programi "Erasmus", ku filloi punën e re kishte disa departamente, si Youth, School, Adult dhe Higher education, pra që presupozonte shkallët e zhvillimit të fëmijës, deri në formimin e tij të plotë. Pas fitoi një përvojë mjaft të mirë në departamentin e parë, Bledi Cami kaloi tek departamenti tjetër, ai i School Education. Vjen një moment që njeriu i kthen sytë nga vendlindja, sado larg të jetë e sado kohë të ketë kaluar. Ju kujtuan ato kohrat e bukura, që pati kaluar tek gjimnazi i qytetit të tij dhe mendoi të aplikonte projekte për të kontribuar sado pak në funksionimin më perfekt të tij, si nga ana studimore, ashtu dhe ajo edukative. Por, për probleme burokratike nuk qe e thënë, që këto fonde ti përfitonte ky institucion, ndaj mendoi t'i kanalizonte në drejtim të kopshtit të Breshias, aty ku kishte kaluar fëmijërinë e bukur dhe të papërsëritshme. Drejtoreshë Ajrie Dachi, si gjithmonë e gatshme për të bashkëpunuar me këdo që i sjell interesa institucionit, që ajo drejton, e plotësoi krejt në rregull anën e dokumentacionit, përse i takonte asaj. Dhe pse nuk e kishte kuadrin e plotë të punonjësve, në vitin 2017 u aplikua projekti i parë me dy tre edukatore. Projekti u titullua "Shpikësit e vegjël". Herën e parë nuk fitoi dhe u la në listën rezervë, pasi nuk ishin fituar të gjithë pikët e duhu-

ra. Një vit më vonë u aplikua sërish me të njëjtin projekt, pasi ishin parë e rregulluar disa pika të vogla. Pas zhgënjimit të lehtë të herës së parë, erdhi shpërblimi. Herën e dytë, projekti jo vetëm që u miratua, por mori dhe shumë vlerësime e lëvdata. Më pas gjërat u shtuan dhe u shumfishuan.

Një nga projektet e shumta ishte dhe ai për fëmijët me aftësi të kufizuara. Dy ishin qëllimet që do arriheshin. Së pari donim të jepnim mesazhin, që dhe ata janë si të tjerët dhe së dyti t'i ndihmonim ata në mënyrë të ndryshme, që të të ingranoheshin sa më mirë e më bukur në shoqëri. Disa aktivitete ata i kanë zhvilluar veças e disa bashkë me fëmijët e tjerë. Të gjitha këto risi e kjo punë me to është pasqyruar në një libër, që mund të shërbejë dhe si përvojë për kopshtet e tjera të republikës.

Një ndihmesë e madhe j'u dha kopështit të Breshias nga përfitimi i projektit për laboratorin dhe klasën eksperimentale. Kjo klasë ka katër pjesë, ajo e shkencës, e gjuhës angleze, e matematikës dhe ajo e teknologjisë. Atje bëhen dhe shumica e aktiviteteve, pasi klasa ka një monitor me prekje, tapet të vijëzuar e me ngjyra, si dhe teteknologji të fundit të shkencës, në dobi të mësimdhënies në shkolla e kopshte. Vlera e këtij projekti kapte shumë prej 23 mijë eurosh.

12 projekte të reja presin në radhë për tu aplikuar e vënë në zbatim. Po aplikohet për "Orf metodën", për muzikën, që fëmijët të mësojnë sipas nivelit të tyre. Një tjetër projekt është dhe ai bilingual. Kjo nuk ka kuptim që në një klasë të jenë fizikisht nxënës që flasin dy gjuhë të ndryshme, porse ato të njihen e të vëllazërohen, të njohin kulturën e traditat reciproke e për pasojë të jetojnë në paqe e në harmoni, si lulet në një livadh shumëngjyrësh.

Projekti për natyrën është një tjetër dhuratë që i bëhet kopështit të Breshias. Nxënësit njohin më në detaje natyrën që i rrethon. Mësojnë ta duan, ta vlerësojnë dhe të bëjnë përpjekje, që ajo jo vetëm të mos dëmtohet, por të zbkurohet akoma më shumë, duke e bërë kështu më bukur dhe vetë jetën e njeriut.

Nuk na ngelet tjetër, vetëm ti urojmë mbarësi në jetë këtij djali të Dibrës, që aq shumë po bën përpjekje, duke lartësuar veten, familjen dhe qytetin e tij të lindjes, ku hodhi hapat e parë dhe belbëzoi fjalët e para.



Me rastin e 7 Marsit, ditës së Mësuesit

profil

# Rexhep Hoxha - Mësuesi që takoi në Bulaçin malor "Lulin e Vocërr" në origjinal

Nga HALIL RAMA

Rexhep Hoxha, mësuesi dhe veprimtari shembullor, i cili shërbeu me përkushtim e devotshmëri, si mësues e drejtues në disa shkolla e institucione të rëndësishme të rrethit Dibër, këtë 7 Mars nuk do të jetë mes ish-nxënësve e kolegëve të tij të shumtë, që i donte dhe e donin aq shumë. Më 20 janar 2022, pasi vuajti nga një sëmundje e rëndë ai e humbi betejën me jetën. Gjithsesi, këtë 7 Mars ai do të kujtohet si mësuesi që para 48 vitesh (1974) kur u caktua të shrbente në shkollën e Bulaçi malor rrëzë Runjës hijerëndë e kreshnike (2048 metra mbi nivelin e detit), do të takonte këtu "Lulin e Vocërr" të Migjenit në origjinal...

Pasi kishte punuar 4 vite në Muhurr, në vitin 1974, për "punë të mirë e të palodhur" mësuesin me "njollë në biografi" e transferojnë në fshatin Bulaç, dy orë e gjysmë larg nga Muhurri, në një terren të vështirë. Atje gjeti njerëz mjaft të mirë dhe arsimdashës. Ai s'i harronte kurrë ato njerëz fisnikë e të dashur pavarësisht varfërisë së tejskajshme. I kujtonte plot respekt, Imer Lleshin, Rakip Loshën, Nazif Gjonin, Shefki Loshën, Halim e Zyber Bushin, Hasan e Sherif Loshën, Gëzim Bushin, Lazam Lleshin e të tjerë.

Nuk ndahej dot nga një histori e ndodhur në atë kohë që e bëri krenar për ata njerëz që jetonin me shprehjen e kahershme: "O Bulaç teferiq, bukë pak, e ujë hiç". Vërtet Bulaçi ishte fshat rrëzë malit të Runjës, por për çudi kishte vetëm një krua me një curril uji.

"Aty,- më tregonte mësues Rexhepi, - takova Lulin e vocërr të Migjenit në origjinal".

Nuk i hiqej dot ngamendja ish-nxënësi i tij Ismet Qamil Lleshi, i cili edhe pse ishte vetëm 4 vjeç, pothuaj çdo ditë, edhe kur bora ishte deri në gju, e priste në oborrin e shkollës këmbë zbatuar, vetëm me një këmishë të bardhë, në mes të borë për t'i thënë: "Mirëmëngjes mësues!"

E ai, mësuesi zemërgjerë, e merrte në krahë dhe e fuste në klasë pranë sobës.

Ata fëmijë, të cilët deri kur vajti mësues Rexhepi nuk njihnin as makinat (pasi nuk i kishin parë kurrë), u bënë shembullorë, madje me rezultatet e tyre në 8-vjeçare do të fitonin të gjithë të drejtat e studimit që vinin për shkollën Hurdhë Muhurr. Ai kujtonte si nxënës të tij të sukseshëm: Petrit Bushin (sot dekan i një universiteti në Prishtinë), Ramazan Lleshin (ish mësues e drejtor shkollë), Maliq Lleshin, Petrit Zhuzhin (ushtarak), Hysni Didën (ushtarak e bankier), Bukurie Bushin (zooteknike), Fazile e Abas Loshën (mësues me arsim të lartë), Laim Bushin (mjek), Besnik Didën (nd/mjek), Zabit Bushin (mësues anglistjeje) etj.

Një ditë, një pjesëtar i Ekipit të Gjeofizikës së Tiranës, që ishte stacionuar në kërkim mineralësh në Muhurr, i thotë mësues Rexhepit se kishte dëshirë të shkonte në shkollën e tij. Quhej Dash Dima dhe ishte nga Tirana. Para se të mbaronte mësimin, mësuesi mendoi të sajtojë një gjë të vogël sa për të shuar urinë disi. I dha 14 lekë një nxënëseje që e kish shtëpinë afër shkollës dhe i tha të blinte dy vezë, t'i ziejë e t'ua sillte tek shkolla. Vajza iku, por u vonua tepër. Mësuesi dërgoi një nxënëse tjetër që t'i thoshte vajzës të vinte shpejt. Nxënësja e dytë përgjigjet se dhe pak e do të vijë shoqja e saj. "Vërtet, pas pak, -tregonte mësues Rexhepi, - erdhi e ëma, një grua në moshë, me një tepsi të madhe në duar. Në tepsi kishte një tas gjizë, gjalpë dhe katër vezë të fërguara, një tas kos për t'u prerë me thikë, bukë nore ose persnek me miell misri gushtak të kuq, që



Në foto: Halil Rama dhe Rexhep Hoxha

sa e kishte nxjerrë nga pjekja, dhe një tas me makarona që ishin plot gjalpë.

"U ulëm me Dashin të hamë me shumë oreks. Si mbaruam, Dashi më tha: 'Në jetën time o Rexhep Hoxha, nuk kam ngrënë drekë më të shijshme se kjo...!'", tregonte mësues Xhepa. E kjo fisnike, që u solli bukën e përgatitur me gjithë zemër, qe gruaja e Nazif Lleshit. Ajo sot nuk jeton ndoshta, por mësues Rexhepi nuk mund të mos e kujtonte, qoftë edhe në shenjë homazhi.

Për dhjetë vjet sa punoi në Bulaç, falë punës së tij, nga ky fshat me 67 familje, mbaruan arsimin e mesëm profesional e të lartë 24 djem e vajza. E kujtonte me nostalgji mësues Rexhepi atë kohë, dhe thoshte se, kur gërshetohet dhimbja me respektin e dashurinë e njerëzve, vuajtja lehtësohet.

Dita e largimit nga ai fshat u shoqërua edhe me lot të përbashkët të mësuesve kolegë dhe prindërve. Ai e kujtonte atë çast si shumë emocionues. Ata ishin bërë njësh në atë kohë, i njihnin mirë hallet e njëri-tjetrit. Nuk i thonin pak, por plot 10 vjet. Mësues Rexhepi kishte hyrë pothuajse në çdo familje, kishin pirë kafe bashkë, kishin ngrënë përshesh me kos e me dhallë, ndonjëherë dhe petanik me hithra. E përcollën të gjithë atë ditë. ...

## KUR HIENAT E LUFTËS SË KLASAVE IA PRISHNIN GJUMIN MËSUESIT DHE SPORTISTIT TË TALENTUAR

Që në klasën e dytë të shkollës pedagogjike, profesorët Shemi dhe Lutfi Manjani spikatën talentin tij në futboll, e paraqitën te trajneri Vafsi Biçaku, i cili e provoi dhe e inkuadroi në ekipin e parë, në vend të Tomor Gjokës, që u lirua nga ushtria.

Në ndeshjen e parë me Elbasanin shënoi golin e barazimit. Në një ndeshje kupe, në Fier, thyen këmbën e djathtë, duke e lënë talentin dy muaj larg fushës së futbollit.

Me ndërhyrjen e z. Mentor Muça, pas kërkesës së shumë sportdashësve e emërojnë mësues në Muhurr.

Rexhep Hoxha vjen në shkollë me paterica. Ishte shumë energjik dhe i shkathët. E nxorri nga prapambetja menjëherë klasën që i dhanë, bëri emër si mësues i zoti dhe prindërit nxitonin t'i regjistronin fëmijët me mësues Rexhepin. Pastaj transferohet në shkollën 8-vjeçare Kastriot, ku punoi vetëm 6 muaj, pasi në mars 1967 e marrin ushtar në një repart pune, ku inkuadroheshin ushtarët me biografi të keqe (të persekutuarit). Pas ushtrie, në vitin 1970 filloi punën në shkollën e Muhurrit, pasi atje ia kishin emëruar edhe bashkëshorten, duke e larguar nga qyteti. I dhanë klasë të parë dhe disa orë fiskulturë në 8-vjeçare. Gjatë kësaj kohe filloi punën për ndërtimin e këndit të parë sportiv. Bashkëpunoi me Drejtorinë

e Minierës së Mermerit në Gurin e Kuq, të cilët e ndihmuan duke dhënë tuba metalike të skadua dhe saldatorin. Ishte këndi më i plotë sportiv në rrethin e Dibrës. Jeta sportive e fshatit u gjallërua shumë. Çdo pasdite kishte aktivitete nga të rinjtë e fshatit.

Mësuesi sportist Rexhep Hoxha ngriti ekipin e futbollit të Muhurrit, i cili konkuronte me sukses gjithë ekipet e kooperativave bujqësore. Ndjehej krenar, por askush nuk i dha qoftë dhe një falenderim. Hienat e luftës së klasave i shfaqeshin edhe në gjumë. Gjithë paraditja dhe pasditja e tij kalonte në punë pranë shkollës. S'mund të hapte gojën për asnjë arsye ndonëse kishte shumë aktivitete në atë kohë.

## MËSUESI SHEMBULLOR, REGJISOR I TALENTUAR I GRUPEVE AMATORE

Në vitin 1971 në Muhurr u ndërtua Shtëpia re e Kulturës. Mësues Xhepën, që kishte prirje regjisoriale dhe interpretuese e vënë të përgatisë një grup artistik për ditën e inaugurimit. E përgatiti shfaqjen me mësues e nxënës dhe u pëlqye shumë nga të pranishmit. Ai, i papërtueshmi, i talentuari, i vullnetshmi dhe i pasionuari për gjithçka, ngriti të parin grup folklorik me një pjesëmarrje të larmishme me burra, gra, të rinj e të reja; instrumentistë e valltarë shembullorë, duke i përzgjedhur nga të gjithë fshatrat e Muhurrit. Në konkurimin e qershorit të vitit '72, grupi i Muhurrit zuri vendin e dytë në nivel rrethi. Konkurimet bëheshin çdo vit, e ai ishte i detyruar për çdo vit të paraqiste grupin për konkurim. Punë e lodhshme dhe as që bëhej fjalë për pagesë. Kishte të drejtë të inatoj me veten, kur kolegët rehatoheshin në shtëpitë e tyre pasdite, ndërsa ai vijonte punën me aktivitetet në shtëpinë e kulturës.

Në vitin 1973, përgatiti ekipin e lojërave popullore për konkurim në rreth, ku Muhurri mori flamurin e festivalit. Ishte eveniment i rëndësishëm për shkollën dhe kooperativën bujqësore Muhurr, por përsëri asnjë vlerësim për drejtuesin e talentuar të këtyre aktiviteteve të shumta, ish kampionin në kampionatin e futbollit të vitit '73, e që kishte ndikuar që ekipi i Muhurrit të fitonte 4-1 në finalen me ekipin e Kastriotit. Muhurri u shpall kampion, e sigurisht në themel ishte puna e palodhur e këtij mësuesi. Rexhep Hoxha i dha Muhurrit aq shumë dije dhe kulturë me veprimtaritë që organizonte e udhëhiqte. E shihje herë pas here duke dhënë shfaqje me grupin, atje ku punonin brigadat e kooperativës. I kënaqte ato duke u dhuruar orë çlodhjeje dhe argëtimi.

Ajo që duhet thënë patjetër është se për 4 vite të punës së tij në Muhurr, jeta kulturore-artistike e sportive morën një gjallëri të paparë. Gumëzhinte çdo ditë këndi i bukur sportiv nga të rinjtë, gjëmonin aktivitetet artistike në shtëpinë e kulturës.

Një cilësi tjetër e mësues Rexhepit ishte lidhja e tij me librin. Lexonte shumë, lexonte çdo lloj zhanri që i binte në dorë. Nuk linte libër të ri pa blerë. E takova para disa kohësh dhe më tha se i kujtohej libri i parë artistik që kishte lexuar. Ishte novela e Gj. Gollsuorhit "Lulet e mollës". Biblioteka e tij kishte mbi 600 tituj librash.

Lexonte shumë dhe Besa, bashkëshortja e tij mësuese, që kishte shumë libra të verdhë të asaj kohe...

## KALVARI I MËSUESIT SHEMBULLOR, NGA SHUMBATI NË FUSHË ALIE

Pasi kishte bërë plot 10 vjet punë në Bulaç,

lirohet një vend pune në fshatin Rreth-Kale, prandaj mësues Xhepa i kërkoi sekretarit të Byrosë së Partisë që t'a ndihmonte të transferohej atje.

"Po, - i tha ai, - jam dakort, por s'do të të lënë qentë tuaj..."

Erdhi në Rreth-Kale, por iu vërsulën kolegët, duke dërguar letra biografike kundër tij, deri sa e pushuan nga puna. U deshën 6 muaj për t'u rikthyer në punë me ndihmën e miqve. Mësuesi me përvojë dhe i suksesshëm kudo që punoi, vuajti shumë shpirtërisht dhe moralisht. Pinte duhan gjithë ditën. Siç rrëfente ai vetë, shpesh zemërimi e shtynte t'i drejtohej kufirit me mendimin: ja vdekje, ja liri! Por zbrapsee kur mendonte sakrificën që gruaja kishte bërë për të; mendonte dy engjëjt e tij të pafajshëm dhe ndërronte mendim.

Pas 6 muajsh e emërojnë në Shumbat. Bënte 6 orë rrugë nditë. Vinte në shtëpi nga ora 9 e darkës. Më pas e dërguan në Fushë Alie, ku punoi 7 vjet. Kur vajti atje, menjëherë në fshat u hap lajmi se ka ardhur një mësues i mirë. Vitin tjetër vërsuhan prindërit për t'i sjellë nxënësit te klasa e mësues Rexhepit. Njësoj si në Bulaç, edhe këtu, ish - nxënësit e tij udhëtuan shumë mirë në rrugën e dijes.

Mësues Rexhepi kujtonte Muhamet Shehun, Roland Karoshin, R. Kacanin, Elona Karoshin me Nexhën, fëmijë shumë i urtë e i sjellshëm (siç është edhe sot), Artanin etj.

## "QYTETAR NDERI" I PESHKOPIË

Lëvizja Demokratike e gjeti në Fushë Alije. E ndiqte hap pas hapi dhe konstatoi se diçka po lëvizte në politikën shqiptare. Kishte mësuar pothuajse përmendësh shumë pasazhe nga artikulli i Ylli Popës "30 vjet kohë e humbur" dhe e deklamonte me shokët rrugës e nganjëherë dhe në autobuzin e Kalasë së Dodës. Po frynte era e lirisë dhe ai, si shumica e shqiptarëve, mezi e priste. Mësues Rexhepi që kishte hequr mbi kurriz kalvarin e vuajtjeve tejet të mundimshme, e priste me shumë etje lirinë.

Plasi revolta e studentëve në Tiranë. Vajza e tij ishte atje dhe i shkruan një letër prej 5 fletësh matematike duke shpjeguar gjithçka që kishte ndodhur ato ditë të acarta. Mësues Rexhepi e ruante me fanatizëm atë letër të shtrenjtë, kur ndër të tjera shkruhet: "Po shkruaj kaq gjatë babi, pasi e di që ti je shumë i interesuar për këtë situatë..."

Rexhep Hoxha mori pjesë në themelimin e degës së PD në Dibër dhe në Mars '91 u pranua anëtar i kryesisë së Degës. Punoj me shumë dëshirë e pasion bashkë me shokun e tij të ngushtë, Lavdrim Shehun për ngritjen e seksioneve të PD në gjithë zonën e Muhurrit e krahinave të tjera.

Mësuesi i kujtonte ato kohë me shumë emocione.

Sa ka vuajtur ai për lirinë, për demokracinë, për dinjitetin e personalitetin e tij! Vërtet kishte punuar arsimtar, por gjithë kohën kishte jetuar i ndrydhur, i frikur, duke e ndjekur pas hije e tmerrshme e luftës së klasave.

Pas fitores së PD, me 22 Mars 1992, ai emërohet në Drejtorinë Arsimore në Peshkopë si përgjegjës i kuadrit. Edhe aty e priste një punë e lodhshme. Një pjesë të madhe të mësuesve, ndryshimet demokratike i gjetën në vende pune shumë të largëta nga vendbanimi i tyre, si në Lurë, në Kala, në Reç, në Qafë Murrë, Zall Dardhë etj. Prandaj iu desh që për një muaj të bëjë studimin e kuadrit dhe t'i afronte afër vendbanimit të tyre. Plus kësaj, duheshin bërë dhe emërimet e reja, por ai e

(Vijon në faqen 23)

Romani rrok tema shumë të mprehta politike në mënyrën e tij si: krimet e komunizmit, vëllavrasja, dhuna, terrori psikologjik, diktatura, vendosmëria obsesive për t'i qëndruar besnik stalinizmit, shoqëria e nëpërkëmbjes së të drejtave të njeriut, angushtia e lirisë së individit. Këto tema të mprehta vijnë si një realitet në dialog të fuqishëm me atë që konsideron letërsia, letërsia e nivelit të lartë që operon me të gjitha mjetet e saj për të sjellë para nesh tabllonë e një shoqëri të tronditur.

Nga BASHKIM HOXHA

Që në fillim dua të them se "NGJIZJA E PAPËRLYEME" është një ndër romanet me të bukur, më të thellë, që sjell të plotë e të pjekur shkrimtarin Agron Tufa. Është një libër më i madh se sa rrok vështrimi im që nuk jam marrë me kritikë e studime letrare. Këto shënime që dua të ndaj me ju, i entuziazmuar pas leximit të këtij romani kaq tronditës, janë një ftesë për lexim.


Në fillim të romanit thuhet se ai i kush-tohet grave ruse dhe të huaja që ndanë bashkë me ne tragjedinë kombëtare. Më tej, këtë respekt autori ka zgjedhur ta shpreh më së miri përmes personazheve të skalitur, por mos prisni të lexoni thjesht një kronikë politike të atyre ngjarjeve dramatike që fati u ngjizi disa të huajve në këtë atdhe të tyre të dashurisë dhe urrejtjes.

**Sigurisht romani është dhe mund të lexohet si një roman politik.**

Por në këtë trajtim me ngarkesë dramatike të politikës që ka mundur të realizojë autori, politika nuk vjen drejtpërdrejtë si e tillë. Ajo vjen në një formë të përkryer letrare përmes historive njerëzore, vjen e ashpër, rëndon mbi fate njerëzish. Nëqoftëse do të bëjmë ndonjë krahasim, mund të themi se në këtë roman politika është kurdoherë e pranishme, ashtu siç rëndojnë retë e zeza në një kohë të keqe dhe shkaktojnë ngacmimin e plagëve kur koha do të priset. Autori na e sjell politikën, jo duke përshkruar retë, por duke u fokusuar tek dhimbja e plagëve, të plagëve që shkakton në fatet njerëzore politika.

Romani rrok tema shumë të mprehta politike në mënyrën e tij si: krimet e komunizmit, vëllavrasja, dhuna, terrori psikologjik, diktatura, vendosmëria obsesive për t'i qëndruar besnik stalinizmit, shoqëria e nëpërkëmbjes së të drejtave të njeriut, angushtia e lirisë së individit. Këto tema të mprehta vijnë si një realitet në dialog të fuqishëm me atë që konsideron letërsia, letërsia e nivelit të lartë që operon me të gjitha mjetet e saj për të sjellë para nesh tabllonë e një shoqëri të tronditur.

Autori nuk qëndron në sipërfaqe skematike të trajtimit të këtyre termave, ai ka shkruar në thelb të politikës duke e ndjekur atë në veprimet e saj, ka depërtuar deri atje sa në një mënyrë emocionale na ka dhënë të beftë se si e vënë atë në veprim instiktet njerëzore: njeriu, vazhdi-



## "NGJIZJA E PAPËRLYEME", një ndër romanet me të bukur, që sjell të plotë e të pjekur shkrimtarin Agron Tufa

misht njeriu është në fokus me thellësitë e ndriçuar dhe të erta të shpirtit.

Nuk është një politikë me terma të përditshmërisë, është një politikë së cilës i bëhet radiografia në zemrat e çfilitura te personazheve dhe kjo i jep dhunës, mungesës së lirisë përmasën e saj të plotë, tronditëse dhe neve na jep një vepër të realizuar artistikisht.

**Sa ç'është politik, ky është edhe një roman i fateve njerëzore dhe mund të lexohet edhe si një roman i fuqishëm dashurie.**

Historia e dashurisë së Ljuba Borisovnes me Martinin, treshja klasike Martin-Ljuba-Viktor i ka dhënë autorit mundësinë ta zërthet dashurinë, këtë ndjenjë të pasigureshme në raportet e saj filozofike me jetën, me individin, në dhënien kuptim të jetës së secilit personazh, që e përjeton dashurinë në mënyrën e vet, dikush të pastër, dikush

perverse, dikush tjetër obsesive në një përplasje të kudo gjendur të besnikërisë dhe të tradhëtisë.

Përsiatjet e Zinaidës pragmatiste, dyshimet dhe dilemat e Ljubës, (interesant është fakti që kapitulli ku flet Ljuba është ndërtuar me shumë pikëpyetje), perversion i hetuesit e i Nesho Dragoit, spekulimi e Dafinës që mjet të spuinllikut ka dashurinë, kompleksiteti i ndjenjës së Viktorit (kapitulli i rrëfimit të së cilit në ndryshim nga ai i Ljubës ka shumë pikëçuditëse, ashtu si veprimet e tij që janë pa dilema), përmasat dramatike të ndjesive që rëndojnë mbi fate njerëzish, të gjitha këto të marra së bashku, janë në tërësinë e vet një traktat sublim për dashurinë, duke e zërthyer atë në të gjitha planet, të zhgryer në jetën njerëzore dhe të pastruar në ëndrra qiellore.

**Ky roman mund të lexohet edhe si**

**Misteri i shtatëzaniës së Ljubës me dorëshkrimin e romanit "Pjella" të Martinin të munguar, teoria kuazi shkencore e latinistit Zef që ka njohur jetën në anën e saj më të errët në kampe dhe burgje dhe që rehatinë e tij të vërtetë e gjen midis librave, i japin kuptim metaforës së fuqishme të ngjizjes së papërlyeme, duke e shenjtëruar ndershmërinë dhe besnikërinë e duke goditur tradhëtinë dhe spiunimin dhe shoqërinë e dhunës dhe të terrorit ndaj individit.**

Që në fillim dua të them se "NGJIZJA E PAPËRLYEME" është një ndër romanet me të bukur, më të thellë, që sjell të plotë e të pjekur shkrimtarin Agron Tufa. Është një libër më i madh se sa rrok vështrimi im që nuk jam marrë me kritikë e studime letrare. Këto shënime që dua të ndaj me ju, i entuziazmuar pas leximit të këtij romani kaq tronditës, janë një ftesë për lexim.

**roman i besnikërisë dhe tradhëtisë.**

Tradhëtia ndaj komunizmit e Bashkimit Sovjetik, siç perceptohet nga njëra palë, besnikëria e palës tjetër ndaj stalinizmit, tradhëtinë e fshehta bashkëshortore, tradhëtinë e miqve përmes ndjesive të fshehta dhe spiunimeve, besnikëritë tinzare të miqve ndaj aparatit represiv, qëndrimi me dinjitet në hetuesi i njerëzve të ndershëm si Samuili, spiunllëqet e dashnoreve me shpirtra të shitur, vazhdimësia e pjellave për të kryer sërish krimet e etërve, janë dhjetra episode që e kundrojnë jetën njerëzore edhe si një raport të besnikërisë me tradhëtinë në interferencë të njera tjetrës.

**Ky roman mund të lexohet edhe si një roman misteri.**

Misteri i shtatëzaniës së Ljubës me dorëshkrimin e romanit "Pjella" të Martinin të munguar, teoria kuazi shkencore e latinistit Zef që ka njohur jetën në anën e saj më të errët në kampe dhe burgje dhe që rehatinë e tij të vërtetë e gjen midis librave, i japin kuptim metaforës së fuqishme të ngjizjes së papërlyeme, duke e shenjtëruar ndershmërinë dhe besnikërinë e duke goditur tradhëtinë dhe spiunimin dhe shoqërinë e dhunës dhe të terrorit ndaj individit.

**Ky roman mund të lexohet edhe si roman i fjalës së gdhendur letrarisht, i fjalës së zgjedhur me ngarkesë të madhe mendimi.**

Me fraza ku natyrshëm veprimi i vishet edhe meditimi i thellë dhe dialogu intelektual e jetësor, (shpesh herë filozofike dhe të shprehura në sentenca), me shkruarjen e pacipë deri në thelbin e gjerave: tek instikti, me historitë tepër të gjetura, që sjellin dhimbje apo gezime, me trishtime apo dyshime, ky roman zë një hapësirë të munguar në hierarkinë e letërsisë bashkëkohore dhe ngjitet në lartësitë e saj më të mira.

**Ky roman mund të lexohet edhe si të gjitha këto mënyra së bashku, si letërsi e mirë, letërsi e vlerave, ku një ndër vlerat kryesore është e vërteta dramatike.**

P.S.

Ka edhe një mënyrë tjetër për të lexuar këtë roman: duke vrarë mendjen gjatë leximit për të gjetur ngjashmërinë me njerzit që kemi njohur realisht në jetë. Po kjo do ishte mënyra më e padobishme, sepse në këtë mënyrë nuk do të shijonim dot të plotë mjeshtërinë e autorit në gdhendjeve dhe plotësimin e personazheve letrarë, do të humbnim magjinë e trillimit letrar e kapriçionit artistike që plotëson jetën dhe e kthen atë në letërsi të bukur e të fuqishme.

# “Fjalor nga e folmja e Bulqizës”

Shtëpia botuese “PRINT-AL” boton studimin shkencorogjuhësor të autorit Agim Demiri



Shtëpia botuese “PRINT-AL” nxori nga botimi librin “Fjalor nga e folmja e Bulqizës” me autor mësuesin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, Agim Demiri, i cili jeton e punon prej vitesh mërgimtar në Terni, Itali.

Lënda e këtij fjalori është vendosur në 310 faqe dhe përbëhet prej 4250 fjalësh vetëm të kësaj krahine, të mbledhura me kujdes gjatë kohës kur Agimi jetonte dhe punonte si mësues në Fushë-Bulqizë. Çdo fjalë shoqërohet me shpjegime gjuhësore, sinonimet dhe përdorime të fjalës nga shkrimtarë si Fishta, Dara, Kadare, Xoxe, Agolli, Kuteli, etj.

Janë fjalët që flet krahina e Bulqizës, të bukura, që tregojnë pasurinë e madhe gjuhësore të saj, që nuk ka vetëm krom si pasuri e nëntokës, por ka dhe etnografi të tillë shumë të pasur, ka dhe mundësi të mëdha turistike, ka dhe gjuhë shumë të pasur, ka dhe banorë të zot, që jetojnë bukur e këndojnë bukur, kërcejnë bukur, flasin bukur, jetojnë bukur...

Fjalët në libër autori i ka dhënë, të shpjeguara, të pajisura me shembuj si i flet krahina, duke bërë kështu një pasqyrim të një pjesë fjalësh që mund të humbin me kalimin e kohës, që brezat e rinj duhet t'i njohin dhe përdorin dhe që gjuha shqipe

duhet t'i bëjë pjesë të saj.

Autori paraqet në këtë fjalor fjalë që përdoren si emërtime vendesh, bimësh e drurësh, gatesash, veshjesh etj., që janë shumë të bukura dhe duhet të njihen dhe të gjurmohen më tej si një pasuri shumë me vlerë. Këtë lëndë autori e përshkruan në faqet e këtij fjalori në mënyrë të krahasueshme me fjalë të tjera me kuptim të njëjtë, apo të afërt që

fliten në gjithë krahinat shqipfolëse, apo që janë përdorur bukur nga autorë të ndryshëm, duke bërë kështu një “gjeografi-fjalor”, zgjedhje e re bashkëkohore kjo e botimeve tona gjuhësore, shumë e nevojshme për shkallën ku ndodhet hapja e gjuhës së folur shqipe në jetën tonë të përditshme shqiptare.

Fjalët që shpjegohen jepen të shoqëruara me shumë fjalë të tjera shqipe, që të krijojnë mundësi që ta kuptosh dhe ta shijosh më mirë kuptimin e saj dhe që bulqizaku të njihet me shumë fjalë të tjera me të njëjtin kuptim, ose me kuptim të afërt, që ka në gjithë krahinat tjera ku flitet shqip.

Ka mjaft raste që autori ka shënuar dhe shpjeguar fjalën, duke e shoqëruar me shprehje të bukura të kësaj krahinë, nga sasia shumë e madhe e tyre, që autori ka në arkivin e tij dhe që meritojnë të paraqiten si një botim me vete si pasuri shumë e madhe e kësaj krahinë. Në këtë fjalor autori ka dhënë në mjaft raste edhe shpjegime të mënyrës interesante të jetesës dhe të etnografisë së Bulqizës, duke e bërë fjalorin edhe më tërheqës për studiuesit përdoruesit e apasionuar.

Fjalori gjithashtu ka paraqitur në hyrje veçoritë fonetike të të folmes së kësaj krahinë, duke përcaktuar hollësisht afrim- largimet, që ka kjo e folme me gjithë gjuhën shqipe dhe që do të jenë bazë dhe do të ndihmojnë më tej studimin e gjuhës shqipe dhe të kësaj të folmeje si pjesë e saj. Nga të gjitha këto, mendojmë se fjalori do të jetë një libër i bukur dhe i vlefshëm për Bulqizën dhe të folmen e saj dhe që do të zërë vendin e duhur në bibliotekat e bulqizakëve e të studiuesve të gjuhësisë.

## Si krijova një fjalor...

Nga AGIM DEMIRI

Këto ditë doli nga botimi një fjalor me fjalë të të folmës së Bulqizës. Lexuesit do të gjejë të shënuar, të shpjeguar dhe të përdorur me shembuj nga krahina e Bulqizës për rreth 4250 fjalë shumë të bukura që tregojnë vlerat kulturore të kësaj krahine dhe janë të denja për të qenë pjesë e fjalorit të gjithë gjuhës shqipe. Krahas saj kam paraqitur në hyrje edhe një studim të hollësishtëm të veçorive fonetike të kësaj të folmeje. Këte fjalor e krijoi dashuria e madhe për të studiuar gjuhën shqipe që në fillimet e mia të mësimave shkollorë gjatë gjithë kohës. Lexoja, përfytyroja dhe përjetoja çdo gjë dhe përipiqesha të hyja në kuptimin e çdo fjalë. Kjo bëri që të krijoj zgjerim fjalori vit pas viti dhe lexim pas leximi. U shtua kjo në moshën e rritur, sidomos kur studiova për dramaturgjë, që i vihej rëndësi me një metodikë analizë shumë më të thellë, që e kishte tekstin dhe ti duhet ta bëjë tënden, duke e interpretuar, duke i dhënë mish e gjak. Gjatë studimit të mëvonshëm për mësuesin e gjuhës shqipe dhe letërsisë vura re se gjuha shqipe mësohej më tepër në formë teorike, rregull pas rregulli dhe nuk bazohej sa duhet të fjalës dhe studimi e kuptimi i saj. Po kështu nëpërmjet këtyre njohurive pashë se ajo që quhej gjuhë letrare ishte një gjuhë e tillë, që nuk përfshinte gjithë hapësirën gjuhësore, përkundrazi, ishte një gjuhë e drejshkrimuar, që ndryshonte shumë nga gjuha e folur e gjithë vendit dhe sidomos e Veriut. Gjuha dialektore e këngëve, që këndoheshin në gjithë vendin dhe e shumë autorëve ishte deri edhe krejt e ndryshme.

Gjuha bënte sikur bazohej te dialektet, por në fakt ndodhte krejt e kundërta: ndiqte gjuhën e tribunave të kongreseve. Shkruhej në gazetë se kishin folur njerëz të ndryshëm në të gjithë vendin, por fjala e

tyre nuk paraqitej, siç ishte shprehur, por e përpunonte gazetari dhe gazeta deri edhe duke e ndryshuar krejt. Studimet dialektologjike nuk ishin bazuar te fjala, gjeografi-fjalori, por te disa veçori të përgjithshme kryesisht morfologjike. Për të folmën e Bulqizës psh nuk kishte asnjë studim.

Në praktikën pedagogjike nuk ndiqej studimi i gjuhës shqipe si zgjerim fjalori, por rregulla dhe vetëm rregulla gjuhësore. Një rubrikën “Fjalë dhe shprehje” që ishte e posaçme për një gjë të tillë, në ciklin e ultë, ku me fjalë të ndryshme nxënësit të krijojnë dhe të mësonin të krijojnë fjali, duke qenë larg konceptimit të jetës së tyre në fshat (= kini parasysh Benin te filmi “Beni ecën vetë”), nuk zhvillohej dhe kontrollohej fare dhe nuk i vihej deri edhe fare rëndësi... dhe për pasojë nuk zbrëthente dhe mësonte nxënësit që të mësonin të shpjegonin kuptimin e çdo fjalë dhe të bazonin njohuritë gjuhësore te kjo.

Nga ana tjetër analiza e asaj që lexonin nuk bazohej në “studim teksti” dhe të çdo fjalë, por në nxjerrjen e idesë, disa ideve kryesore që duke dashur të përshtatëshin me kohën shpjegoheshin në përgjithësi dhe duhet të mbaheshin mend siç i kishtethënë mësuesi, por se çfarë thoshte tekstin dhe si i kishte përdorur fjalët nuk bëhej fare, siç kam parë tekstet e huaja. Thuhej nëpër të ndonjë figurë letrare, por edhe kjo jo duke i parë si kuptim fjalë, por si figurë letrare. Kjo e bënte gjuhën të vështirë për t'u mësuar. Në ciklin e lartë gjuha mësohej vetëm si rregulla gramatikore, sintaksore pa u bazuar fare te kuptimi i fjalës dhe as te asnjë lloj studimi teksti. Kjo bëri që t'i hyj që t'i mësoj nxënësit që të analizonin dhe shpjegonin kuptimin e çdo fjalë dhe bashkë me to, të gjurmonim shpjegimin kuptimor të çdo fjalë që lexonin, a kuptimin dhe të bëjmë “Studim teksti” për

**Në shenimet e mia u krijua një “arkiv” me folklor, përralla dhe gjuhë të folur të krahinës. E thellova këtë punë në mërgim, ku të folmën e Bulqizës e krahasova me shumë fjalorë dhe enciklopedi italiane e deri edhe Arbëreshe. Në këtë mënyrë përpunimi dhe ristudimi i çdo fjale, bëri që të përpiloj këtë fjalor me fjalë të veçanta të bukura të kësaj krahine, duke i shpjeguar dhe përdorur me shembuj.**

të kuptuar kuptimin e çdo fjale. Kjo bëri që në shenimet e mia të krijoj një “arkiv” me folklor, përralla dhe gjuhë të folur të krahinës siç flitej dhe t'i studioj. E thellova këtë punë në mërgim, ku përvoja e gjatë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe lënda e grumbulluar në të folmën e Bulqizës e krahasova për një periudhë rreth dhjetëvjeçare me shumë dhe studime dialektologjike, me shumë fjalorë dhe enciklopedi italiane e deri edhe Arbëreshe duke krijuar një fond fjalori të gjuhës shqipe për rreth 600.000 fjalë për të krahasuar me to fjalët e Bulqizës dhe fjalët e huaja në formë përqasjesh sinonime. Në këtë mënyrë përpunimi dhe ristudimi i çdo fjale, bëri që të përpiloj këtë fjalor me fjalë të veçanta të bukura të kësaj krahine, duke i shpjeguar dhe përdorur me shembuj. Në këte mënyrë është krijuar mundësia që këto fjalë të bukura të mos humbasin më dhe të jenë të shpjeguara duke u përqasur me gjithë sinonimet me to në gjuhën shqipe. Kjo do të bëjë që i riu bulqizak dhe më gjërë, të njihet, të njohet kuptimin e tyre dhe t'i përdore si pjesë e gjuhës shqipe.

Faleminderit dhe lexim të mbarë dhe me shendet që lexuesit e nderuar do t'i bëjnë këtij fjalori krahas librave të tjera të bibliotekës së tyre!

### BUJTINAT MIKPRITËSE



**BUJTINA KONAKU I DIBRËS**  
Vendndodhja: Tomin Tel: 0692053492  
E-mail: aminosalkurti@gmail.com



**BUJTINA E JUFKAVE**  
Vendndodhja: Peshkopi Tel: 069 937 7337  
E-mail: agro\_zerja@yahoo.com



**GUEST HOUSE SABRIU**  
Vendndodhja: Rabisht Tel: 069 511 4003  
E-mail: guesthousesabriu@gmail.com



**KULLA HUPI**  
Vendndodhja: Dushaj, Bulqize  
Tel: 068 837 3793  
E-mail: kullahupi5@gmail.com



**BUJTINA ARBRI**  
Vendndodhja: Arras, Fushë-Çidhën  
Tel: 068 650 6061  
E-mail: markuvladimir@yahoo.com



**GUESTHOUSE TERSHANA**  
Vendndodhja: Peshkopi Tel: 0218 20306  
E-mail: bujtina.tershana@outlook.com



**BUJTINA GOLECI**  
Vendndodhja: Rabisht Tel: 069 642 9888  
E-mail: fitimgoleci1@gmail.com

# Lavdrim Puci flet pak, punon shumë

Nga SHAQIR SKARRA

Thumana u trondit dhe pati tragjedinë më të madhe njerëzore nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019, i cili shkundi Shqipërinë dhe që më pasi lëkundjet e tij vazhduan të mbajnë në alarm të gjithë shqiptarët, sidomos në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës ku u shkaktuan shumë viktima, shumë të plagosur, dëme materiale.

Nuk ishte e lehtë ajo natë e trishtë e 26 nëntorit të merrije kurajon e të vazhdoje për në qendër të Thumanës, e mandej për në pallatet e dëmtuara, gërmadhat e të cilëve morën 24 jetë njerëzore.

Megjithatë, Lavdrim Puci, prind dhe familjar i mirë nuk mundi të qëndronte rehat në vilën e tij të bukur në Paskuqan e cila nuk lëvizti fare nga tërmeti. Ai u ngrit, nuk qëndroi më të shikonte lajmet, të dëgjonte britma e të qara në TV, por u vesh dhe u nis i vetëm për në Thumanë.

Dhimbja dhe tragjedia që kishte pllakosur atë qytezë të vogël u bë pjesë e pa ndarë edhe e Lavdrimit. Atë nuk e thirri kush nëpër natë, jo, telefoni i tij nuk ra. E thirri ndërjegjja e lartë, e thirri dhimbja e të tjerëve, e kërkonte morali dhe shpirti i humanizimit për të bërë diçka për këta njerëz që kishin shpëtuar dhe tashmë kishin mbetur pa strehë, udhëve të Thumanës, në mes të katër rrugëve, ku për mbulojë vetëm qielli u kishte mbetur.

Atë natë të tragjedisë së madhe udhët e rrugicat e Thumanës ishin plot me njerëz, aq sa Thumana nuk mban mend ndonjëherë të ketë patur. Dhimbja është shumëfish më e madhe. Të gjithë janë të hutuar, të shpërqendruar, të traumatizuar, mbase edhe me pikëpyetje të madhe: A mund ta kishim parandaluar këtë tragjedi?! A mund të kishim bërë më shumë për të shpëtuar të tjera jetë?! Pyetje të cilat për fat të keq, do t'i shoqërojnë për një kohë të gjatë.

Të gjithë ne në jetën tonë përjetojmë mërzinë, pikëllimin, zhgënjimin, apo dëshitim mirëpo duhet pasur kujdes që trazimi shpirtëror i shkaktuar nga këto mos të na kalojë në dhimbje. Këto shpërjetime a disfatë nuk duhet të na gjuhëzojnë përkundrazi duhet të na bëjnë më të fortë.

Dhimbja shpirtërore është një plagë e brendshme që askush nuk e shikon dhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë për ta sfiduar atë. Nga thyerja shpirtërore nuk rrjedh gjak, nuk shihet objektivisht ndonjë zemra është e "ndarë copë copë" dhe dhemb "thyerja", dërmon tërë trupin.

Ende nuk është gjetur një gips për zemrën e thyer. Ne të gjithë kemi një plagë të tillë, ndoshta edhe më shumë se një.

Ne megjithatë nuk duhet ta shohim atë si dobësi ose disfatë, mirëpo ta pranojmë si pjesë të qenjes sonë dhe të mësojmë nga ajo. Gjatë jetës sonë përballemi me shumë situata të vështira. Nganjëherë humbim personat e dashur, nganjëherë një diagnozë e sëmundjes së rëndë ose një fatkeqësi komunikacioni, nganjëherë fatkeqësi të përmasave të mëdha natyrore si kjo që ndodhi me tërmetin e 26 nëntorit 2019.

Lavdrimi e pa gjendjen në vend, e ndoqi nga afër cep më cep të Thumanës, nuk mjaftoi me kaq por vajti edhe në qytetin e Durrësit, në Bubq të Krujës, në Tiranë, në Kamëz dhe Paskuqan. Humbjet ishin të mëdha. Shumë veta kishin mbetur nën gërmadha, shumë shtëpi e pallate ishin shembur e bërë rrafsh me tokën, të shumtë ishin edhe ata që kishin mbetur jashtë pa strehë e pikërisht këtyre duhej u zgjatur dora e humanizimit.



Njerëzit e mirë dhe human janë shumë të ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve dhe bëjnë vepra të mira për të lehtësuar vuajtjet e atyre që i rrethojnë. Ky është një nga veprimet më themelore të mirësisë që njerëzit e mirë bëjnë si genie njerëzore. Dhe domosdo që për të tillë njerëz ka shumë nevojë komuniteti. Lumë kush i ka afër, lumë kujt i gjenden pranë.

Nuk priti shumë Lavdrim Puci që të bashkohej me vargun e gjatë të humanistëve, të atyre që do të solidarizoheshin dhe ndihmonin për këtë fatkeqësi të madhe natyrore. Zëri i arsyes e thirri dhe ai doli në skenë i vetëm së bashku me familjen, me fëmijët e tij, me mjetet e tij personale, me financat e tij.

Humanizmi bazohet nga thirrja e cilësive botërore, njerëzore dhe të arsyes. Pas humanizmit vjen toleranca (durueshmëria) paqja dhe liria e ndërjegjës, janë parimet më të rëndësishme për një jetë të përbashkët njerëzore.

Të jesh human do të thotë të mbash qëndrim njerëzor e fisnik dhe të tregosh dashuri të thellë ndaj të gjithë njerëzve. Zemra jote duhet të jetë e madhe dhe t'i nxërë të gjithë njerëzit, pa dallim. Të jeshë humanist do të thotë t'i duash njerëzit, t'u dëshirosh të mirën dhe lumturinë, të jesh i dhembshur me ta, të urosh udhëzimin dhe gëzimin e tyre.

Ajo që na bashkon me të gjithë njerëzit e tjerë, është pikërisht fakti që jemi njerëz dhe genie humane. Nuk ka gjë më të bukur se të kesh zemër të gjerë dhe të madhe, e cila i nxërë të gjithë.

Një zemër e tillë, kudo që të ndodhet mendon si t'u falë gëzim dhe lumturi të tjerëve. Ajo mendon për një nënë me jetimë, për një nevojtar si ta ndihmojë, për një të moshuar të braktisur, për jetimët në jetimore, për njerëz në fatkeqësi natyrore. T'u duash të mirën të tjerëve, do të thotë të shpresosh dhe të urosh udhëzimin e tyre, jetën e paqte dhe në siguri.

## JAM I LUMTUR KUR JANË TË TJERËT.

Lavdrim Puci atë natë sa e nisi misionin e tij human, do të vazhdonte gjatë, do të

punonte shumë, do të shpenzonte nga ekonomia e tij familjare për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve dhe motrave që u goditën nga kjo fatkeqësi e madhe natyrore. Mos edukon fëmijën të bëhet i pasur, por edukon të bëhet i lumtur, që kur të rritet, të dijë vlerën e gjërave dhe jo vetëm çmimin e tyre.

Njerëzit e mirë janë të lumtur. Lumturia nuk ka të bëjë me paratë, pamjen apo statusin. Njerëzit e mirë janë sinqerisht mirënjohës për atë që kanë, për atë që bëjnë. Shpesh lumturia e tyre është ngjitëse dhe mezi presin që ta shpërndajnë ashtu sikurse shpërndan edhe dielli rrezet e tij të argjendta në agim. Dhe Lavdrimi është njëri prej tyre, gjithmonë i lumtur për atë që ka, gjithmonë i pasur kur e shpërndan pasurinë tek njerëzit në fatkeqësi. "Nuk mund të ndjehesh i lumtur në shpirt e zemër, thotë Lavdrimi, kur nuk janë të tjerët, nuk mund të jesh i pasur kur nuk janë të tjerët. Unë për vete i lumtur jam kur janë të lumtur edhe të tjerët, i pasur jam kur shikoj se kanë edhe të tjerët".

Mëngjesi i ditës së parë pas tërmetit Lavdrimin nuk e gjeti në Tiranë. U bashkua shpejt me një grup inxhinierësh vullnetar të ardhur nga Greqia dhe vazhdoi gjatë në teren, duke i shkelur me këmbë të gjitha zonat e dëmtuara, duke bërë vlerësimin për to si ekspert i fushës së ndërtimit. Dhe Lavdrimi nuk mjaftoi me kaq. Jo, kishte më për të bërë, për t'u ardhur në ndihmë këtyre vëllezërve e motrave që dolën nga shtëpitë dhe filluan të jetojnë në çadrat e ngritura, për ta kthyer sado pak lumturinë në familjet e tyre, për ta zvogëluar dhimbjen, për t'u fshirë lotin në sy.

Së bashku me fëmijët e tij filloi disa ditë me radhë duke u futur në markete e supermarkete, duke mbushur trasta plot me ushqime e veshmbathje dhe duke i shpërndarë tek banorët e goditur nga tërmeti i 26 nëntorit.

Nuk ishin ndihma të ardhur nga shoqata e fondacione, jo, ishin të gjitha të blera nga kursimet familjare të tij, ishin ndihma që po i dhuronte me shumë dëshirë dhe me zemër të madhe duke e ndarë e përpjestuar ekonominë e vogël familjare së bashku me

vëllezërit e motrat që jetonin në çadër dhe pa asnjë mbështetje. Mund të themi se Lavdrimi ishte ndër të parët që filloi sa mundi të ndihmonte me ndihma ushqimore dhe veshmbathje.

Nuk mjaftoi me kaq. Për Lavdrimin ndihma dhe kontributi i sejcilit duhej parë disi ndryshe. Ndjenja e humanizmit ishte e madhe për Lavdrim Pucin.

Në Kamëz dhe në Paskuqan i piketoi tre banesa për ti ndërtuar nga e para. Nuk i njihte fare banorët që banonin më parë në shtëpitë që ishin prishur. Pa banesat e shkatërruar totalisht, pa familjarët, pleqtë dhe fëmijët e vegjël që ishin në çadër dhe me atë ekonomi të vogël që kishte vendosi që të ndërtonte jo një por tre banesa nga e para. Nuk i bëri për bujë, për tu dukur, për ti bërë vetes publicitet. Jo. Ndërtesat u ndërtuan në kohë rekord dhe familjarët u futën brenda duke uruar me shpirt e zemër këtë njeri fisnik që shkrin pasurinë e tij për tu ardhur në ndihmë të tjerëve.

Përsëri Lavdrimi u angazhua masivisht me kontributin e tij financiar për zbutjen dhe eliminimin sado pak të pasojave të rënda të tërmetit. Filloi të jap ndihmë edhe në meremetime e ristrukturime të pasojave të vogla në pallate. U bënë kaq kohë që e ka harruar zyrën, ka harruar dhe objektet e shoqërisë "Puci SHPK" Jo, e gjithë vëmëndje tij është përqendruar në pasojat e tërmetit.

Gjatë periudhës së karantinës nga korona virus 19, Lavdrimin do ta shikoje përsëri vetë derë më derë duke ndihmuar familje në nevojë e pensionistë të vetmuar në Paskuqan, Kamëz e Babru. Futej brenda, çonte pako me ushqime, nuk trembej fare nga virusi i tmerrshëm veçse ndjehej i lumtur kur munddohej sado pak të lumturonte të tjerët. I tillë është Lavdrim Puci, gjithmonë ka kërkuar që pasurinë ta ndajë me të tjerët se vetëm atëherë ndjehet i lumtur kur janë të lumtur dhe të tjerët.

## KUSH ËSHTË LAVDRIM PUCI?

Unë e njoh herët, e njoh se fshatrat tanë janë kufitarë me njeri tjetrin dhe shkollën e kemi të përbashkët.

Lavdrimi ka lindur në Venisht më 13 maj të vitit 1980 në fshatin Venisht në një zonë më përfaqësuese të njerëzve të mençur dhe të shprehur siç është zona e Ujëemujës.

Familje e tij herët një familje e mesme e me tradita të mëdha atdhetare, humane e mjaft mikpritëse dhe bujare. Këtë bujari e kanë shfaqur në kohë e periudha të ndryshme. Të parët e tij ndjenjën e humanizmit e kishin në gen dhe pa dyshim, Lavdrimi ka marrë shumë nga të parët e tij.

Pra Lavdrimi u rrit dhe u burrërua me këtë filozofi, e thënë më shkoqur që të vlerësojë gjërat, përfshi këtu edhe vetë pasurinë, jo nga çmimi, as edhe nga shuma e parave që ke dhe për vetë vlerën që kanë, por si dhe sa ndjehet i lumturuar, si dhe sa i mbushet shpirti e zemra për çka mund të të bëjë për ata që e rrethojnë. Sepse sipas vetë Lavdrim Pucit: "Ai që s'ka para është i varfër, por më i varfër është ai që s'ka gjë tjetër përveç parasë".

Shkollën fillore dhe tetëvjeçare e ka përfunduar në Shumbat, kurse të mesmen në Sllovë. Në Tiranë do të përfundojë Fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit me nota të mira. Vazhdon Master shkencor për administrim-biznes. Në kohën që ekonomia e tregut ishte legalizuar edhe Lavdrimi u bashkua me armatën e madhe të ndërtuesve duke marrë licensën dhe ngritur shoqërinë e ndërtimit "Puci Sh.P.K.", me seli në Tiranë



Lavdrim Puci duke shpërndarë ndihma pas tërmetit.

dhe aktivitet në të gjithë vendin. Në fillim e nisi me pak puntor e kuadro se i vogël ishte dhe kapitali i tij por më vonë u zgjerua shumë. Sot zotëron mjaft makineri të rëndë ndërtimi si fadroma, varinska, mjete transporti të rënda etj. Së bashku me specialist, administratë e puntor firma ka mbi 50 veta. Është i martuar me Nedimen dhe ka dy fëmijë: Leon dhe Hazbijen. Nga viti në vit "Puci Sh.P.K" është rritur, veprat që ka ndërtuar janë të shumta si: ndërtime shkolla, objekte kulti, apartamente banimi, etj. "Puci Sh.P.K" me administrator, inxhinierin. Lavdrim Pucin është lider në fushën e ndërtimeve në vendin tonë.

Kur gjykojmë rreth aftësive drejtuese e organizuese të Lavdrim Pucit, të mençurisë së tij, për zgjidhjen e problemeve të shumta që i dalin vazhdimisht përpara, të shumta e të komplikuar, me urtësinë që e karakterizonte ai dinte që ti zgjidhte të gjitha e t'ju jepte udhë. E vetmja mënyrë për të bërë punë të dobishme, ndoshta jo të mëdha, por që të jenë të mirë pritura nga njerëzit, është që ta duash atë që bën dhe të lodhesh e të sakrifkohesh për të arritur gjithçka. Lavdrimi i bëri dhe vazhdon ti bëjë të gjitha punët me shpirt dhe zemër. Ai është treguar kaq i aftë sa investoi që të ishte jo vetëm një sukses, por të qëndronte gjithmonë edhe një vlerë për të gjithë.

Është sot një fjalë goje të thuash "ai ka qenë i guximshëm dhe i vendosur qysh kur ka qenë i vogël", por kur "lexon" e gjykon jetën e një personi si të Lavdrim Pucit, njeriu qëndron për një çast dhe i thotë vetes: ky paska qenë i vendosur për të mbetur nga fillimi deri në fund të jetës së tij njeri i përunjur ndaj të vërtetës dhe i mirësisë njerëzore.

Të gjithë ata që e njohin dhe që e kanë njohur Lavdrim Pucin, flasin me plot respekt për të. Por ajo që ajo që zotëron tërë qenien e tij është guximi dhe iniciativa 'e çmendur' për të ndërmarrë iniciativa të mëdha, që për shumë njerëz dukeshin ëndrra të parralizuara, është humanizimi dhe njenja fisnike që ka për të ndihmuar të tjerët.

Dhe Lavdrimi është shumë i dashuruar me punën dhe me profesionin që ka zgjedhur. Lavdrimi dhe vetë familja e tij bëjnë diferencën për mikpritjen, për bujarinë, për njerzillëkun. Nuk ka pengesë që të ndalë njeriun, nëse ai ka vullnet. Në rrugë e sipër një njeri i vetëdijshëm për atë që bën, do të kuptojë se nuk do ti duhet as gjysma e forcës që ka patur ndërmend të përdorë.

Kur njeriu e di se sa e gjatë është udha, dhe kur e çmon se jeta është e vështirë për të dalë faqebardhë në krye të saj, duhet të jetë përherë i përgaditur. Përvoja njerëzore ka çimentuar dhe dhënë prova se punët e vogla janë më me vlerë se punët e mëdha.

Vetë Lavdrimi është krenar për veprat e mëdha të dibranëve. Duke qenë se është shumë i pasionuar pas historisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas historisë së popullit të Dibrës, ai ndjehet tepër i lumtur për ata që kanë lënë paraardhësit e tij, por ai dëshiron që brezat e nesërm të krenohen me veprat që do të lëmë ne sot. Ndaj, mesazhi i tij është: "Çdo dibran, kudo që ndodhet ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve, përmes veprave me vlerë që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Mjaft dibranë kanë bërë emër edhe jashtë trojeve tona. Ne kemi vlera. T'i ruajmë pra ato, të mos i humbasim. Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën dhe veten".

## FLET PAK, PUNON SHUMË

Gjithë qenja e tij njerëzore lëshon vetëm mirësi e asnjëherë ligësi. Shihemi kur takohemi drejt në sy, në fytyrë mirësi rrezaton, vetëm çiltërsi ka në shpirt. I tillë është brumosur qysh fëmijë dhe kështu është ende sot që është bërë vetë prind. Kur bisedon me Lavdrim Pucin, ai flet qetë, me zë të ulët, me fjalë të kursyera, por me vend. Fjala e tij peshon por ja që nuk e thotë shpesh, e kursen. Është e gjitha kjo në natyrën e tij që shumë kush e kërkon këtë vrytyt të bukur njerëzor por nuk e kanë, sidomos në kafën e mëngjesit kur e rrufit qetë qetë e biseda rrjedh vetë dashje pa dashje edhe tek politika që në fakt është bërë më se e zakonshme kohët e fundit.

Lavdrimi të dëgjon me vëmendje, nuk të ndërpret kurrë e kur shikon se biseda merr rrjedhë krejt ndryshe ul kokën mendueshëm e hesht. Hesht aq shumë sa edhe ti që e ke përballë e kupton fare qartë se tashmë e ke shkelur disi në bisedë. Ai e ka qëmtuar fjalën si mendim, në jetë, e ka përkëdhelur atë dhe e ka vendosur në funksion të shprehjes së mendimit, të botës emocionale e shpirtërore që ka.

Lavdrim Puci megjithëse unë e njoh nga herët ashtu siç e thashë më lart, ai nuk ka nevojë që ta njoh unë, nuk ka nevojë as për të shkruar në gazetë megjithëse dëshira ime ka qenë e kahershme për ti thënë fjalët e mia ashtu siç është dhe e njoh në fakt por nuk më ishte bërë për mbarë pasi kafën e mëngjesit e pinë shpejt dhe nuk ka nge më të qëndroj gjatë në lokal por atje poshtë në zyrën e tij modeste, i zënë me projektet dhe ritmet e zhvillimit, orët dhe ditët e punës së tij kanë një matës tjetër, atë të ritmit me atë se sa punë bën "Puci Sh.p.k" brenda një dite.

Lavdrimi ka punuar pak në administratë, në bashkinë e Kamzës, pikërisht në drejtorinë e rindërtimit, drejtori e re kjo që mbulonte më së shumti dëmet dhe pasojat e tërmetit. Lavdrimi i priti të gjithë qytetarët, ata që kishin ankesa nga rivlerësimi i dëmeve dhe pasojave të tërmetit dhe dërgonte shkresa në Institutin e Ndërtimit ku të gjithë qytetarët nga pritja dhe zgjidhja e problemeve që u zgjidhte Lavdrimi mbetën të kënaqur.

Mëngjesi e gjen në zyrë por vetëm për pak orë, pastaj atje do ta takosh, mes puntorëve e specialistëve ku ngrejnë kokën lart objektet që ndërton. Lavdrim Puci gjithmonë është në lëvizje, ai e ka kapërcyer edhe vetë kohën.

Në zyrë projekte, aktmarrëveshje, kontrata puntorësh e dosje pa fund por aty gjen të sistemuara bukur edhe libra profesional por edhe artistik, poezi e romane, studime e histori të ndryshme. Të shumtë janë edhe ata libra që ka sponsorizuar vetë. Dhe kur ka pak kohë të pushojë, pa tjetër që do ia kushtojë librit. Jo vetëm lexon por edhe sponsorizon, edhe shkruan. Dhe Lavdrimi ka sponsorizuar shumë për librin, për artin dhe kulturën. Së fundi edhe vetë u fut në plejadën e studiuesve duke qenë vetë autor për librin që ka botuar për vendlindjen, se me vendlindjen Lavdrimi është i lidhur shumë. Te Lavdrimi e kanë gjetur derën çelëse dhjetra e dhjetra studiues e artistë që kanë patur nevojë për sponsorizime, dhjetra e dhjetra familjarë, të moshuar, fëmijë që kanë patur probleme nga më të ndryshmet si ekonomike ashtu edhe shëndetsore. Lavdrimi punon për vete, për familjen e tij por ndihmon edhe të tjerët kur janë në nevojë. I tillë është Lavdrim Puci.

## POEZI

# Vargje që gulçojnë nga dhimbja dhe tradhtitë tinzare

Nga SELMAN MEZIU

Dremitet njeriu nga pa gjumësia. Cfilitet populli nga tradhëtia. Ligështohet një popull nga krimet e shëmtueme plotë dhimbje. Del mbi të shumtat valë deti poetja reçiane nga fisi troci. Buçet së brendëshmi me vikamat dhimbje therëse. Arma e saj melhem shërues është poezia. Miranda Troci Derti din mjeshhtërisht të ulet kam kryq mbi poezinë e ta thur me plotë mjeshhtëri e intonacione.

E shqetëson së tepërmi plani ogurzi i qeverisë Rama mbi mbytjen e luginës së Drinit të Zi me anë të digës në Skavicë. Ajo hyn në shtigjet e thepsura të ngjarjeve. Aty dhe atje në kohë që rrokulliseshin tundueshëm nxjerr gurin e çmuar të qendresës e jetë gjatësisë, ku shkruan: "Një emër madh që koha dhe lufta se përhumbi..", E kjo është Dibra e vuajtjeve, e lufrave e "Një valë gjaku që oshëtin mbi dhimbjen..", Poeten e shqetëson deri në qelizën e fundit të shpirtit kjo që po përgatitet në dukje e nën mutaf. Mirë por ajo dëgjohet si ushtim luginash mbi dhimbjet në hullitë e historisë.

Megjithatë ajo e shqetësuar pa kufi, përsëri ngulmon të na bind me vargun e saj të thellë, kuptim plotë: "Kërcëllimë dhëmbësh që përtyp trishtimin..", Se rreziku është në shqem të derës e po të kërcënon e do t'a sjell vuajtje cfilite shpirtërore e fizike. Poetja me artin e saj të fjalës e shtrin këtë kërcënim në planin gjeografik e me mjeshhtëri e finesë ajo skalit vargun: "Shikim vrazhdë dy brigjesh që lëshon mallkimin.."

Vallë kush po të mallkon? Kush kërkon varrosjen e dibrës mijëra vjeçare. Poetja zbulon, armikun, hasmin, kërcënuetin, tradhëtarin. Lexojmë me kujdes se çfarë po përgatite prapa krahëve. "Erë tradhëtie të thurën pas shpine..", Kujdes! Dibranë jini vigjilent! Hapni sytë. Zbulojeni dhe demaskojeni duke i grisur maskën.

Pastaj, poetja del hapur. Ajo nuk përdor figura, por të çon te burimi i së vërtetës, te ato që po bëhen përgatitës të një kurthi ogurzi, zhdukje të trojeve të shejta, të peisazheve që vetëm stinët, bujku e pentari dibran, din ti ndryshojë. "Të bajlozëve pareli që kurrë nuk ngihen..", Pangopësia e tyre nuk ka as mëshirë as mendon për një shkretim të përgjithshëm. Jana këtu në shqipëri. Brenda nesh.

Poetja natyrshëm të çon me kujdes, plot llogjikë e fines vargu, në udhën e heroizmit legjendar dibranë, në lufrat e kuvendet historike në zgjidhjen e problemeve të luftërave duke mbrojtur këto troje e bërë zotër të tyre në udhë kalimet e shekujve. Ajo shkruan vargun: "Mos më quaj "fole e braktisur" dhe vend pa zot..",

Poetja e mbushur me urrejte, e bindur për forcën e mençurinë e dibranëve, i dalin nga thellësia e shpirtit vargjet: "Llogaritë e krimbura do tiu mbeten ngrirë. Se mbi këto valë ska biznes dhe lot..", Miranda si poetë, Miranda si patriotë, Miranda si dashuruese e vend lindjes nuk tundet nga istikami i saj, se fitorja mbi këto mbretër e bisha të pa ngopura është e sigurt, sepse është luftë e drejt ku dibrani ka dhanun provat në vargmalet e historisë.

Poezia "Zëri i heshtjes..", një nga poezite kushtuar tragjedisë që po ju përgatitet banorëve buzë drinas dhe disa poezi të tjera mbushur me kushtrim luftarak, me plotë hrozëm e dhimbje të thellë, kërkon me çdo kusht që të "zgjoj nga gjumi..", dibranët kudo që janë anë e kand lamshit të dheut për të mbrojtur trojet e tyre. Të lumte pena Miranda Troci Derti, poetja zemër zjarr!



Ashtu siç fitojnë, vëllezërit Naseri dinë dhe të japin nga kjo pasuri e fituar me mund e djersë. Naseri është president i kompanisë së tij, është president i klubit të futbollit për qytetin, është kryetar i një shoqate humanitare për njerëz në nevojë. Hera herës kanë bërë kontribute modeste dhe në Peshkopi për dekorimin e shkollave me bredha, apo ndonjë ndihmesë për fëmijë jetimë.

profil

# Familja e madhe Imeri

Nga OSMAN XHILI

Pak vite më parë, po ndiqja një emision televiziv në një nga kanalet e Kosovës. Moderator i emisionit po tregonte se si një nga biznesmenët e shquar të Kosovës, po plugonte me traktor në pronat e tij dhe po i bënte gati për mbjellje. Mos ishte një truk televiziv, mendova në fillim, njëfilmim sa për tu parë nga bota, një gjetje artistike? Më vonë u binda plotësisht se biznesmeni që ngiste traktorin ishte real dhe pa asnjë retushim. Ai e donte punën, mjetin, tokën dhe padyshim dhe njerëzit. Do ta kisha shumë për nder të njihesha nga afër me këtë njeri, të shihja si e nisi rrugëtimin e tij, si arriti deri këtu dhe ku mendonte të shkonte në të ardhmen, bashkë me familjen e tij të mrekullueshme. Fati e deshi që kjo të bëhej e mundur pak kohë më vonë.

Miku im i nderuar, Naser Imeri, është një nga tetë vëllezërit e kësaj familje të madhe. Po të shtosh dhe tre motrat, numri i tyre shkon në njëmbëdhjetë. Vendlindja e tyre është Dumnica e Epërme, në rrethinat e Vushtrisë. Fëmijëria e tyre ishte tejet e vështirë, si shumica e familjeve të asaj kohe.

Naseri tregon një histori të hidhur të fëmijërisë së tij. Ishte në klasën e dytë të shkollës fillore. Shkolla ishte shtatë kilometër larg dhe rruga gjithë baltë në dimër e pluhur në verë. Një ditë, mësuesi i tha të dilte para klase. Për një moment, Naseri nuk e kuptoi arsyen. Mësuesi numëroi arnat në rrobat e djalit dhe i dolën plot tetëmbëdhjetë. Djali i vogël që mërzhitur fort. Mallkoi fatin, kohët e vështira, natyrisht mallkoi dhe mësuesin, që e bëri objekt tallje para klase. Bëri një betim me veten e tij, se dikur do t' u tregonte se kush ishte në të vërtetë, e çdo të bëhej në të ardhmen. Të tjera e të tjera vështirësi e ndjekin atë dhe brezin e tij. Kujton rrugën e gjatë, plot 17 kilometra, që e bënte çdo ditë për të shkuar në shkollën e mesme. Ndonjëherë, mbante në duar kova djathi, që i shiste në qytet, për të kaluar familja me bukë.

Gjyshi i tyre u vra nga partizanët në masakrën e Tivarit, duke lënë djalin e tij, Shahinin, vetëm 12 vjeç. Dumnica e Epërme ka mbetur në histori si burim qëndrese e trimërie. Ajo nuk u shkel nga këmba e pushtuesit në luftën e parë botërore. Ajo nuk u shkel, pushtuar e nënshtruar, as në luftën e dytë botërore. As bullgari nuk arriti të hyjë këtu e ta mposhtë. Por një tjetër sprovë, tjetër sfidë duhej ta fitonte për të hyrë në histori, luftën ndaj serbit. Dumnica ndahet në tre pjesë, apo fshatra, Dumnica e Poshtme, e mesme dhe Dumnica e Epërme. Serbi arriti deri te ajo e mesit, nuk mundi të shkojë më tej. Qëaty kërcënoi, bombardoi e shkatërroi ndonjë shtëpi.

## LUFTA.

Nuk kishte si të ndodhë ndryshe, kur themeluesi i U. Ç. K së do të ishte një nga djemtë e familjes Imeri, Gani Imeri. Ai kishte shërbyer gjatë në ushtrinë jugosllave dhe i njihje mjaft mirë taktikën dhe teknikat luftarake. Në krah të tij u rreshtuan dhe dy vëllezër të tjerë, Bajrami dhe vëllai më i vogël, Qemal Imeri, atëherë vetëm 17 vjeç.

Duke qenë e mbrojtur dhe pothuajse e paarritshme nga forcat serbe, atje u strehuan gati 30 mijë refugjatë, si të thuash një qytet i tërë. Ishin tre muaj të pranverës së vitit 1999, një nga pranverat më të errëta, me më pak lule, me shumë trishtim e krisma armësh. Kush i ushqente dhe kush i furnizonte gjithë ato njerëz? Ndoshta komandant Ganiu do të më tregonte më shumë për luftën, por nuk arrita ta takoj. Ndoshta, kjo do t' i takojë ndonjë



rradhe tjetër. Drithi dhe mishi ishin ushqimet bazë për gjithë këtë popullatë, por kishte raste që gjërat u vështirësuan deri në ekstrem. Një mulli punonte pa pushim, duke bluar drithin që konsumohej nga njerëzit. Nënë Emineja, nëna e këtyre tetë lisave, qëndroi si një heroinë e vërtetë. Ata 30 mijë njerëz nuk i shilte si të huaj, por tamam si fëmijët e saj. Ajo nuk pushonte asnjë çast dhe siç tregon Naseri, ajo gatuante deri në 25 herë në ditë për këto njerëz. Jo vetëm kaq, por ajo u mbante gjallë shpresën se një ditë lufta do të mbaronte, se ata sërisht do të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe do të takoheshin me njerëzit e tyre, që ishin shpërndarë si zogjtë e korbit. E ç'mund të bënte ajo më shumë se kaq? Vërtetë, nënë Emineja nuk i kishte gënjyer. Ajo ditëerdhi si për ata njerëz, ashtu dhe për mbarë popullin e Kosovës, që fitoi përfundimisht lirinë, që e kishte vaditur me

lotët dhe gjakun e bijve të saj.

## NJË FILLIM I RI

Lufta mbaroi dhe duheshin parë mundësi të reja punësimi e jetese. Në vitet para lufte, Naseri kishte shkuar të punojë në Austri. Fillimisht, punoi si punëtor e më pas u mësua si specialist ndërtimi. Rrallë mund të fliste me familjen. Duhej të pronotonte dhjetë ditë përpara, pasi vetëm një person në qytetin e tyre kishte telefon. Pas lufte ai u kthye në vendin e tij. Vendi ishte shkatërruar tej e tej dhe nevojat për ndërtim ishin të shumta. Në fillim ndërtonte shtëpi për njerëzit, me fare pak mjete pune dhe dy tre ndihmës. Sa do të dëshironte të kishte një kompani të vetën ndërtimi, me shumë punëtorë e specialistë! Të ngrinte nga themelet, jo më një shtëpi, por një pallat me dhjetra apartamente të bukura. Kaluan disa vite të tjerë. U shtua puna,



u shtuan të ardhurat. Tashmë drejtonte një skuadër pune, pastaj një firmë dhe më vonë një kompani të vërtetë ndërtimi, që u emërtua "Ariani Company". U realizua ëndrra e dikurshme. Ai e pa veten president të kompanisë, por kjo nuk i'a rriti mendjen, por i shtoi akoma modestinë dhe vullnetin për punë.

Sot kompania e familjes Imeri ka një bilanc tejet të pasur me shifra. Dhjetra pallate të ndërtuara, me mijra apartamente. Personeli drejtues është mbi 30 veta, kurse numri i punëtorëve arrin në 350. Naseri ka një dashuri e respekt për punëtorët, pasi dhe vetë ka qenë i tillë. Ata janë që të gjithë të siguar dhe rroga mujore e secilit shkon nga 600 deri në 800 euro. Ka kohë që aktiviteti ndërtues i kësaj kompanie i ka kaluar kufijtë e Vushtrisë dhe po zgjerohet në gjithë Kosovën. Blloqe apartamentesh po ndërtojnë në Prishtinë, por dhe një kompleks shumë i madh e modern, me emrin "Amina", po merr formë në Mitrovicë. Do të ishte me fat ai njeri, apo ajo familje që posedon një apartament të kësaj kompanie. Hapësirat komode, parkingu, gjelbërimi dhe parqet e lojërave përr fëmijë janë gjithnjë të pranishme, duke e bërë më të këndshëm qëndrimin aty. Duhet theksuar se gjithëky aktiviteti i këtyre përmasave, nuk ka asnjë euro haram, apo të fituar në mënyrë korruptive. Asnjë tender shtetëror i fituar prej saj. Lehtësisht, vjen në mendje krahasimi me kompani fantazmë të vendit tim, që me tre ditë historik të tyre, fitojnë tendera njëqind milion dollarësh. Sa privilegj do të ishte, që çdo qytet në Kosovë e Shqipëri të kishte në gjirin e tij njerëz e kompani të tilla!

Sa shumë fakte e të dhëna ka për këta njerëz, që në vend të fjalëve e përgojimit, njohin djersën dhe punën e ndershme, në vend të gjuhës së urrejtjes, njohin vlerat dhe humanizmin për njerëzit në nevojë. Kompania e tyre zotëron dy fabrika të mirëfillta betoni, që plotësojnë nevojat e tyre të ndërtimit, por dhe për shitje tek ndërtues të tjerë. Veç tyre ata disponojnë dhe një fabrikë aluplasti për dyer e dritare, me materiale gjermane dhe që eksportohen në Gjermani.

Naseri na fton të vizitojmë zyrat e kompanisë "Ariani Company". Ata ishin në katin e dytë të një pallati gjigand. Mjafton të themi se kati i parë, me një sipërfaqe 4000 metër katror, ishin zyra dhe ambiente pune të dhëna me qera. Zyrat e kompanisë, të bukura, të pastra, mobiluar me shije e profesionalizëm. Ata ishin truri i kompanisë. Aty përpunoheshin planet, projekte, uebsajde, bilanci i shpenzimeve dhe të ardhurave. Shumë pjestarë të famijes Imeri, punonin aty, me kohë të pjesshme, apo të plotë. Agnesa, vajza e madhe e Naserit, punonte në kompjuterin e një

## histori

Luftëtari dhe qëndrestari,  
Bajram Bardulla

Nga MEVLUD BUCI

Historia e qëndresës popullore dibrane si ajo mbarëkombëtare i ngjan një galerie me plot thesare të çmuara. Sa herë kthen kokën pas nëpër vite e shekuj, çdo studiues befasohet dhe ka çfarë të thotë nga atdhetaria e atyre burrave të pamposhtur dhe shpirtstuih, që luftuan për flamur dhe tërësinë e trojeve shqiptare.

Këtu e dyzet vite më parë, në kuadrin e 100-Vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, botova shkrimin "Trim, ndër trimat dibrane", në gazetën "Ushtima e maleve", një shkrim kushtuar Bajram Bardullës, besimtar, filozof e prijës popullor, sheherli i Dibrës.

Pas kaq kohe ndjeva sërish se figura e tij kishte nevojë për një ndriçim të ri, si qëndrestar në ballë të betejave, gdhendur në kujtimet e brezave, në fakte të pamohueshme historike e veçanërisht në epikën popullore. Bajram Bardulla në këtë përvjetor të Lidhjes së Prizrenit u dekorua me medaljen "Për veprimtari patriotike", por drejtuesit monistë të Dibrës e shihnin figurën e tij disi shtrembër, për shkak të luftës së klasave, ndaj nuk bëheshin përpjekje për ta sje llë më të plotë figurën e tij. Edhe fisin e nderuar Bardulla e shihnin si të padëshiruar, si antikomunist.

Mbaj mend se kur u botua shkrimi im modest, më falenderoi Haziz Ndreu, Velo Cfaruku (kryeredaktor i gazetës), Kamber Faruku e Hysni Bruçi, studiuesi Iliaz Kaca etj. Edhe pse të shkruaje në atë sistem për figura të tilla ishte një guxim, kur cilido vërehej me lente dhe duhej të përballlej me një psikozë miope, se shkruaje për fetarët, unë sërish e ndjeja si një detyrim moral të shkruaja për këtë figurë të patriotizmit dhe të besimit, sepse figura të tilla janë poliedrike, të çmuara, thesare lavdie.

Bajram Bardulla u lind në një familje të shquar sherlerësh, më 1810 në qytetin e Dibrës. U rrit dhe u edukua përmes shkollës por edhe nga odat dibrane, me traditat e fisit dhe të familjes. Qysh në fëmijëri u mëkua me patriotizëm, ndaj sapo shkoi te dajat në qytetin e Dibrës së Madhe ra në kontakt me patriotët, bashkëpunoi me ta, që kur ishte në moshën 25-vjeçare. Qysh në betejën kundër urdive të Hajredin Pashës, në korr ik 1844 e deri në bëtejën e Nishit 1877, Bajrami u shqua si luftëtar besnik i çështjes shqiptare dhe i lirisë me mesazhin e tij që vjen nëpër kohëra: "Je besimtar, nëse nuk je atdhetar!"

Ai ishte bashkëkohës dhe bashkëpunues i Iliaz Pashë Dibrës, Molla Bajramit (Hoxhë Bucit), Sheh Zerqanit, Isuf Dodës, Isuf Bej Karasanit, pa e lëshuar armën nga dora. Bajram Bardulla qëndroi për çështjen kombëtare, duke mbrojtur Dibrën dhe kufijtë etnikë të popullit tonë,

të copëtuar padrejtësisht nga Fuqitë e Mëdha. Kur u vra Isuf Murrja (prijës popullor nga Hotesi i Luznisë) Bajrami u çoi fjalë bijve të Isufit (siç e dëshmon epika popullore e asaj kohe):

Merrni Luzninë e dilni në Qenok,  
Se do të shkoj në Shehër e t' nor  
nji top".

Bajrami ishte gjithmonë në krah të prijësve popullorë, qëndrestar i lirisë dhe burrë i karareve, kurdoherë i vendosur, i thjeshtë trim i provave ndër beteja. Si fakt që vjen nga gojëdhënat është edhe përleshja e këtij luftëtari në Kuben të Dibrës së Vogël (afër Peshkopisë). Bimbashi turk e kap Bajramin për jake të kopranës (kajukes), por Bajrami i bie dhe e godet, duke mos u trembur nga urdia turke.

Fjala dhe veprimtaria e tij, ngado që shkonte, zinte vend dhe linte gjurmë në ndërgjegjen e malësorëve. Si luftëtar, tashmë, ai ishte i shkëputur nga jeta familjare duke iu përkushtuar luftës. Mori pjesë aktivisht në betejën e Nishit, ku, ndonëse iu vra i vëllai, Sheh Fejza, luftoi si trim kundër serbo-malazeze.

Bashkëpunëtorët e tij si Isuf Prençi në Reç, Mustaf Mziu në Muhurr, po veçanërisht epika e poezisë popullore e ka përjetësuar figurën e tij:

N' Fushë të Nishit, mu ke ura  
Xherek paska Dibra burra.  
Sulmojnë llogoret pa kësula  
Pa kësula e pa jakuce  
Bajrami thret ta mbrojmë kët nuse  
Nusja jonë është vatani  
Bini burra ktij dn-dushmani.  
(Dosja 3, Muzeu i Dibrës).


Ndonëse ishte i goditur nga rënia e të vëllait, ai nuk e uli madhësinë e qëndresës, as hovin e sakrificës në emër të fitores e të flamurit.

Epika popullore, shpirti dhe mençuria e popullit nuk e kanë harruar Bajram Bardullën dhe qysh prej asaj kohe dhe sot, kjo këngë ngjan si testament i tij dhe si dekorata më e lartë për të.

Bajram Brdulla një burrë plak,  
Ban luftë me serb në Karadak,  
Bajram Bardulla ni trim si zana  
Ksi burrash rrallë le nana,  
U çue në kam e t' madhe briti  
Din Dushmanin e tronditi  
Kur u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, tashmë Bajram Bardulla ishte një luftëtar me emër, prijës popullor, i formuar dhe i kalitur në zjarrin e kryengritjeve të njëpasnjëshme, kundër pushtuesve turq dhe serbë. Ai u bë i dëgjuar në Dibër dhe në Prizren. Dhe ishte ndër atdhetarët më veprimtarë të Lidhjes. Deri në maj 1891, kur në moshën 81-vjeçare u nda nga jeta, ai nuk e ndau pushkën nga dora.

I paharruar do të mbetet takimi i tij me Abdyl Frashërin, i cili, kur ishte në Dibër, i dhuroi Bajramit një abetare me mbishkrimin: "Vetëm gjuha dhe pushka kanë me na ndritur kombin, kanë me na lanë të pavdekshëm nën hijen e flamurit tonë".

Ndonëse ka kaluar kohë nga ndarja e tij nga jeta, ai nuk harrohet, sepse ka lënë pas pasradhës fisnikë të fisit të Bar-



Bajram Abdulla Bardulla

dullëve si dhe miqtë e fisit bardulla si Dollmeni i Dibrës së Madhe, Sevdari i Deshatit dhe i Dibrës së Madhe, Shehu i Brezhdanit, Rexhepi e Kryemadhe në Grevë, Alku në Dohoshisht, Joniku i Kosovës, Shehu i Zerqanit e deri te Duka i Qafë Murrës e Nasufi i Maqellarës. Agolli i Dohoshishtit etj;nipa të nderuar Adnan Nasufi, Rustem Bardulla, Nezulla Shehu, Bajrami i Ri, Rasim Bardulla, Demir Fetah Bardulla, Sami Bardulla, Mitat Bardulla;burra të fisit, pasardhës të denjë, burra me karare e bujarë si: Musa i Parë, Dine Bardulla, Iliaz Bardulla, Rustem Bardulla, Dine Bardulla;intelektualë të shquar si:Agim Bardulla, Genc Bardulla, Bilbil Bardulla, Adriatik Genc Bardulla, Sul Bardulla, Rexhep Bardulla, Përparim, Flamur, Demir, HajredinBardulla etj.

Bijë të thjeshtë, besimtarë e të përkushtuar për jetën si HajredinDemir Bardulla i cili në moshën 63 -vjeçare u diplomua në fakultetin Ekonomik të Tiranës.

Bajram Bardulla e pasardhësit e tij janë një gjerdan i artë për Dibrën e kombin. Madhështorët e historisë, ndonëse i harrojnë presidentiët partiakë, mbeten drita e atdhetarisë, ata kanë në mbështetje historinë dhe muzën popullore.

Kënga popullore buçet me tërë madhësinë e saj duke e përjetësuar atë me shpirtin e tij luftarak:

Tunë moj e mjera Tunë  
Shumë nana ke lanë kërcunë,  
Nuse të veja vërtet kanë met  
Por burrat e tyre kanë met shahjat,  
Luftën e Najshit kush e bani  
Bajram Bardulla e Sufë Karasani.  
Për vëllanë e tij, Sheh Fejzë Bardulla,  
populli thuri vargjet:

O Bardulla i nanës arbnore, o kreshnik,  
trim i lirisë,

Në mejdan, mbajte në krah,  
Vlla Sheh Fejza, martir ka ra.  
Vlla Sheh Fejza martir ka ra,  
O kryetrim, bir dibrani,  
Veprat flasin, mbete kala,  
Bini burra, ktij din-dushmani.

Ende kumbon dhe mbetet si një thënie lapidare fjala e tij: "Bini burra, ktij din-dushmani", si një amanet i çmuar për brezat, për të mbrojtur lirinë, tërësinë tokësore, traditat dhe gënin shqiptar.

zyre dhe ndiqte vitin e parë të fakultetit ekonomik. Ajo na përshëndeti, la punën për një moment dhe na shërbeu me kafe dhe qerasje të tjera. Sa njerëz të thjeshtë e modestë! Në asnjë vend tjetër vajza e presidentit të kompanisë, nuk do tu shërbente vizitorëve, siç bëri ajo. Të lumtë Agnesa, ju lumtë të gjithëve, njerëz fisnikë të familjes Imeri!

## FERMA E DRERËVE

Vëllezërit Imeri për momentin nuk banojnë në fshatin e tyre, por ata kurrë nuk e harrojnë Duminicën e tyre të dashur, atje ku kaluan fëmijërinë dhe rininë e tyre, atje ku kaluan ditë të bukura e të trishtuara. Një ndërtesë e bukur trekatshe, e punuar e gjitha prej guri të skalitur, qëndron hijerëndë. Aty mblidhen vëllezërit në fundjavë, kënaqen e argëtohen, por dhe diskutojnë për planet e javës në vazhdim. Aty janë ndërtuar pishina, por dhe fusha minifutbolli, si një ilaç për të larguar stresin e javës.

Shpesh kemi dëgjuar të flitet për fermë lopësh, delesh, dhish, apo dhe kuajsh e diçka tjetër. Ferma e tyre është vërtetë e një lloji të veçantë. Para tetë vitesh vëllezërit Imeri menduan tësjellin drerë nga Suedia dhe Hungaria, thjeshtë për dekor e kënaqësi. 30 hektarë në fushë e në kodër u rrethuan me tel dhe drerët ishin krejt të lirë të lëviznin në këto hapësira të mbushur me pyje e shkurre të ndryshme. Vit pas viti ata lindën të vegjël, u shtuan dhe u shumuan e sot ferma ka mbi 600 krerë të kësaj specie tepër interesante. Naseri tregon se pesha e drerit suedez arrin deri në 350 kilogram. Thamë që kjo nisi për sport e kënaqësi, por krahas kësaj, mund të jetë dhe aktivitet fitimprurës. Drerët e rritur mund të thërren e konsumohen, duke pasur një shije shumë të këndshme, ndoshta më të mirë nga gjithë llojet e tjerë. Njëkohësisht, po shtohen kërkesat e blerësve pasionantë, për të pasur dy, tre, apo më shumë çifte drerësh në parqet dhe resortet e tyre.

Gjithë këtij numri në rritje të drerëve, i shërben një sipërfaqe prej 30 hektarësh, e mbjellë me grurë, misër, elb dhe kultura të tjera. Në kohën e lirë, Naseri vetë, merr traktorin dhe plugon, frezon, apo mbjell këto sipërfaqe toke, duke kujtuar me nostalgji, por dhe me dhimbje, ato kohra kur punonin me kuaj e me pendë qeshë.

Brenda kësaj sipërfaqe të rrethuar, vëllezërit Imeri kanë ndërtuar një liqen, ku drerët kridhen për tu pastruar e zbatimur. Jo vetëmkaq, por uji i liqenit shërben dhe si një rezervat peshku, duke pasuruar akoma më shumë menunë e familjes, me këtë ushqim bio. Kudo që të hedhësh sytë në fermën e tyre ka diçka interesante. Në krahun e një kodre të butë, me kundrejtim nga dielli, janë vendosur 100 koshere bletë, mjaltin e të cilave e përdor familja për nevoja të saj, por dhe qerasen miqtë e vizitorët e shumë. Pula, gjela deti e lloje të ndryshme shpendësh, janë gjithmonë të pranishme dhe në një numër të konsiderueshëm. Natyrisht, nuk mund të mungojnë në fermën e tyre dhe disa hektarë me pemë frutore, të gjitha llojeve, që gjenden në Kosovë, apo më tej akoma.

E kush nuk do t'i kishte zili arritjet e kësaj familje të madhe e të nderuar? Vështirë për tu besuar, që tetë vëllezërit Imeri e kanë të përbashkët llogarinë dhe pse numri i tyre në total ka shquar në 50 persona. E ku gjendet një model i këtillë, kur çdo ditë e më tepër, shohim raste që dhe dy vëllezër nuk flasin me njëri tjetrin? Cila vështirësi e sfidë, mund ti bëjë ballë një bashkimi dhe uniteti të këtij lloji të veçantë?

Ashtu siç fitojnë, vëllezërit Naseri dinë dhe të japin nga kjo pasuri e fituar me mund e djersë. Naseri është president i kompanisë së tij, është president i klubit të futbollit për qytetin, është kryetar i një shoqate humanitare për njerëz në nevojë. Vetëm para pak muajsh, bashkë me dy miq të tij, ndanë pesë mijë euro për operimin në Turqi, të një vogëlusheje nga Vushtria. Hera herës kanë bërë kontribute modeste dhe në Peshkopi për dekorimin e shkollave me bredha, apo ndonjë ndihmesë për fëmijë jetimë. Po sa raste të tilla ka në historinë e kësaj familje të nderuar, që dikur priti e përcolli me mijëra refugjatë lufte? Zoti e ndihmoftë, Zoti e bekoftë këtë familje të nderuar, që aq shumë ka ngritur prestigjin e saj dhe aq shumë po bën për komunitetin dhe njerëzit në nevojë!

# Lëvizja demokratike e Marsit 1922

Nga ZABIT LLESHI

Lëvizja e Marsit ishte një lëvizje demokratike e progresive që synonte të konsolidonte themelet e demokracisë të hedhura në Kongresin e Lushnjës.

Viti 1921 mbylli një etapë të rëndësishme në historinë e shtetit të pavarur shqiptar. Ai kurorëzoi luftën e popullit shqiptar për ruajtjen dhe konsolidimin e pavarësisë së Shqipërisë të tërësisë së saj territoriale<sup>1</sup>.

Kriza politike që shoqëroi shtetin e qeverinë shqiptare tregonte për demokracinë e brishtë shqiptare që e shoqëroi me antagonizma të fuqishme shoqërinë shqiptare në gjysmën e dytë të vitit 1921.

Qeveria e Xhafer Ypit ardhur pas rrëzimeve të disa kabineteve qeveritare ishte një hap mbrapa në jetën politiko-shoqërore të Shqipërisë u shpreh deputeti Stavri Vinjau në një nga mbledhjet e Parlamentit. Ahmet Zogu mbajti postin e Ministrit të Brendshëm. Ai ndaloi grumbullimet, mitingjet, pa autorizimin e xhandarmërisë ose të Ministrit të Brendshëm. U krijua Gjyqi i Lartë i Shtetit të cilin Zogu e përdori me mjeshtri për të gjithë kundërshtarët politikë. Aparatin e xhandarmërisë dhe policisë e vu në veprim për të mbështetur klikën e tij. Shfrytëzoi një ligj tjetër që miratoi këshilli kombëtar "Për djegjen e shtëpive dhe konfiskimin e pasurive" të të pandehurve dhe të dënuarve që arratisen<sup>2</sup>.

Natyrisht duke shprehur interesat e çifligarëve, feudalëve, të tregtarëve të mëdhenj kjo qeveri nuk mund të pajtohej me interesat e fshatarësisë që kërkonte tokë bashkë me liritë demokratike. Kështu pra kemi një kontradiktë që nuk mund të zgjidhej me paq, me marrëveshje, por vetëm me organizim nga ana e forcave demokratike përparimtare për rrëzimin e qeverisë së Xh. Ypit. Kjo qeveri për të mbijetuar zgjodhi, dredhitë, mashtrimet dhe masa represive për shtypjen e rezistencës që kishte filluar muaj më parë si në parlament, në fshat e qytet, ndonëse luftohej kundër ushtrisë serbe.

Me një urdhëresë më 8 janar qeveria vendosi, që popullsia shqiptare me detyrim të paguante taksat e prapambetura qysh prej vitit 1919, këstet e vitit 1921 bashkë me ato të vitit në vazhdim. Hyri në fuqi shërbimi ushtarak i detyrueshëm filloi aksioni për mbledhjen e armëve. Ahmet Zogu siç shkruan në kujtimet e tij Hoxha Kadriu donte të zhdukte parinë e viseve mbi Shkumbin dhe pastaj mbasi të mbetej fill i vetëm si sundues këtu t'i sillej Toskërisë e ta shtypte edhe këtë duke u bërë kështu një kryetar qeverie më autoritar se Esat Pasha.

Ahmet Beu nuk kërkoi të bëhet vetëm diktator. Qëllimi i tij ishte, mbasi e ka një fuqi të gatshme në dorë, të zhdukë armiqtë e tij personal si Aqif Pashën, Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Ramiz Dacin, Irfan Ohri etj.

## 1. BESA E SHENJTË

Dibranët vendosën t'u pëgjigjen flakë për flakë masave represive të Qeverisë. Më 15 dhjetor 1921 u mblodhën në kullën e Islam Spahisë në Lumë, Bajram Curri, Elez Isufi, Halit Lleshi, Sali Ohri etj, lidhën "Besën e Shenjtë" me qëllim që të pengonin ardhjen e Konservatorëve në Qeveri. Për zgjidhjen e krizës politike duam një Qeveri që do ndihmonte në rimëkëmbjen e vendit, zh-

villim paqësor të ekonomisë e vendosjen e lirive demokratike.

Jemi lidhur për me sigurue interesin e atdheut urtësisht" – thuhej në thirrjen që lëshuan Halit Lleshi e Sali Ohri menjëherë pas formimit të Besës së Shenjtë<sup>3</sup>.

Elez Isufi i kishte deklaruar Ismail Strazimirin "U besatuem me Bajram Currin që të marshojmë mbi Tiranë për me kërkue që të mblidhet Asambleja e Përgjithshme dhe të caktohet fati i popullit të ngratë<sup>4</sup>.

Në elitën patriotike të Lumës, Dibrës, Matit, Elbasanit, Tiranës, Shijakut, Kavajës ish përpunuar mendimi për një bashkim e koordinim të forcave që ishin në gjendje të mblidheshin rreth tyre për të zgjidhur 3 probleme.

1. Të ndaleshin ose ndërpriteshin ngatërresat, grindjet në parlament e jashtë tij.

2. Të ndërpriten abuzimet dhe shkeljet që bëhen nga elita politike në pushtet ndaj statutit të Kongresit të Lushnjës.

3. Të mblidhej Ansambleja Kushtetuese për normalizim e gjendjes në vend.

Për të realizuar këto u pa me vend të intensifikoheshin përpjekjet dhe të fillonin menjëherë e pa vonesë veprimet. Dibra shihet si një garanci dhe shpresë qoftë edhe me armë.

Më 28 janar 1922 në Malin e Dhoksit në besën e Mehmet Duriçit (Bulqizë), Ali Llanit – Martanesh, Bajram Zenelit – Tërnovë, u zhvillua një mbledhje ku erdhën Bajram Curri, Elez Isufi, Halit Lleshi, Ramiz Alliu, Destan Puca. Këtu u vendos të realizoheshin objektivat e lëvizjes për demokraci. Asnjë kompromis as me reaksionin e brendshëm asnjë tundim nga përkëdheljet e armiqve të jashtëm të vendeve fqinj.

Në ditët e para të muajit shkurt 1922 në Allajbegi në shtëpinë e patriotit Demir Kaja përsëri u mblodhën Elez Isufi, Halit Lleshi, Suf Xhelili, Murat Kaloshi, Dan Cami<sup>5</sup>.

Duheshin veprime konkrete pa humbur kohë, vonesa ishte në dëm të lëvizjes, sepse qeveria kishte marrë informacion e dijeni të plotë nëpërmjet emisarëve të saj në Prefektura e Nënprefektura (për Besën e shenjtë). Ajo dërgoi emisarët e vetë për mbledhjen e armëve në Dibër, Martanesh, Lumë, Elbasan, Çermenikë, Krujë, Kavajë, Shkodër etj. Shefqet Korça, komandant i operacionit për mbledhjen e armëve në Dibër e Martanesh më 22 shkurt 1922 në letrën që i dërgonte Komandës së Përgjithshme në Tiranë shkruante "Krerët e Dibrës", Elez Isufi, Suf Xhelili, Halit Lleshi, Dan Cami, Murat Kaloshi dhe dy a tre bulqizakë, kanë lidhur besën që të bëjnë një kryengritje kundër qeverisë<sup>6</sup>.

Ramiz Daci bashkë me Zija Dibrën, Dan Camin, Halit Lleshin, ishin protagonistë aktivë. Ato gjatë të shkurtit 1922 shkelën pothuajse gjithë fshatrat e Dibrës, takuan mjaft luftëtarë vullnetarë. Prijsat popullore biseduan në odat e kullave dibrane në Maqellarë e Kastriot, Grykë e Vogël, Çidhën e deri në Kullat e Elez Isufit në Sllovë për të koordinuar veprimet për aksion të përbashkët të armatosur<sup>7</sup>.

Patriotë të tjerë dolën në mbështetje të kësaj Lëvizje që në historinë e Shqipërisë njihet si "Lëvizja e Marsit 1922" si Luigj Gurakuqi, Mustafa Kruja, Abas Kupi, Hasan Prishtina, Aqif Pashë Elbasani, Lym Petrela, Hamit Toptani etj.

Më 1 mars nisi marshimi i kryengritësve në drejtim të Tiranës. Bajram Curri e mori drejtimin e parë Gjakovë-Tropojë-Kukës-Shkodër-Tiranë.

Në drejtimin Dibër e Epërme-Gollobordë-Martanesh-Qafë Priskë-Tiranë, forcat udhëhiqeshin nga Halit Lleshi e Dan Cami.

Murat Kaloshi do të sulmonte Peshkopinë për të marrë prefekturën (Pefekt ishte Sali Vuçiterni).

Elez Isufi u nis nga Dardha-Gjur Reç-Krej Lurë-Selitë-Krujë-Tiranë.

Një drejtim tjetër ishte Kavajë-Durrës-Shijak-Tiranë, nga Hamit Toptani, Lym Petrela, Bajram Xhani, Imer Delialliasi. Osman Lita një nga krerët bajraktarë kishte sinjalizuar për planin e lëvizjes së kryengritësve. Në Pukë dhe Çermenikë u zhvilluan beteja të ashpra me forcat qeveritare<sup>8</sup>.

Elez Isufi, Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, me 350 forca pasi kaluan Matin erdhën në Krujë, prenë linjën telefonike që lidhej me Tiranën. Në Tapizë u ndeshën me trupat qeveritare të komanduara nga Meleq Frashëri, i cili vritet në veprimet e para luftarake. Ushtria qeveritare u tërhoq dhe zuri pozicionin e mbrojtjes në Rrapin e Treshit. Elez Isufi u fut në Tiranë qëndroi në Kodër të Kuqe vetëm me forcat e tij. Në Borizanë erdhi Zija Dibra me 30 forca ndërsa Mustafa Kruja dhe Abas Kupi nuk kishin forca të armatosura me vete.

Me dibranët në Kodër të Kuqe u bashkuan Lym Petrela e Can Huqi. Shtëpia e Canit u bë baza e kryengritjes dhe selia e Elez Isufit.

Muhaxhirët i ndihmuan luftëtarët e Dibrës, i strehuan, u kujdesën për të plagosurit. Motra e Ramiz Dacit Meleqja e martuar tek Tërshanët u tregua mjaft aktive dhe humane në ndihmë të luftëtarëve dibranë në lëvizjen e Marsit<sup>9</sup>.

Qeveria reaksionare e Xhafer Ypit e trembur nga vullti i kryengritësve dibranë tregoi një çoroditje, një mungesë besimi. Në ushtrinë qeveritare: u krijua një anarki. Ministri lanë detyrat dhe shkuan në Elbasan, ndërsa Zogu qëndroi në zyren e tij në pritje për bisedime me Elez Isufin.

Halit Lleshi me Dan Camin mbasi kaluan Ostrenin u ngjiten në Martanesh, nëpërmjet Çermenikës zunë vend në Labinot-Fushë<sup>10</sup>. Ata u përballën me forcat e Ferit Frashërit në ndihmë të të cilit erdhi edhe Shefqet Korça. Aqif Pashë Elbasani sipas marrëveshjes duhet të mbështeste me luftëtarët e tij trupat e Halit Lleshit, por ata nuk morën asnjë angazhim në veprime luftarake ndaj trupave qeveritare. Aqif Pashës i kishte bërë presion prefekti i Elbasanit Abedin Nepravishta, pranoi të dilte jashtë qytetit me kusht që të mos e përcillnin me forcë<sup>11</sup>. Në këtë situatë Halit Lleshi u tërhoq në Qafë Priskë. Trupat e qeverisë u shtuan, me ata u bashkuan Ministri e Qeverisë Ypi bashkë me përkrahësit e Shefqet Vërlacit.

Elez Isufi qëndroi në Tiranë me luftëtarët e tij në pozicione luftarake në pritje të ardhjes së Bajram Currit e Halit Lleshit, Aqif Pashës e Hamit Toptanit, që sipas marrëveshjes do të marshonin në drejtim të Tiranës. Do të takoheshin me 8 mars në rrugët hyrëse të kryeqytetit për të sulmuar njëherësh atë.

Braktisja e aleatëve, mungesa e municioneve së bashku me përgjegjësinë që ndjente për fatin e kryengritësve e detyruan Elez Isufin të pranonte më 10 mars 1922 ndërmjetësinë e ministrit anglez në Tiranë Ajres për një zgjidhje paqësore të konfliktit. Elezi pranoi të hiqte dorë nga lufta e armatosur me kusht të mos merrej asnjë masë ndëshkimore ndaj malësorëve kryengritës<sup>12</sup>.

"Luftëtarët dibranë, - do të shkruante

gazeta "Liria Kombëtare" - e morën Tiranën me forcën e armëve, por e lanë atë si rezultat i ndërhyrjes së anglezit Ajres për ndalimin e luftimeve<sup>13</sup>.

Bajram Curri u ndal në Pukë mbasi Paria e Shkodrës nuk u përgjigj pozitivisht lëvizjes për të marshuar drejt Tiranës për përmbysjen e qeverisë e mbledhjen e Ansamblesë Kushtetuese. Ahmet Zogu kërkoi ndihmë përfaqësuesit anglez në Tiranë Ajres, për të hyrë në bisedime me Elez Isufin. Duke vlerësuar situatën e krijuar bashkë me mungesën e municioneve Elez Isufi nënshkroi armëpushimin me Ahmet Zogun. Më 11 mars u kthye në Dibër.

## 2. DISA MËSIMET QË DALIN NGA LËVIZJA E MARSIT 1922

1) Forca kryesore lëvizëse e lëvizjes së Marsit ishte fshatarësia mbi kurrizin e së cilës rrëmonte shtypja dhe shfrytëzimi i egër i bejlerëve dhe çifligarëve, shtresës së pasur të shoqërisë shqiptare. Ishte lëvizje antiqeveritare, antifeudale.

2) Qeveritë e ardhura pas Kongresit të Lushnjës nuk bënë asnjëpërpjekje për të vënë në jetë Programin e atij Kongresi, nuk e thirrën asnjëherë Ansamblenë Kushtetuese, e vetmja aspiratë që do të ndërtonte shtetin.

3) Lëvizja e Marsit ishte demokratike dhe përparimtare sepse në drejtim të saj ishin patriotë të luftës për liri e pavarësi, që kishin drejtuar lëvizjen kombëtare gjatë gjithë jetës siç ishin Bajram Curri, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Elez Isufi, Aqif Pashë Elbasani, Ramiz Daci, Dan Cami, Bajram Xhani, Hamit Toptani etj.

Lëvizja e Marsit nuk i arriti objektivat dhe qëllimet e saj për faktin se: a) i mungoi një program i qartë politik. b) Bashkëveprimi i udhëheqësve që drejtuan lëvizjen nuk ishte në lartësinë e duhur. c) Mungoi vendosmëria e plotëm që me çdo çmim të arrihej objektivi. d) Peshë kryesore e veprimeve luftarake i mbeti Dibrës e vetëm Elez Isufi dhe Halit Lleshi u angazhuan në veprime luftarake.

Fshatarësia e Shqipërisë së Mesme me gjithë mbështetjen nuk pati organizim e mobilizim si ajo e Dibrës. Udhëheqësit e saj mbeten vetëm vrojtues të situatës, ndër-morën veprime e angazhime spontane. Ata u treguan pasivë në kohën kur duheshin kryer sulme të shpejta për të rrethuar kryeqytetin nga të gjithë anët njëkohësisht. Kjo i dha lëvizjes karakter krahinor dhe jo gjithëpërfshirës.

Ajo që i sollli më shumë dëm kryengritjes ishte paqartësia politike e organizatorëve të saj, të cilin me qëllim që të rritnin "efektivin" e armatosur, pranuan që të merrnin pjesë edhe disa forca "antizogiste" si Mustafa Kruja, Abas Kupi të cilët nuk kishin asgjë të përbashkët me lëvizjen demokratike<sup>14</sup>.

Lëvizja e Marsit kishte synime ekonomiko-sociale, ajo synonte të frenonte politikën ekonomike të konservatorëve që me anë të taksave të reja rënduan gjendjen ekonomike të popullit. Populli i Dibrës do të thoshte Elez Isufi, është helmuar nga kjo qeveri, sepse ka vënë taksat të rënda dhe s'i le të qetë<sup>15</sup>.

Lëvizja e Marsit ishte një lëvizje e gjerë popullore që shënoi një hap tjetër përpara në luftën për demokraci e përparim. Ajo i dha goditje të fuqishme forcave konservatore<sup>16</sup>.

Synimi politik i lëvizjes së Marsit ishte siç konstatoi publicistika e kohës: t'i priste rrugën realizimit të ambicieve diktoriale të konservatorëve të cilët pasi shtinë në

KONCERT NË ITALI ME RASTIN E 8 MARSIT

# Djemtë e Dardhës rrojnë me këngën

Nga **BUJAR MUÇA**

Dy këngëtarë nga Zall Dardha ftohën në një koncert për 8 Marsin në Gjenova. "Djemtë Dardhës rrojnë me këngë", është titulli i një këngë kënduar nga brezi më i ri i këngëtarëve dardanë si Bledar Kaca, Gentian Dervishi e Mentor Topuzi.

Treva e Dardhës ka patur çdo kohë artistët e saj si muzikantin Muharrem Xhëdiku, Hazizi Ndreu, Lirie Rasha e Sajhe Poloshi, Qerim Sula e Sherif Dervishi, që më këngët dhe interpretimet e tyre i kanë kapërcyer kufijtë e Europës.

Këngëtarët e brezit të ri si Bledar Kaca, Manushaqe e Abas Kaca, Fation Dervishi, djali i këngëtarit Sherif Dervishi.

Krahas tyre dhe Gentian Dervishi e Mentor Topuzi janë dy emra që vitet e fundit po dalin fuqishëm në tregun muzikor, jo vetëm më kënga të bukura, por dhe më vlera artistike.

Mentor Topuzi vjen me shumë këngë, por këngët "Nusja më divan", "Heronjtë e Dardhës", "Këngë dasme" e disa të tjera.

Po kështu, Gentian Dervishi më një këngë "Sallat kurbet" në duet me Lirie Rasha ka në repertor dhe këngët "Cucë dernjanët", "Molla e kuqe" dhe "Tek-tek-tek" duet me këngëtarën Lindita Gjoka, apo kënga Reç e Dardhë.

Dua të veçoja duetin e Gentian Dervishi me Mentor Topuzin mjaft të suksesshme si te kënga "Sa e ëmbël fjala nënë", dhe së fundi "Këngë për 8 marsin" këto këngë dhe të tjera.

Ishin këto këngë një indicie që u erdhi ftesë për një koncert me rastin e 8 Marsit në Gjenova, Itali. Në këtë koncert, të organizuar së bashku me këngëtarin kurbinas, Ilir Laçi që jeton në Itali, do këndojnë dhe Gentian Dervishi dhe Mentor Topuzi, dy këngëtarë të rinj, një më një repertor të pasur me këngë.



dorë pushtetin në dhjetor 1921, s'donin me ndigjue zanin e popullit, s'donin Ansamblenë Kushtetuese<sup>17</sup>.

## 4. DEMOKRATËT PAS LËVIZJES SË MARSIT

Dështimi i Lëvizjes së Marsit 1922, (jo për faj të dibranëve) pati pasojë të rëndësishme për lëvizjen demokratike në Dibër e Shqipëri. Ndonëse sipas marrëveshjes së 10 marsit qeveria dhe ministri i brendshëm i saj ishin "pajtuar" për të siguruar lëvizjen e dibranëve në shtëpitë e tyre, nuk do të merrej asnjë masë ndëshkimore kundrejt drejtuesve të kryengritjes dhe pjesëmarrësve të saj.

Menjherher filluan spastrimi i aparatit shtetëror nga nëpunësit kundërshtarë si në qendër ashtu edhe në pushtetin lokal, prefektura, n/prefektura e komuna, sidomos në Dibër, Kosovë, Lumë, Mat, Elbasan, Durrës, Kavajë etj.

Pengesa të mëdha i bënë Elez Isufit me luftëtarët e tij në rrugën e kthimit në Lis të Matit, pasi kaluan Qafën e Shtamës dhe zbritën në malin e Germanit, dibranët i gjetën shtigjet e zëna nga forcat e armatosura qeveritare, prandaj çanë përpara me forcën e armëve<sup>19</sup>.

Ahmet Zogu me përkrahësit e tij spastroi aparatit shtetëror në qendër dhe në bazë nga kundërshtarët e tij politik dhe reagon ashpër kundër tyre. Ai urdhëroi çarmatimin e popullsisë edhe në viset kufitare me Jugosllavinë, nxiti Këshillin e Lartë t'u hiqte udhëheqësve të Komitetit "Mbrotja Kombëtare e Kosovës" mandantin e deputet në parlamentin shqiptar.<sup>20</sup>

Ndër të parat viktimë të Ahmet Zogut pjesë e obskurantizmit mesjetar e vrasjes mbas shpine, pabesisë, prej kriminelit duke fshehur dorën e vrasësve të patriotëve pa gjyqe, gjykime siç bënin dikur qeveritë apo pushtuesit e huaj osman, serbë, austriakë, bullgarë etj.

Me porosi të Ahmet Zogut disa ditë pas Lëvizjes së Marsit togeri Fiqiri Dine arrestoi në Peshkopi Ramiz Dacin dhe ia dorëzoi, gjoja për ta përcjellë në Tiranë, Shefqet Korçës, i cili pa kryer asnjë procedurë e vrau barbarisht (pas shpine) te ura e Qytetit pranë Valikardhës (Bulqizë)<sup>21</sup>.

Ahmet Zogu burgosi 500 vetë, vari e pushkatoi 52 patriotë, ç'mobilizoi 70 oficerë, pushoi nga puna qindra nëpunës etj.

Vrasjet vazhduan siç janë të njohura me patriotin e madh Avni Rustemin, Luigj Gurakuqin, Zija Dibrën, Bajram Currin për ta mbyllur me Hasan Prishtinën. Kështu mund të themi se regjimi feudoborgjez likudoi pjesën më të shëndoshë e demokratike të intelektualëve e patriotëve shqiptarë që luftuan me mish e me shpirt, me mendje e pushkë për demokracinë e përparim shqorëror.

Referenca:  
1 Milo Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, 1992 fq 143  
2 DUKA 2007, 138.  
3 Gazeta "Dita e Re", 10 maj 1922, f. 7.  
4 STRAZIMIRI 1931, 135-136.  
5 MURRA 1982 ("Gazeta "Ushtima e Maleve", 28 prill 1982, f. 3).  
6 AQSH, Fondi i M.P.B., 252, Dosja 13, 1922 dok. Nr. 6, 162, 1922.  
7 FRASHËRI 2012, 374.  
8 LALA 1982 ("Ushtima e Maleve", 31 mars 1982).  
9 VLLAMASI 2000, 284.  
10 VLLAMASI 2000, 283.  
11 Idem, 283.  
12 FRASHËRI 2012, 376.  
13 LALA 1982 (Ushtima e Maleve", 31 mars 1982)  
14 FRASHËRI 2012, 374.  
15 Elez Isufi, Gazeta "Puna e Korçës" 18 mars 1922.  
16 KORDHA 1996.  
17 Ora e Maleve", 19 korrik 1924.  
18 FRASHËRI 2012, 376.  
19 AQSH, F. 252, Dosja 1, viti 1922, f. 133.  
20 Histori e Shqipërisë, vëll. III, Tiranë 1964, f. 258.  
21 FRASHËRI 2012, 376.



# I përfalem mirënjohjes

Nga **MEVLUD BUCI**

Ky titull ishte planifikuar prej vitesh të ishte libri i 30 i botimeve të mia, por kjo përpjekje e arkivi prej 700 faqesh nuk u realizua, sepse mundi, djersa dhe përkushtimi im u shkri dhe u shkrymbua më 15 dhjetor 2021 në orën gjashtë të mëngjesit, në Lukanin tim të Katër Grykëve, rrëzë Runjës shekullore. Filozofi i kohërave, populli thotë: "Nuk del kur e mendon, burri rrëzohet dhe shkrihet, por ringrihet"

Vendosa ta bëj këtë shkrim për ata që më respektojnë, u përlëshën me flakët e shtëpisë sime, të magazinës, e duke shpërfaqur nderimin, shpirtin human e dhimbjen. Ata më dhanë ndihmë e kurajo, ata u gdhendën në altarin e shpirtit njerëzor. Ndaj dhe mirënjohja, nderimi e vlerësimi për ta mbetet gjë e çmuar.

## 1. JETA ËSHTË E SHKURTËR, LUM KUSH DHURON MIRËSI.

Në jetë njeriu provon dritën e djersës, bukurinë e besimit, rrezatimin e bujarisë, vlerat e shokëve dhe të miqve. Vetëm prova, vetëm shembulli flet më mirë se një mijë fjalë të bukura. "Një shembull në praktikë-thotë Sami Frashër -vlen më shumë se një mijë fjalë të bukura".

Vërtet, provat e fjalës e të dritës së shpirtit janë mirësia, sipas mundësive. Janë dhjetëra e qindra ata që jetuam me atë çfarë më ndodhi mua, më dhanë krah e zemër si: Tofik Meh-

met Totraku, Irfan Zebi, Islam Uka, Bajram Avdia, Sabri Laci, Dëfrim Methasani, Hali Rama, Bujar Karoshi, Ferit Fixha, Qazim D. Shehu, Bajram Canameti, Basir Bushkashi, Artan Dilaver Kurti, Hamdi Xhemal Hyska, e plot të tjerë. Ata thanë fjalët e shpirtit, urimet e mirësinë e zemrës.

S'ka kurrë në jetë më të çmuar se mirësia njerëzore, drita e zemrës dhe dashmirësia. Koha dhe jeta njohin shumë prova, shumë luftëra, vuajtje e dhimbje, gëzime, hidhërimi, ngjitje dhe zbritje, po një e vërtetë mbetet testament për gjurmët e jetës: Humanizmi, shpirtbardhësia.

Latini thotë: "Kujt nuk i dhimbset padrejtësia e tjetrit, mbron padrejtësinë në shkallë kombëtare".

Dëshmi e të vërtetës, dëshmi e shpirtbardhësisë ishte ajo që, bashkëfshatarët e mi, ish-nxënësit e mi, që se ata u përlëshën me flakët, me zjarrin. Drejtori i nderuar i shkollës së Lunarës Përparim Petrit Lica, Blerim Ahmet Totraku, Hamit Loka, Klevis Buci, Festim Lica e plot të tjerë. Bënë të pamundur, përmes akullit dhe borës, shpëtuan stallat e ngritura me djersë.

Shtëpia ime, bashkë me arkivin (punë gjurmuese 45-vjeçare) vërtet u shkrinë, por drita e shembullit të tyre ia kalon çdo zjarri, ajo mbetet flakadan i mirësisë njerëzore

## 2. SHTËPIA E ZOTIT DHE E MIKUT

Në urtësinë e Dibrës mëson se shtëpia është e zotit dhe e mikut. "më i çmuar se çdo

**Ky titull ishte planifikuar prej vitesh të ishte libri i 30 i botimeve të mia, por kjo përpjekje e arkivi prej 700 faqesh nuk u realizua, sepse mundi, djersa dhe përkushtimi im u shkri dhe u shkrymbua më 15 dhjetor 2021 në orën gjashtë të mëngjesit, në Lukanin tim të Katër Grykëve, rrëzë Runjës shekullore. Filozofi i kohërave, populli thotë: "Nuk del kur e mendon, burri rrëzohet dhe shkrihet, por ringrihet"**

thesar, është një mik bestar. "Miku i vërtetë jeton me hallin e mikut të sinqertë".

"Po të mos ishin provat në vështirësi nuk njiheshin shokët e miqtë në përditshmëri". Këto thënie na mësojnë plot të vërteta, ngajnë me bedenat e kullave, me gurët e shkrepave, me dritën e bardhësive. E kam për zemër të përmend emrat e të nderuarve Hysni Bodini, Isuf Miha, Luan Cemenja, Saimir Totraku, të cilët dhanë kushtimin për tragjedinë, ku shtëpia ime e bërë model mes malesh, me mund e djersë, u bë shkrymb e hi. Nuk harrohen gjithashtu Ilir Balili i Kuçit të Vlorës, Faik Xhani i Lisit të Matit, Hazis e Hasie Totraku, Vafsi Cibaku i Sohodollit, Mentor Irfan Jashari, Ahmet Sharë Totraku e qindra të tjerë,

Në këtë nderim nuk harrohen Mensur Murja, Bilbil Bardulla Gani Lleshi, Besnik Buci. Esat Lica, Remzi Fida etj.

Janë gdhendur në gur fjalët e mirësisë të të nderuarve Sabri Karoshi e Haki Përnezha të Çidhnës të mençurisë, të të shquarve Ahmet Çausi e Osman Xhili, Mal Buçpapaj i Malësisë së Gjakovës e të Arben Belit, ish-drejtorit gramshiot; Abaz Hysa etj, të cilët më dhanë krah e zemër. Po kështu edhe shefi i nderuar i policisë Sami Lleshi, administrator, ish-nxënësi im Fiqiri Muça, dhjetëra e qindra lukanjakë, kasnorë e qafëmurras e selishtianë të fisnikërisë.

Natën e Vitit të Ri 2022, më telefonon Petrit Dine Doda. Fisniku lind fisnikun, geni pason genin. Ai më jep krah dhe urim, për faktin se shqyqyr që shpëtova vetë. Në vazhden e provave të mirësisë janë gdhendur edhe Hazbi Kamberi i Dibrës, Llesh Ndue Gjoka i Kashnjetit, të përkushtuarit Ramadan Toma e Merxhan Duka, Mexhit Teta e plot të tjerë. Në mbyllje të këtij shkrimi, dua të theksoj një fjalë nga Urtësia e Malësisë së Gjakovës: "Nderimi që ti bën shkruaje në akull, nderimin që të bëjnë shkruaje në gur". I përfalem mirënjohjes...

# Rahman Ismaili – fisniku fjalëpak e zemërmirë

Kujtime nga kolegë, shokë dhe miq me rastin e përvjetorit të parë të ndarjes nga jeta

Më 25 shkurt 2021 u nda pa pritje nga jeta babai im Rahman Ismaili, influenca më e madhe në jetën time. Për figurën e babait dhe marrëdhëniet e mija me të, do të ndalem në biografinë time pas disa vitesh. Në përvjetorin e parë, kur dhimbja e humbjes të një njeriu kaq të shtrenjtë është akoma e madhe, radhën po ua lë miqve, shokëve dhe kolegëve të babait që patën mirësinë të më dërgonin kujtimet e tyre për të cilat ju jemi familjarisht mirënjohës. Faleminderit bordit të gazetës Rruga e Arbërit për botimin e kujtimeve.

Gëzim I. Alpin

Birmingham, Angli, 25 shkurt 2022

Kujtimet janë botuar me shkurtime si rezultat i hapësirës së kufizuar. - Redaksia



Rahman Ismaili, Birmingham, 2001

## Rahman Ismaili, njeri i mirë e me zemër të madhe

Nga TEFTA CAMI\*

Kanë kaluar shumë vite që nga largimi im nga Dibra. Por miqtë e shokët si Rahman Ismaili mbeten pjesë e kujtimeve më të mira e të paharruara të mija.

Kam punuar me Rahmanin që nga viti 1970 dhe deri sa u largova nga Dibra në janar të vitit 1976.

Rahmani kishte prejardhje patriotike si nga babai edhe nga nëna, qe te dy nga fshati Rabdisht. Gjyshërit e tij ishin shquar në luftë për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga inkursionet e forcave serbenë shekullin XIX-të dhe në fillim të shekullit XX-të.

Rabdishti vuajti nga bastisjet dhe masakrat e serbëve të cilët pasi vrisnin burrat dhe djemtë i vinin zjarrin fshatit. Në një rast, serbet pushkatuan 72 meshkuj. Tri breza të familjes së Rahmanit janë rritur jetim si rezultat i krimeve serbe.

Familja dhe të afërmit e Rahmanit përkrahën LANÇ-re, ndërsa daja e tij luftoi me armë në dorë si partizan dhe u plagos. Babai i Rahmanit dhe babai i bashkëshortes Vahides ishin zgjedhur në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar të zonës.

Rahmani e Vahidja u edukuan dhe brumosur që në moshë të re me dashuri për atdheun. Frymën patriotike ua transmetuan edhe 4 fëmijëve të tyre që i rritën, arsimuan dhe edukuan me dashuri e përkushtim.

Kur isha në Dibër, Rahmanin ishte shofer i sekretarit të parë ndërsa unë punoja si sekretare e dytë e Komitetit të Partisë të rrethit. Megjithatë me Rahmanin udhëtoja herë pas here.

Një person mund të njihet edhe nga një takim e për një kohë të shkurtër e jo më për disa vite. Vizita që bëra një herë në Rabdisht bëri që t'i kuptoja më mirë virtytet e tij.

Rabdishti është afro 4 km nga Llixhat e Peshkopisë. Fshati është vendosur në qendër mbi kurrizin e një pllaje të rrethuar nga të dyja anët me toke bujqësore, me bjeshkë që i qëndron si kurorë. Natyra mahnitëse, ajri i freskët, uji i ftohtë, pyjet me pisha dhe bredha, rrugët dhe sokaqet e shtruara me kalldrëm (një gjë e veçantë në Dibër), dhe shtëpitë, pothuajse të gjitha dykateshe, të ndërtuara me gurë të latuar e të mbuluara me rrasa, të bëjnë të ndjesh një relaks të veçantë. Nuk është aspak çudi që Rabdisht është përzgjedhur ndër katër fshatrat turistike të Dibrës.

Si më parë edhe tani banorët janë shumë të lidhur me fshatin tyre të begatë. Kjo shpjegon përse pas tranzicionit, ndryshe nga fshatrat e tjerë, banorët e Rabdishtit nuk janë larguar për të shkuar në qytet apo jashtë atdheut. Edhe tani, duke qenë një popullsi e kulturuar, rabdishtasit vazhdojnë ta ruajnë tokën e bukës dhe nuk e shpërdorojnë për ndërtime. Nga Rahmanin mësova se përveç bujqësisë, blegtorisë dhe frutikuturës një nga burimet e të ardhurave në

## Njeri i ndershëm, mirënjohës dhe mikpritës

Nga SULEJMAN TOMÇINI\*

Pasi u ktheva nga Kajro në fillim të viteve 1980, u emërova referent për Lindjen e Mesme në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku mbuloja edhe ambasadat në Kajro dhe Algjer. Në vitin 1983 më vjen një njoftim për t'i kërkuar ambasadës tonë në Kajro që të ndiqte çështjen e dërgimit të dy studentëve për studime në Egjipt, njëri pre tyre, Gëzimi. Në atë kohë nuk e njihja Gëzimin dhe familjen e tij. Kur u prezantova me Gëzimin në ministri më foli për familjen dhe prindërit e tij. Më pëlqeu Gëzimi që në takimin e parë për rezultatet e shkëlqyera në Universitetin e Tiranës dhe mënyrën e komunikimit. U angazhova ta ndjek problemin e nisjes së tij në Kajro pasi e dija se burokracia do të na hante shumë kohë deri sa të merrnim përgjigjen e duhur.

Megjithë nxitjen e herë pas hershme tonën, kjo çështje na mori gati dy vjet deri sa u realizua.

Gjatë kësaj periudhe u njoha dhe u takova shpesh edhe me babain e Gëzimit, Rahmanin i cili vinte jo shumë i gjatë, por me një trup të rregullt dhe muskuloz, me një fytyrë paksa të zgjatur, por tërheqëse. Ishte i qeshur dhe kur fliste dukej se i flisnin edhe sytë.

Rahmani ishte njeri korrekt dhe mirënjohës, jo si disa të tjerë që kur realizonin qëllimet nuk të flisnin. Këtë e vura re edhe pasi Gëzimi

u largua për studime në Kajro. Rahmanin nuk rrinte pa më takuar sa herë që vinte në Tiranë me shërbim. Që nga ajo kohë miqësia jonë nuk u ndërpre asnjëherë. Ai nuk i harroi kurrë përpjekjet e mija për realizimin e vajtjes së të birit në Kajro megjithëse unë bëja detyrën time, i shtyrë pak edhe nga fakti që Gëzimi ishte dibran. Isha krenar që, për meritat e tij, Universiteti i Tiranës kishte zgjedhur një djalë të zgjuar nga krahina ime të shkonte për studime të larta në Kajro.

Për herë të fundit Rahmanin e takova në Peshkopë kur u ktheva nga Arabia Saudite në vitin 2004. Ai dhe bashkëshortja e tij Vahidja më pritën mua dhe bashkëshorten time në shtëpinë e tyre të bukuroshu siç dinin të prisnin vetëm ata. Kulmi i qerasjes ishte mjalti nga bletët për të cilët kujdesej vetë Rahmanin.

Rahmani mbeti deri në fund njeri i ndershëm dhe mirënjohës, cilësi që, siç thuhet në fenë islame, është virtyti më me vlerë i njeriut.

Duke mbyllur këto rreshta, i shpreh edhe një herë Gëzimit dhe familjes ngushëllimet më të sinqerta. Rahmanin u prehtë në paqe dhe u pastë lënë jetë dhe bekimin pasardhësve.

Tiranë, më 16 shkurt 2022

\* Sulejman Tomçini, ish-ambasador i Shqipërisë në Egjipt, Algjeri, Arabi Saudite, Liban, Siri, Kuvajt, Emiratet, Oman dhe dy Jemenet.

## Shoku ime zemërgjerë prej 70 vitesh

Nga SHUAIP METHASANI \*

Me Rahmanin jam njohur në pranverën e vitit 1953, në moshën 18 vjeçare, kur punonim në Ndërmarrjen 21 Dhjetorit në Tiranë për të ndërtuar Kombinatin e Tekstileve. Ishim shumë dibranë atje por mbaj mend veçanërisht Rahmanin nga Rabdishti, Xhemil e Neshat Pacin nga Cerjani dhe Fadil e Xhemë Melanin nga Pjeça.

Drejtori Nexho Konomi shpesh na këshillonte të merrnim shembull nga Rahmanin, Sami Methasani, Azem Balliu dhe Musa Metani që punon me dy turne.

Në vitin 1964 unë fillova punë në Komitetin e Partisë në Peshkopë. Aty u takova përsëri me Rahmanin i cili deri sa doli në pension ishte shofer i Sekretarit të Parë. Ajo që e dallonte Rahmanin ishte se punonte me ndërgjegje dhe besnikëri. Edukata e tij shpjegon se përse 11 kuadrot drejtuese me të cilët ai punoi për tre dekada diskutonin çdo gjë në prezencë të tij.

Me Rahmanin kam shumë kujtime nga të cilat do të veçoj dy raste. Në vitin 1972, ishim me një ekip në Helmerën e Bulqizës kur njoftohem se ishte helmuar familja ime në Sllovë. Rahmanin me dërgoi menjëherë në Sllovë, morëm të gjithë anëtarët e familjes dhe i sollëm në spital për t'u mjekuar, dhe na ktheu të gjithëve shëndoshë e mirë në shtëpi.

Ky ishte Rahmanin, shoku ime zemërgjerë prej 70 vitesh.

Një ditë, gjatë periudhës 1970-1975kur punoja në zonën e Sllovës dhe të Kalasë së Dodës vjen Hekuran Isai i cili ishte Sekretari i Parë i rrethit. Gjate drekës kur i zoti i shtëpisë i vuri kokën e qengjit përpara Hekuranit ky tha: 'Kjo i takon Rahmanit sepse ai ka në dorë jetën time dhe si koleg.' Me këtë Hekuranit tregonte modestinë e vet dhe respektin ndaj Rahmanit.

Rahmani gëzoi të njëjtin respekt nga kolegët, miqtë dhe shokët e shumtë edhe pasi doli në pension. Sa dilte në qytet gjithmonë e ftonin për kafe.

Rahmani dhe bashkëshortja e tij me punën e tyre të ndershme si prindër të përkushtuar u hapën dritën jeshile Gëzimit dhe tre fëmijëve të tjerë që sot janë për së mbari me familjet e tyre.

Gëzim – për jetën dhe punën e Rahmanit ka vend për të shkruar romane dhe qindra faqe po unë po e mbyll me pak fjalë: Të rroni me njerëzit e tjerë dhe ta kujtojmë të gjithë prindin tuaj të mrekullueshëm dhe shokun tonë të nderuar.

Me shumë nderime dhe respekt për Rahmanin dhe gjithë familjen e madhe Ismaili, I juaji shoku i babait, Shuaip Methasani

Tiranë, më 18 Maj 2021

## Njeri korrekt dhe mik i vërtetë

Nga STEFAN KUMARAKU

Me Rahmanin jam njohur kur isha shoqëruar personal i Presidentit të Republikës Haxhi Lleshi. Presidenti kishte konsideratë të veçante për Rahmanin i cili gëzonte edhe respektin e shumë sekretarëve të parë dhe të disa anëtarëve të Byrosë Politike.

Rahmani ishte i thjeshtë dhe i respektueshëm me këdo, veçanërisht me kolegët. Që në fillim kur prezantohesha me Rahmanin të kripohej përshtypja se kishte vite që punoja me të. Rahmanin ishte njeri i ndershëm dhe

punëtor.

Ky dibrani i rrallë shquhej edhe për intelektin dhe ironinë e tij. Respekti që kishte fituar me punë dhe përkushtim ndaj Dibrës e bënte që të mos ia përtonte ndonjë kuadri të lartë me nivel mediokër.

Për mua Rahmanin mbeti gjithmonë një mik i vërtetë dhe njeri korrekt.

Tiranë, më 16 shkurt 2022

\*Stefan Kumaraku. Oficer shoqëruar personal i Haxhi Lleshit, President i Republikës (1978-1989)

Tiranë, më 17 shkurt 2022

\*Tefta Cami, ish-Ministre e Arsimit dhe e Kulturës (1976-1987)

Nga JOVAN BARDHI

**I**ruaj si relike, kujtimet nga jeta dhe puna me Dibranët.

Atje bëra edhe shkollën e Dibrës. Ajo ka kuptim të thellë: të jep zgjuarsi, aftësi për tu orientuar drejtë në jetë, për të bërë punë cilësore, dhe forcë për të përballuar çdo problem që të sjell jeta.

Këto edhe të tjera cilësi i gjeta tek Rahman Ismaili. Punëtor i pandalshëm: në çdo kohë, ditë e natë.

Njohës i mirë i profesionit të shoferit, shembullor në mirëmbajtjen e automjetit, kurdoherë në gatishmëri për punë.

Njohës i mirë i të gjitha rrugëve brenda Dibrës, i përgatitur për udhëtuar në to në kohë të mirë dhe kohë të vështirë, me borë dhe akull, ditën dhe natën.

Njohës i të gjithë rrethit, i secilës krahinë e fshat, dhe i çdo zone ku punohej e jetohej në Dibër.

Gjatë 7 viteve, nuk mbeta asnjëherë pa shkuar në destinacionin e planifikuar për difekt të mjetit që ai drejtonte apo bllokim të rrugës. Ai, kur ktheheshim nga shërbimi, pasi më linte mua në zyrë apo shtëpi, nuk shkonte në shtëpinë e tij pa përgatitur mjetin të gatshëm për udhëtimin tjetër. Mjeti i tij ishte gjithmonë në gatishmëri të plotë.

Ai ishte njohës shumë i mirë i gjendjes ekonomike, sociale e shoqërore të çdo krahinë të Dibrës. Në shumë raste, me atë qetësinë dhe elokuencën e tij, fillonte bisedën dhe më bënte me dije, për gjendjen, shqetësimet dhe problemet që do të hasim atje ku do të shkonim. Ai kishte njohuri, edhe për prirjet dhe specifikat kryesore të secilës zonë dhe fshat. E ato, nuk nguronte të t'i shpjegonte qetë, qetë, kur udhëtonim sëbashku.

Dibranët e duan bujqësinë, sidomos prodhimin e misrit, të fasuleve bashkëshoqëruese, të jonxhës si ushqim për kafshët dhe asaj të farës, të pataveve, perimeve, drurëve frutorë etj. Pemët frutore i duan shumë dhe u shërbejnë me përkushtim. Ato rriten në çdo kodër dhe tokën me pjellori të ulët e bëjnë një pemëtoare cilësore. E gjithë toka e Dibrës është e mbushur me pemëtari cilësor, sidomos me qersh, kumbulla, mollë, dardha, etj., nga më të mirat në Ballkan dhe Europë. Zor se mund të gjeje një shtëpi në Dibër pa pemë frutore në kopshtin e shtëpisë.

Shtëpia e Rahmanit qe shembulli më i mirë për këtë. Atë e kishte ndërtuar vetë, në një tokë të pjerrët, të cilën e kishte kthyer në një vilë të bukur, të rrethua me pemë frutore, rrush, kumbulla, mollë, dardhë dhe ku mbilleshin edhe perime. Ajo ishte një shtëpi që kushdo që e shihte u kënaqte syrin dhe shpirtin.

Rahmani më tregonte për shumë shembuj të punëve të mira në të gjithë krahinat e Dibrës, më fliste me pasion për pemëtarinë, dhe më sugjeronte që unë të nxisja nisma, për të bërë të gjithë sipërfaqen e rrethit me një pemëtarinë të madhe dhe cilësore, pasi ajo i përshtatej klimës dhe do të bëhej burim i të ardhurave për të gjithë.

Prej tij mësova, në fillimet e mia në Dibër, edhe se dibrani është ndërtues i shquar i rrugëve, i urave, i veprave ujitëse, i hekurudhave, i fabrikave, uzinave, hidrocentraleve, etj.

Ai nuk pushonte së rrëfyeri për karakteristikat dhe prirjet e popullit të çdo krahine të Dibrës. Duke i dëgjuar këshillat e tij, si njohës shumë i



Te Tirana International Hotel, 2009 (prezantimi i dramës 'Sikur të vdekurit të dëgjonin')

## Shtatë vjet në Dibër me Rahman Ismailin e shquar dhe të palodhur

mirë i dokeve, zakoneve, psikologjisë dhe cilësive individuale të krahinave, asnjëherë nuk gjendesha i pa përgatitur në situata që të krijonin individë të caktuar.

Nuk kisha ndeshur asnjëherë, që një shofer, të kishte aq njohuri e kulturë, sikur të ishte një intelektual i shkolluar në disa universitete. Por ai kishte bërë me shumë sukses shkollën e bukur të odës dibrane, dhe trashëgonte virtytet e larta të një familje me traditë të mëdha atdhetare.

Ai interesohet për çdo projekt që bëhej për Dibër, jo vetëm për ekonominë, por edhe për arsimin, për emancipimin e gruas, për luftën kundër zakoneve prapanike dhe zhvillimin social të çdo zone.

Më tregonte për dukuritë e së kaluarës që ishin pengesa për zhvillimin e Dibrës, dhe sugjeronte si duhet të vepronim, për zhvillimin e arsimit të mesëm masiv dhe profesional. Interesohej dhe më kërkonte gjithnjë të dërgonim e sa më shumë vajza e djem në shkollat e larta, në të gjithë degët e Universiteti të Tiranës dhe Instituteve të tjera.

Ai dhe bashkëshortja e tij Vahidja e bënë detyrën e tyre: rritën dhe edukuan 4 fëmijë, i arsimuan dhe i përgatitën të aftë për të përballuar vetë jetën, duke qenë shembull për familjet dibrane.

Rahmani nuk i shpëtonte as një rast pa u njohur me projektin për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, për zgjerimin e industrisë të nxjerrjes së kromit, për zhvillimin e frutikuturës në të gjithë territorin e Dibrës dhe ngritjen e industrisë të përpunimit të frutave për nevojat e vendit dhe për eksport.

Dibra ngriti një Ndërmarrje Bujqësore të krahasuar me atë të Korçës. Ai sugjeronte të ndërtohen depo, magazina, frigoriferë, fabrika e punishte për përpunimin e frutave, në mënyrë që prodhimi të mos dëmtohej, por të rruhej, evadohej dhe eksportohej me cilësi të mirë.

Ai, si dibrani i mirë, qe i shqetësuar për nevojën e investimeve më të mëdha për rritjen e prodhimit bujqësor dhe të industrisë së kromit.

Si ish Ndërmarrja Bujqësore e Peshkopisë, mund të ngriheshin edhe 3 - 4 ndërmarrje të tjera bujqësore, pasi terreni e kushtet ishin shumë të favorshme. Ai na sugjeronte që këtë nisëm ta realizonim, që të punësoheshin sa më shumë të rinj e të reja të arsimuar.

Ai qe tepër i interesuar që të ndihmoheshin zonat e fshatrat malor për zhvillimin ekonomik e kulturor, për mekanizimin e shërbimeve në bujqësi dhe pemëtarinë, për lidhjen e çdo fshati me rrugë automobilistike.

Mbaj mend, gjithmonë na sugjeronte të zhvillojmë sa më shumë industrinë e lehtë dhe ushqimore, për të punësuar sa më shumë gra e vajza, në mënyrë që të ardhurat e familjeve dibrane të rriteshin më shpejtë, dhe pesha e femrave në familje të vinte duke u rritur, pasi ajo çlirohej më shpejtë nga një farë prapambetje që kish krijuar e kaluara dhe padituria.

Rahmani qe një figurë e mirë shoqërore në Peshkopinë në saj të sjelljes së tij dhe familjes, e cila qe e thjeshtë, e arsimuar, me marrëdhënie shumë korrekte dhe të mira me të gjithë banorët, duke dhënë një shembull të shkëlqyer të njeriut që jetonte me mundin dhe djersën e tij.

Siç përmenda më lart, Rahmanin dhe Vahidja bënë kujdesin e duhur që të 4 fëmijët e tyre të arsimohen, rriten dhe edukohen me normat më të mira moral-çytetare, duke qenë shembulli më i mirë edhe për të tjerët. Rahmanin qe edhe një shembull i mirë i kujdesit për shëndetin e tij, të Vahides dhe fëmijëve.

Për mua ai nuk qe vetëm një shofer i dalluar, por edhe një ndihmës i mirë për të kryer detyrën time. Ai qe një njeri i pa lodhur, kurdoherë i merakosur, i përkushtuar për të kryer detyrën që i ishte ngarkuar me korrektesë dhe besnikëri.

I tillë qe Rahman Ismaili, një nga miqtë e rrallë të familjes time.

Tiranë, më 13 Maj 2021

\*Jovan Bardhi shërbeu si Sekretar i Parë i Komitetit Partisë në Dibër (1976-1982) dhe Ministër i Industrisë Ushqimore (1989-1990).

## Njeri i besueshëm, punëtor i palodhur dhe patriot

Nga BESNIK LAMI\*

**R**ahmani rrodhi nga një familje e ndershme, punëtoare e patriotike në fshatin Rabdisht. Babai i tij, Jonuzi, ishte Sekretar i Këshillit të parë Nacional-Çlirimtar të fshatit. Daja e tij, Arif Nesimi, ishte partizan i Brigadës 18 Sulmuese, i cili pas Luftës u bë oficer e pastaj kuadër i gjeologji-minierave. Një nga vëllezërit e Rahmanit, Abedini, në vitet '70 mori titullin e lartë 'Hero i Punës Socialiste' si traktorist i dalluar në SMT-në e Dibrës.

Unë s'kam punuar me Rahmanin; kam qenë mësues fshati. Rahmanin e kam njohur fillimisht si mik i kushërinjve të mi Ramazan e Qamil Haka.

Pas ndryshimit të sistemit e daljes në pension të Rahmanit më 1991, unë u njoha më mirë me të kur u anëtarësuam në organizatën e veteranëve si pasardhës veteranësh. Në aktivitete veteranësh takoheshim shpesh me Rahmanin dhe kuvendonim për probleme të ndryshme, pinim kafe në lokal, madje në disa raste i kam

qenë për vizitë dhe në shtëpi.

Megjithëse kishim afro 20 vjet diferencë moshe, komunikojta lirshëm me Rahmanin si miq e shokë.

Nga pamja e jashtme Rahmanin të jepte përshtypjen e një njeriu të qetë, të matur, mendar, i thjeshtë dhe i komunikueshëm. I tillë ishte ai në të vërtetë në punë dhe jetë: i dashur, punëtor, i papërtuar, human dhe altruist. Ai përpigje të ndihmonte këdo që kishte halle e shqetësime brenda kuadrit ligjor. Thjeshtësia e tij ishte e admirueshme aq më tepër po të kemi parasysh se fjala e tij kishte peshë gjatë 30 viteve si shofer dhe mik i besuar dhe i respektuar i shumë sekretarëve të parë si Jashar Menzelxhiu, Sulë Baholli, Hajri Hoxha, Sali Stafa, Petraq Magjistari, Hekuran Isai, Jovan Bardhi, etj. Pas ndërrimit të sistemeve, për Rahmanin nuk doli asnjë cen, gjë që dëshmon për vlerat e tij njerëzore dhe çytetare.

Rahmani njihej personalisht me shumë kuadro që drejtuan Dibër dhe Shqipërinë dhe ishte njohës shumë i mirë i tipave të njerëzve

dhe problemeve të jetës. Sikur të ishte njeri i penës do të na linte një libër shumë të bukur me mbresa e kujtime.

Edhe kur Rahmanin doli në pension mbeti ai që kishim njohur me parë: njeriu xhantil me vlera çytetare.

Ai u nda nga jeta në moshën 90 vjeç, i kënaqur me fëmijët e nipërit e mbesat, i respektuar në kulm nga ata dhe shoqëria. Megjithë kufizimet nga Covid-19, në funeralin e Rahmanit më 26 shkurt 2021 erdhën shumë njerëz për t'i dhënë lamtumirën e fundit jo nga Peshkopia, zona të ndryshme të Dibrës, Tirana dhe çytete të tjera në shenjë nderimi e respekti për të.

Rahmani bëri një jetë të qetë e të ndershme familjare. A kishte harmoni të shkëlqyer me bashkëshorten Vahiden.

Rahmani jetoj goxha, iku nga kjo jetë i qetë pa vuajtje e sëmundje. Ai ishte simboli i njeriut të vlerave, njeri i punës e patriot i vërtetë.

Peshkopi, më 20 Maj 2021

\*Besnik Lami, ish-arsimtar, autor, dhe Sekretar i Komitetit të Veteranëve të Rrethit Dibër

## Njeriu që e deshi me gjithë shpirt Dibër

Nga DEMIR OSMANI\*

**N**donjëherë në jetë takon njerëz të thjeshtë, me edukatë të shëndosh shoqërore dhe cilësi e virtyte të larta njerëzore që është e vështirë t'i harrosh, pasi në udhëtimin tënd, gjenden në momente deçizive, nga ku merr ndryshim kahu i lëvizjes tuaj. Një i tillë është edhe Rahman Ismaili.

Për herë të parë e kam takuar Rahmanin në vitin 1977 kur isha mësues në shkollën e mesme të Maqellarës. Një ditë, ndërsa po jepja mësim, një nxënës më thotë se me kërkonte një burrë 'për një porosi me rëndësi'.

Dola nga klasa dhe pashë një meso burrë, me buzën në gaz, me sy të qeshur, i veshur me xhakëtë e pantollona stofi të mirë për kohën, me këmbishë të bardhë. Pasi u prezantua tha se kishte ardhur me porosi të Jovan Bardhit, Sekretarit i Parë të Komitetit të Partisë, kuadri me funksionin më të lartë në Rrethin e Dibrës.

'Njofto Kadriun (babain tim)', vazhdoi Rahmanin, 'se sot ne shtëpinë tuaj do të vij shoku Jovan. Do të jemi vetëm ne të dy. Nuk është nevoja të jesh as ty'.

Ngaqë e ndjeu habinë time, Rahmanin me tha me atë zërin e tij të qetë dhe bindës: 'Është për mirë, është për ty. Edhe unë dëshiroj që djemtë e mi të bëhen si ti, që vijnë e të kërkojnë në Tiranë. Ne i kemi këtu, e nuk i vlerësojmë.'

U ngroha në shpirt dhe menjëherë ndjeva simpati të veçantë për atë njeri që u shfaq krejt papritur me një mesazh kaq të madh.

Në atë kohë kisha mbaruar dy shkolla të larta, dhe disa digastere qendrore kishin kërkuar të më tërhiqnin në Tiranë. Diçka më pengonte. Gjate luftës nacional-çlirimtare shtëpia ime ishte një nga bazat më të mëdha në Dibër dhe babai im kishte qenë partizan. Por në vitin 1946 babai ishte dënua dhe kishte vuajtur dënim në burgun e Gjirokastrës 2 vjet për 'agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor'. Pavarësisht se ai kishte marrë pafajësinë pas prishjes së marrëdhënieve me jugosllavët, sapo hapej dosja ime, gjendej i shkruar dënimi i tim eti, dhe kështu mbyllej rrugëtimi im.

Më pas me Rahmanin më takoi të punoj, udhëtoj, bashkëbisedoj dhe diskutoj për shumë gjera. Mësova shumë prej këtij burri të rrallë e të zotë të Dibrës, të cilin unë e gjithmonë e njoha si fjalë pak e punë shumë, me sjellje korrekte e shumë të kulturuar, besnik dhe i pa përtuar për të të ndihmuar e mbështetur kur vërente se përpiqesh, bujar dhe fjalë ëmbël, i ndershëm dhe shumë fisnik.

Pas kishim punuar bashkë për disa vite Rahmanin përsëri u shfaq në një moment kyç. Në Mars 1986 isha propozuar për t'u larguar nga Dibra në një detyrë më të rëndësishme në një vepër të madhe. Kjo gjë nuk u pëlqeu shëfave të mi në Rrethinë e Dibrës të cilët më penguan.

Megjithëse i mërziur nuk e dhashë veten dhe u nisa për Kala të Dodës për të nxjerrë aksionistë. Ndërsa udhëtoja me tre instruktorë të Komitetit të Rinisë rrugës për Kastriot, shoferi Kadri Meda tha se Rahmanin po vinte mbrapa dhe po bënte sinjal të ndalem!

Ndalojmë makinën dhe Rahmanin më thotë: 'Zbrit nga makina dhe eja me mua. Këta djemtë le të vazhdojnë rrugën. Do të shkojmë në zyrën e Sekretarit të Parë.'

U ktheva me makinën e tij. Rahmanin me atë buzëqeshjen e para 8 viteve më thotë: 'Nuk mund ta ndalojë askush rrugëtimin tënd. I thanë atij shokut këtu ata të Tiranës, ai na duhet për punë më të mëdha. Dibra ka plotë djem e vajza të mirë që mund ta zëvendësojnë.'

U gëzova sa nuk thuhet. Edhe Rahmanin fluturonte nga gëzimi; bëri ç'bëri, e rregulloi me shefin e tij, dhe më nisi menjëherë për në Tiranë.

Ja ky ishte Rahman Ismaili, njeriu që e deshi me gjithë shpirt Dibër dhe Dibranët.

Tiranë më 15 Maj 2021

\*Demir Kadri Osmani, fizikan, ish Sekretar i Parë i Rinisë të Rrethit Dibër

# ZEQIR HYSA - kujtim e dhimbje, që dhemb gjithmonë

Nga SHAQIR ÇERPJA

Koha ecën dhe ne ecim e udhëtojmë me kohën. Edhe kujtimet ecin e udhëtojnë me ne. Kujtimet ecin me kohën, por ato nuk shkojnë si koha dhe nuk shkojnë me kohën, por rrinë përherë me ne, rrinë dhe flasin me njerëzit. Rrinë në shpirtin dhe zemrën tonë. Malli i shpirtit i ushqen dhe i mban gjallë kujtimet. Malli i shpirtit bëhet lot dhe loti i flladit dhe i freskon ato. Ndonëse kanë kaluar tridhjetë vjet, qëkur, njëri nga djemtë e mirë të Dardhës, një intelektual, specialist dhe drejtues kryesor i Dardhës, Zeqir Hysa, në moshë shumë të re, vetëm tridhjetë e tre vjeç, u nda nga jeta, por ai rron i gjallë dhe është i gjallë në kujtimet tona. Tridhjetë vjetë nuk janë pak, tridhjetë vjetë janë shumë për të mbajtur në shpirt e zemër peshën e kësaj dhimbje të madhe për vdekjen e parakohëshme të tij. Por vitet nuk i zbehin kujtimet tona për të. Kujtimet tona për Zeqirin janë të freskëta e dhimbja flet e dhemb përditë, përherë, gjithmonë.

Ishte dhjetor i vitit 1991. Ishte dimër, por ishte më ftohtë se dimër. Jo vetëm ai dhjetor, por edhe muajt e tjerë të atij viti, ishin të ftohtë e të akullt si dhjetor, si dimër dhjetori. Ishin ditë, javë e muaj të zbrazët, të lodhshëm, të mërziqshëm, të ftohtë e të akullt, sepse bashkëfshatari, bashkëmohatari, shoku ynë e shoku i të gjithëve, djali i dashur dhe dashamirës me të gjithë, Zeqir Hysa, vuante e dergjej në shtrat, pa shenja përmirësimi e pa shpresë shpëtimi.

Dhe, ndonëse kanë kaluar tridhjetë vjet, ne e kujtojmë me respekt e mirënjohje dhe mendojmë, meditojmë dhe tregojmë për të.

Zeqir Hysa u lind në fshatin Lashkizë të Dibrës, në pranverën e vitit 1958. U lind në muajin e parë të pranverës, më 23 mars, kur pranverë ishte, por pranvera dhe dimri akoma s'ishin ndarë, akoma rrinin bashkë. Ishte ditë e dielë dhe ardhja e Zeqirit në jetë, solli ngrohtësi dielli dhe dritë dielli në familjen e tij. Ishte fëmija i dytë dhe djali i parë i prindërve Met Hysa e Xhibe Cani-Hysa. Por gëzimi në familjen e tij nuk zgjati shumë, se babai i tij, Met Hysa, u sëmurë dhe u nda nga jeta në moshë të re, duke lënë dy fëmijët e vegjël jetim. Kur i vdiq i ati, Zeqiri ishte shumë i vogël, vetëm pesë vjeç. Kujdesja dhe përkujdesja e nënës dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes nuk i munguan asnjëherë, por mungesa e babait, dhimbja dhe malli për të, e shoqëruan gjithmonë, gjatë gjithë jetës së tij. Pasi mbaroi shkollën 8-vjeçare në Lashkizë, vazhdoi, kreu e përfundoi shkollën e mesme bujqësore në Zall-Dardhë, me rezultate shumë të mira. Në shkollën e mesme bujqësore, krahas përpjekjeve për rezultate sa më të larta në mësim, Zeqiri ishte edhe një aktivist i dalluar shoqëror. Aktivizohej me organizatën e rinisë në shkollë dhe me komitetin e rinisë të zonës së Dardhës. Kishte dëshirë e pasion për të shkruar dhe shkruante e botonte edhe në shtypin lokal të kohës, në gazetën "Ushtima e maleve", jo vetëm shkrime të karakterit informativ, por edhe poezi.

Rezultatet shumë të mira në mësim, por dhe sjellja, qëndrimi shoqëror dhe aktivizimi në aktivitete dhe veprimtari të ndryshme shoqërore, i hapën rrugën dhe i dhanë mundësinë për të vazhduar studimet e larta. Në periudhën 1979-1984 vazhdoi e kreu studimet e larta në Institutin Bujqësor të Korçës. Ashtu si në shkollën e mesme bujqësore në Zall-Dardhë, edhe gjatë studimeve të larta në Korçë, krahas punës, përpjekjeve e studimeve për të përvetësuar programin mësimor e shkencor, ai vazhdoi të aktivizohej me organizatën e rinisë dhe komitetin e rinisë të Institutit dhe në veprimtari të ndryshme shoqërore. Vazhdoi të shkruante poezi, të merrte pjesë në konkurime letrare në Institut, por edhe duke botuar në shtypin e kohës poezi, shkrime të karakterit informativ, skica etj.

Gjatë studimeve në Institutin Bujqësor të Korçës, përveç formimit shkencor e profesional, ai u pais me kulturë të gjërë dhe formim të përgjithshëm intelektual. Dhe, me të kryer e përfunduar studimet e larta, kthehet në vendlindje dhe fillon e vazhdon punë agronom në sektorin e Lashkizës të kooperativës bujqësore Dardhë. Ndonëse i ri në moshë, ai ishte i pjekur dhe i matur në sjellje, qëndrime dhe veprime. Ishte i dashur dhe dashamirës me të gjithë. I thjeshtë, modest, i komunikueshëm dhe tolerant, jo vetëm me kolegët dhe shokët, por edhe me vartësit, me brigadierët dhe punëtorët kooperativiste, me të cilët bashkëpunonte ngushtë dhe konsulohehin bashkë për të gjetur zgjidhje efektive për realizimin e detyrave. Balanca e përkushtimit intelektual dhe profesional anonte gjithmonë në krah të punëtorëve dhe gjithmonë kërkonte e gjente zgjidhje të ndërmjetme, të buta, për të lehtësuar punëtorët, të cilët punonin e lodheshin shumë, por paguheshin shumë pak.

Vetëm disa muaj pasi Zeqiri kishte filluar punë agronom në Lashkizë, ndodhi një tragjedi e rëndë, që tronditi jo vetëm Zeqirin dhe familjen e tij, por tronditi gjithë fisin e fshatit, Dardhën e Dibrën, por edhe më gjërë. Në dimrin e madh të vitit 1985, në janarin e ftohtë të atij viti, ra në krye të detyrës, Xhelal Hysa, "Hero i Punës", kushëriri i parë i Zeqirit, të cilin e kishte si prind, e kishte këshillues, krah dhe mbështetje për çdo rast, për çdo punë dhe për çdo gjë. Disa muaj pas vdekjes së Xhelalit, në tetor të vitit 1985, Zeqiri i besohet detyra e rëndësishme e kryetarit të këshillit të bashkuar të Dardhës, që kishte në juridiksion të nëntë fshatrat e Dardhës. Edhe në këtë detyrë të rëndësishme, ai u shqua për thjeshtësi, për tolerancë dhe dashamirësi me të gjithë njerëzit. Për të gjitha këto cilësi pozitive, ai u bë, ishte dhe mbeti një njeri, një intelektual, një specialist, një kuadër dhe drejtues i vlerësuar, i dashur dhe i respektuar nga njerëzit.

Në karrierën e tij drejtuese si kryetar i këshillit të bashkuar të Dardhës, ai pati rast t'a provonte mirënjohjen, respektin dhe dashurinë e njerëzve ndaj tij. Ishte një rast delikat në karrierën e tij, që zgjidhjen pozitive në favor të Zeqirit e dha populli, dashuria e popullit, këmbëngulja dhe vendosmëria e popullit.

Në fushatën elektorale për zgjedhjet lokale, pati përpjekje për t'a penguar rikandidimin e Zeqirit për mandatin e dytë si kryetar i këshillit të bashkuar në Dardhë. Por përpjekjet për t'a penguar rikandidimin e tij nuk funksionuan, nuk rezultuan të suksesshme dhe nuk e penguan dot rikandidimin e tij. Por edhe pasi u kryen dhe përfunduan votimet dhe Zeqiri ishte zgjedh anëtar i këshillit të bashkuar të Dardhës dhe pritej mbledhja e këshillit të bashkuar për të votuar dhe për t'a rikonfirmuar kryetar të këshillit të bashkuar për mandatin e dytë, përpjekjet për t'a shmangur rizgjedhjen e tij, jo vetëm nuk u ndërpre, por vazhduan, u rritën, u zgjeruan e intensifikuan edhe më shumë. Problemi u ndërlikuar shumë, sepse çështja u adresuar dhe shkoi në organet kryesore politike dhe shtetërore në rreth. Tani që Zeqiri ishte zgjedhur anëtar i këshillit të bashkuar, njerëzit që ishin angazhuar dhe punonin për të penguar rizgjedhjen e Zeqirit kryetar i këshillit të bashkuar, jo vetëm donin t'a pengonin rizgjedhjen e tij, por donin t'a revokimin publikisht. Si argument u përdor një shkresë (me të dhëna të vërteta, krejt të vërteta), që Zeqiri kishte lëshuar në mbështetje e në mbrojtje të një specialisti të zonës, në një proces gjyqësor. Dhe, përpjekjet e këtyre njerëzve të veshur me pushtet politik e shtetëror nuk u ndërpre, por vazhduan. Në fshatin Lashkizë u organizua një mbledhje e zgjeruar e popullit, jo vetëm të Lashkizës, por edhe të fshatrave të tjerë Tartaj, Soricë, etj. Kishin ardhur të deleguar nga organet kryesore të rrethit të Dibrës, nga komiteti i partisë, nga komiteti ekzekutiv dhe nga gjykata. Organizatorët e këtij takimi popullor dhe të deleguarit e organeve shtetërore të rrethit Dibrë kishin bindjen se do t'a realizonin lehtësisht



revokimin e tij, por dështuan. Dështuan, sepse Zeqirin e donte populli dhe populli e mbështeti, këmbënguli dhe e mbrojti. Të deleguarit u kthyen bosh, të mundur e zemërtyer nga ky takim i dështuar dhe i pasuksesshëm me popullin në Lashkizë. Por, nga ky dështim, strukturat e organeve politike e shtetërore në rreth, u egërsuan edhe më shumë. Dhe, pas pak kohe, në fshatin Qa, në vendlindlindjen e Zeqirit, u organizua një mbledhje e zgjeruar e popullit të Dardhës. Në këtë mbledhje të zgjeruar të popullit të Dardhës vjen edhe vetë sekretari i parë i rrethit të Dibrës, Xhelil Gjoni, i shoqëruar nga kryetari i degës së punëve të brendshme I. B. dhe drejtues të tjerë të strukturave të organeve politike e shtetërore në rreth. Ardhja e vetë sekretarit të parë të rrethit të Dibrës, Xhelil Gjoni, por dhe shoqërimi i tij nga kryetari i degës së punëve të brendshme, ishte një presion psikologjik për popullin, që populli të heshtë, të mos fliste. Por populli nuk heshti. Populli foli. Folën shumë veta. Dhe të gjithë folësit në atë takim popullor folën me guxim dhe me shumë vlerësim për Zeqirin. Vetëm vlerësime pozitive për Zeqirin. Dhe çdo diskutim shoqërohej me duartrokitje nga populli i pranishëm në atë takim. Xhelil Gjoni i dëgjoi me shumë vëmendje të gjithë diskutantët e diskutimet e tyre. Dhe, në fund, edhe Xhelil Gjoni u dorëzua. E pranoi dështimin. Atë ditë, në atë takim popullor, Zeqir Hysa u rizgjedh kryetar i këshillit të bashkuar Dardhë, për mandatin e tij të dytë. Në fund të takimit, Xhelil Gjoni i drejtohet Zeqirit dhe i thotë: -Ti je kryetar me mandat popullor, se ty të don populli dhe mandatin ta jep e ta dha populli.

Zeqiri vazhdoi punën në mandatin e tij të dytë si kryetar i këshillit të bashkuar të Dardhës, duke punuar me përkushtim për të justifikuar jo vetëm detyrën, por dhe dashurinë, besimin, vlerësimin, respektin e mirënjohjen e popullit ndaj tij.

Por, megjithëse Zeqiri u rizgjedh kryetar i këshillit të bashkuar Dardhë, me mandat popullor në takim popullor, fundi i këtij mandati ishte i vështirë, sepse në shkurt të vitit 1991, shëndeti i tij u prek dhe u tronditi nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme. Ai përjetoi ditë e netë të vështira, duke luftuar me sëmundjen dhe duke përballuar dhimbjen. Dhe, më 23 dhjetor 1991, ai u nda nga jeta në moshë shumë të re, veç tridhjetë e tre vjeç, duke lënë në pikëllim, jo vetëm fëmijët jetim, nënën e moshuar dhe nusen e re, por edhe të gjithë njerëzit që i deshi dhe e deshën aq shumë.

Kujtimi i tij rron e do të rrojë midis nesh.

printime dixhitale  
me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme  
libra | broshura | revista | fletëpalosje  
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.  
duke filluar nga 1 kopje e vetme  
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Bëj një abonim  
online ose  
kopje të shtypur...  
Kushton vetëm 600 lekë në vit...  
email: rrugaearbërit@gmail.com



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: <https://tinyurl.com/lcc3e2f>

# in memoriam

## Ndahet nga jeta veterani Besim Bajraktari

Më 14 shkurt 2022, u nda nga jeta në mënyrë të papritur veterani Besim Bajraktari nga Dohoshishti i Dibrës. Edhe lisat e fortë, ata që u kanë bërë ballë rrebesheve e stuhive ndër dekada, një ditë rrëzohen për dhe, në tokën ku janë ngulur fort rrënjët e tyre. Besim Bajraktari u nda nga jeta në mënyrë të beftë mëngjesin e asaj të hëne, kur qe ngritur si çdo ditë tjetër dhe familjarët e prisnin në tavolinë për të ngrënë mëngjesin, por ai atë ditë nuk zbriti. Iku si një zog që pasi ka bërë vend në një degë peme, ka soditur gjithçka rreth e qark dhe papritur ngrihet në fluturim, ikën pa kthim drejt lartësive, drejt qiellit të pa fund ku kërkon një strehë të re.

Ikja e tij pa paralajmërim tronditi në radhë të parë familjarët e tij, gruan e fëmijët, vëllezërit e kushërinjtë, bashkëfshatarët dhe banorët e Peshkopisë e të mbarë vendit, kudo që kishte të njohur. Largimi i tij la pa fjalë miqtë dhe shokët e shumë kudo ku ka punuar e ka kaluar, të cilët e njihnin si një burrë me vlera të rralla, i punës e i kuvendit, i fjalës e i besës, i mendimit e i shakasë, por dhe i vendimeve të vështira, model i mikut, shokut, drejtuesit dhe familjarit.

Besim Bajraktari lindi në Dohoshisht më 6 maj 1938 në një familje të ndershme e punëtore dhe me tradita të spikatura patriotike. U rrit e u edukua me vlerat e veçanta si fjalë e mbajtur, dashuria për punën dhe për njerëzit, respekti për të tjerët dhe kujdesi për familjen, por dhe dashuria deri në vetmohim për fshatin, Dibrën dhe mbarë vendin. Pasi kreu arsimin 7 vjeçar, në vitin 1953 shkoi në Tiranë ku bëri një kurs për tregti dhe në moshë 15 vjeçare filloi punë në këtë sektor në fshatin e tij, deri në vitin 1955.

Ai u rrit e u formua nën kujdesin e vëllait të madh, Shemsit, i cili ishte model i tij. Por i vëllai u nda shpejt nga jeta në moshën 40 vjeçare, që në vitin 1970. Kështu Besimit i ra herët barra e familjes, por ai e mbajti me dinjitet atë.

Në vitin 1955 filloi punën në Kooperativën bujqësore të Dohoshishtit si përgjegjës blegtorie, kur ishte vetëm 17 vjeç.



Në vitin 1956 u martua me Meribanin, me të cilën linden e edukuan më së miri 6 fëmijë, 3 djem dhe 3 vajza, Nexhmiu, Mevludi, Festime, Nusrete, Nevruz, e Florina. Ata u rritën e u formuan me edukatën e familjes dhe kulturën e kohës e janë sot punonjës të nderuar dhe familjarë e qytetarë shembullorë. Më i madhi midis tyre, Nexhmiu, është një ekonomist i njohur në Tiranë, drejtor i një Banke të nivelit të dytë dhe derë e hapur për çdo dibran që troket në derën e tij.

Pas shërbimit ushtarak, në moshën 23 vjeç, Besimi do të emërohet Kryetar kooperative bujqësore, në fillim në Hoteshe dhe me vonë në atë të Luznisë.

Puna e tij u vlerësua si mjaft e mirë dhe në shtator të vitit 1963 u dërgua në shkollën 3 vjeçare të Kryetarëve të kooperativave bujqësore në Tiranë. Pas përfundimit të shkollës, ai ishte përsëri kryetar në Luzni deri në maj të vitit 1972.

Në vitet 1972-1975 ishte kuadër kryesor në zonën e Maqellarës.

Gjatë viteve 1975-1977 u dërgua si një dorë e fortë në Kooperativën Okshtun, ku bëri një punë shumë të mirë dhe i solli

ndryshim e përparim asaj zone e ku la miq e shokë dhe përmendet gjithnjë për mirë. I dha emrin e tij asaj periudhe, atje thonë shpesh "në kohën e Besim Bajraktarit". Kur një mik i Besimit, mjeku Nazmi Koçi, njoftoi të vëllain Seferin për humbjen e Besimit, ai si moshatar e mik që e kishte i tha Nazmiut: Shko vëlla në përcjelljen e Besimit, shko edhe për mua se jam i pa mundur, bile jo vetëm për mua, shko për gjithë Okshtunin që e kishte si djalin e vet.

Në vitet 1977 deri 1987, Besim Bajraktari ishte Kryetar i kooperativës në Maqellarë, njëra ndër ekonomitë më të mëdha e me probleme në rreth. Pas vitit 1987, ai u largua nga bujqësia dhe punoi si N/drejtor e Drejtor në tregti dhe me pas drejtor i bazës së bujqësisë në rreth.

Pas vitit 1991, njeriu me eksperiencë të madhe u shkëput nga puna në shtet dhe krijoi biznesin e tij ku me punën dhe mundin e tij e të familjes eci përpara.

Besim Bajraktari do të mbahet mend si burrë i fortë, njeri i drejtë e pa kompromis sidomos me eprorët e vet, i dashur e punë mbaruar me popullin dhe të gjithë hallexhinjtë që kërkonin ndihmën e tij, i fjalës e i besës, shembull për tu ndjekur nga të tjerët.

Respekti dhe dashuria e popullit për të, për familjen dhe fisin e tij u tregua dhe me rastin e ndarjes së tij nga jeta. I gjithë qyteti i Peshkopisë, fshatrat për rreth, të ardhur nga Tirana dhe nga rrethet, nderuan familjen dhe të afërmit e tij. Ata i siguruan këtë njeriu të mirë e drejtuesi shembullor për disa dekada, një përcjellje madhështore, siç ai meritonte dhe siç dibranët dinë ta bëjnë. Ai prehet në një lëndinë të bukur në fshatin Dohoshisht, pranë të vëllait, Shemsit dhe të afërmit të tij, në një vend ku shihet Korabi e Deshati, qyteti i Peshkopisë dhe fshatrat sipër tij.

Kujtimi dhe nderimi për të do të rrojnë përjetësisht për atë çka ishte, për atë çka bëri, për atë çka na la.

**Hekuran Kola, Shems Zuna, Irfan Zebi, Nazmi Koçi, Bajram Krashi**



## LAMTUMIRË, MEXHIT MËZIU

Nga HALIL RAMA

Pothuajse, gjithë burrat e djemtë e Muhurrit, si edhe të krahinave përreth, jo vetëm të ardhurit që banojnë në metropolin shqiptar, në Durrës, Laç, Lezhë e Shkodër, por edhe nga trojet autoktone e nga hapësira mbarëshqiptare në botë, ishin më 13 shkurt 2022, në mesditë, në varrezat e Bathores, për t'i dhënë lamtumirën e fundit Mexhit Mëziut. Vetë prania e mijëra dibranëve në këtë ceremoni mortore ishte dëshmia më e qartë e respektit që ata gëzonin për Mexhitin.

Ai kishte lindur në Muhurr, më 1 maj 1942, për t'i mbyllur sytë përgjithmonë, të shtunën e 12 shkurtit 2022. Ndërsa paraditen e kësaj date, si edhe çdo ditë tjetër, ai do të pinte kafënë e mëngjesit me shokët e tij, papritur, një atak kardiak do të bëhej shkaku i ndarjes së tij nga jeta.

Familja, miqtë, të afërmit dhe shokët e tij të shumtë do ta përjetonin me trishtim e dhimbje të thellë vdekjen e njeriut të tyre më të dashur.

Ndaj s'kishin si të mungonin ata në ceremoninë e përcjelljes së tij për në botën e përtejme.

I rritur jetim, që në fëmijërinë e tij të herëshme, nën përkujdesjen shembullore të nënë Zamanes, Mexhiti do t'i ngjiste me krenari shkallët e dijes dhe do të përballonte me dinjitet punë të vështira për t'i ardhur në ndihmë familjes.

Në moshë fare të re do të punonte në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit Pyjor Dibrë, për t'iu përkushtuar më pas profesionit të shoferit me pasion e përkushtim të jashtëzakonshëm. Dhe jo vetëm si person, por duke ndihmuar edhe dhjetra djem të tjerë të Muhurrit, që t'i përkushtoheshin këtij profesioni. Kështu, nëse shoferët muhurrakë zinin numër të konsiderueshëm në Parkun Automobilistik të Dibrës, si edhe në Minierën e Mermerit, SMT, NB etj., më i spikatur, padyshim, ishte Mexhit Mëziu. Një shofer me inteligjencë të rrallë, që shquhej jo vetëm për profesionin, realizimin e tejkallimit e planit me "Saurer"-in e tij, por edhe si një veprimtar i mirë shoqëror.

Me punën e sjelljet e tij shembullore në shoqëri e familje, ai arriti të integrohej deri në strukturat më të larta të rrethit, duke u zgjedhur deri anëtar i Plenumit të Komitetit të PPSH të rrethit Dibrë.

Qytetarët dibranë e donin dhe e respektonin Mexhit Mëziun, edhe kur drejtonte autobusin e linjës Peshkopi-Tiranë, edhe kur ai qe ndër të parët shoferë të eksport-importit të mallërave nga shtete të ndryshme të botës.

Mbi një dekadë, si shofer eksport-importi, ndikuan që Mexhiti të krijonte profilin e qytetarit që përvojën e përparuar botërore ta reflektonte në sjelljen e qytetarëve në familje e shoqëri. Këtë profil do të përshfaqte ai, edhe në dhjetra vite si shofer i autobusit të linjës Peshkopi-Tiranë, duke fituar respektin e mijëra dibranëve.

Vitet e fundit të jetës së tij i kaloi në Valias, mes shokëve e miqve të shumtë, që i donte dhe e donin aq shumë.

Ashtu siç ishte vetë, shembull në familje e shoqëri, ai dhe bashkëshortja e tij, Safia, rritën dhe edukuan tre djemtë dhe tre vajzat e tyre: Ismetin, Idajetin, Violetën, Ylberin, Ervinën dhe Adelinën, të cilët e gëzonin jashtë mase me arritjet e tyre dhe me familjet shembullore që krijuan. Ai gëzohej arritjeve të tyre dhe lumturorëve me nipërit e mbesat, të cilët nuk do të harrojnë kurrë dhe do të trashëgojnë e çojnë më tej trashëgiminë e tij të vyer.

Lamtumirë, Mexhit Mëziu!

Parajsa qoftë vendbanimi yt i përjetshëm!

## Rexhep Hoxha - Mësuesi që takoi në Bulaçin malor "Lulin e Vocërr" në original

(Vijon nga faqja 21)

përballoi me shumë sukses këtë reformë delikate, saqë komuniteti i arsimtarëve dibranë nuk pati asnjë ankesë.

Pasi konsultohet me drejtorin e drejtorisë, z.Tomor Shehu për një emërim apo transferim të caktuar, e shpallnin atë. Pra nuk veptoi kurrë vetëm me kokën e vet...

Për kontributin si mësues shembullor Rexhep Hoxha është dekoruar nga Presidenti i Republikës në vitin 1994 me Medaljen "Naim Frashëri" të Klasit Parë, si dhe me Çertifikatën "Nderi i Arsimit në Dibrë". Po ashtu Këshilli Bashkiak i Peshkopisë i ka dhënë titullin "Qytetar Nderi" i qytetit Peshkopi.

### MËSUES NË PESHKOPI, KUR NXËNËSIT NGATËRRONIN GJERGJIN ME SKËNDERBEUN?!

Kur fitoi PS në 1997-tën, Rexhep Hoxha kaloi përsëri mësues në shkollën "Selim Alliu", Peshkopi. Mori një klasë të dytë shumë të dobët. Drejtoresha e shkollës gjatë kontrollit i tha: "Ke 17 nxënës që nuk dinë të lexojnë, nga 28 gjithsej". Por mësuesi që kishte jo vetëm përvojën, por edhe përgjegjësinë maksimale për detyrën, siç e kishte patur edhe në shkollat e skajeve të largëta, e bëri klasën konkurruese me klasat e tjera brenda tre muajve.

Gjithësesi ai kujtonte një "provokim" të vogël me shumë domethënie në një ditë kur kishin një pjesë leximi me titull "Gjergj Kas-



trioti dhe Skënderbeu'. Në brendësi, teksti nuk e përmendte më 'Gj.Kastrioti', por vetëm 'Skenderbeu!'. Mësues Xhepa u ndal 5 minuta për t'u shpjeguar nxënësve se si dhe ku e mori tutullin Skënderbe, Gjergji. Sa ra zilja, futet menjëherë te klasa ngjitur dhe i merr leje mësueses t'ju bënte një pyetje nxënësve.

Po, - tha ajo.  
- Kush më thotë, çfarë e kishte Gjergj Kastrioti, Skënderbeun?!, i pyeti.

-Vëlla,- thotë njëri.  
-Shok, o mësues, ia pret tjetri..., dajë një tjetër!!!

Mësuesja filloi të skuqej.  
Shkoi mësues Xhepa edhe te klasa tjetër.

Po ajo pyetje, po ato përgjigje. Te klasa e tretë po ashtu. Kur po dilte, një nxënës thirri: Me leje mësues! Gjergj Kastrioti është vetë Skënderbeu.

- Të lumtë, - i tha. Po i kujt je ti?, - e pyeti.  
Nxënësi i tregoi emrin e babait që ishte inxhinier dhe të nënës së tij mësuese. "Të fala prindërve" - i tha mësues Xhepa dhe doli nga klasa e tij.

Vetëm një vit punoi mësues Rexhepi me atë klasë, e megjithatë ajo deri sa mbaroi klasën e tetë, thirrej "Klasa e mësues Rexhepit...!".

Kësisoj, profili i tij është një ndërthurje e çuditshme dhe e mistershme e rrethanave e faktorëve objektivë e subjektivë, ekonomikë e politikë, që bëjnë të mundshme daljen e shpërthimit në skenën e amfiteatrit, ku popujt vendosin vetë për fatet e tyre.

Si nga një vullnet hyjnor, harmonizohen gjer në përsosmëri përvoja e mësuesit e sportistit të talentuar me atë të organizatorit të partisë së parë opozitare në një rreth tejet të vështirë si Dibra. I ardhur nga një familje me një traditë të mirëfilltë intelektuale, Ai ishte edukuar dhe formuar me disiplinën, ndershmërinë e antikonformizmin, ekselent në fushën e mësimdhënies e të edukimit në përgjithësi, me aftësi të spikatura organizuese e menaxhuese. Kështu, Rexhep Hoxha, një politikan tipik në një situatë atipike, siç qe ajo e viteve 1997 - 2000, do të bëhej shembull frymëzimi për demokratët, ish-nxënësit e kolkët nga gjithë Dibra.



**Rruga e Arbërit** *Aty ku fjalët nuk i merr era!*

KRIJU AKTUALITET KULTURË TURIZEM SPORT DIASPORA NJOFTIME ARKIVA PAJTOHU/NDIHM

Kërk...

ARTIKUJ TË FUNDI

- Grate shqiptare që misionin vram jehonën në shpëtyllim nga furi Senokaj i BIRI
- Stratëzja e Dibrës nuk duhet të ridojë
- Qeveria duhet të tregohet e përvur dhe e përgjegjshme ndaj kërkuesve të punës
- Nga Duga Kanoni
- Rafting në Dri, një risi e turizmit në Dibrë për surpriza dhe aventura

**Nga raftingu në Dri, te ngjitja në majën e Korabit, mundësitë e zhvillimit të turizmit**

Më daljen e ngadalë nga pandemia shpresat për një risi të turizmit në vend po rriten. Çka kjo për një edhe lëvizjen për përgatitjen e guidave turistike dhe bërjen e turizmit. Më 29 maj 2021, në Parku Kombëtar "Shehëri" - Jabllanica Ishë i pranohet ambasadori i...

Qershor 2021

**Rruga e Arbërit** *Botim i pavarur*

**E vetmja e printuar për rajonin e Dibrës**

Pajtohu dhe qëndro me gazetën *Rruga e Arbërit* më pranë #Dibrës!

Twitter: rrugaearbërit Facebook: Rruga e Arbërit Edit

Rruga e Arbërit @gazeteerajonittdibrës · Local business Edit Contact Us

[www.rrugaearbërit.com](http://www.rrugaearbërit.com)

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: [info@rrugaearbërit.com](mailto:info@rrugaearbërit.com)

Informacioni për versionin e printuar: [rrugaearbërit@gmail.com](mailto:rrugaearbërit@gmail.com)

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin "NDIHMË EDHE TI" që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

<https://tinyurl.com/lcc3e2f>

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

**REKLAMO  
BIZNESIN  
TËND**

Një faqe e plotë  
me ngjyra kushton  
15000 lekë

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë  
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohe  
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

**BËJ PAJTIMIN TËND!**

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**

Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD.**

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Me **1000** lekë  
mund të rezervosh  
një reklamë gjatë  
gjithë vitit në format  
kartvizite (8x5cm)

**TANI MUND TË PAJTOHENI PRANË SPORTELEVE TË POSTËS SHQIPTARE  
NË TË GJITHË SHQIPËRINË. NJË PAJTIM VJETOR KUSHTON 600 LEKË**

**BIGmarket**

një epokë e re dashurie  
ndaj jush po nis tani

**GJITHMONË ME OFERTA...**  
PESHKOPI MAQELLARË